

osce

Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri



# TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

Manual për Trajnerë

PËR AKADEMINË E SIGURISË



# TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

---

Manual për Trajnerë

PËR AKADEMINË E SIGURISË

### **@ Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2023**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Materiali që përmban ky botim mund të citohet ose të rishtypet, me kusht që të njihet autorësia e tij dhe një kopje e botimit që përmban materialin e rishtypur t'i dërgohet Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por nuk kufizohet në përdorimin komercial apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky botim, kërkon lejen me shkrim të Prezencës së OSBE-së.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

ISBN: 9789928470751

Ky botim u realizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në kuadrin e Programit "Avancimi i kapaciteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe Akademisë së Sigurisë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore", i cili zbatohet me mbështetjen e Qeverive të Shteteve të Bashkuara, Norvegjisë dhe Italisë.

Ky dokument u financua nga qeveritë e sipër përmendura, gjithsesi pikëpamjet e shprehura në të nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikat zyrtare të Qeverive të Shteteve të Bashkuara, Norvegjisë dhe Italisë.

# Përmbajtja

Shkurtime.....	6
Hyrje.....	7
01 - Hyrje në trafikimin e qenieve njerëzore .....	8
02 - Trafikimi dhe kontrabandimi - dallimet.....	19
03 - Shkaqet dhe pasojat - faktorët shtytës dhe tërheqës.....	23
04 - Format e shfrytëzimit .....	26
05 - Metodatat e rekrutimit .....	37
06 - Metodatat e kontrollit .....	46
07 - Trafikimi i fëmijëve.....	51
08 - Identifikimi i viktimës .....	55
09 - Intervista fillestare - teknika konjitive e intervistimit .....	70
10 - Hetimi i trafikimit të qenieve njerëzore .....	83
11 - Detyrimi për Përkujdes dhe Vlerësimi i Rrezikut për Viktimat e Trafikimit .....	92
12 - Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe Skuadrat e Përbashkëta Hetimore .....	103

# Shkurtime

BE	Bashkimi Evropian
EUROPOL	Agjencia Evropiane e Bashkëpunimit për Zbatimin e Ligjit
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur i Republikës së Shqipërisë
KiE	Këshilli i Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
KP	Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
KPrP	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
OSBE/OSCE	Organizata për Siguri e Bashkëpunim në Evropë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
TQNJ	Trafikimi i Qenieve Njerëzore
SPH	Skuadra të Përbashkëta Hetimore
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin
UNTOC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar
VKM	Vendime të Këshillit të Ministrave

# Hyrje

Përditësimi i metodave të mësimdhënies dhe trajnimit në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore është një prej objektivave kryesorë të punës së Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Për t'i ardhur në ndihmë institucioneve dhe në veçanti Akademisë së Sigurisë dhe Policisë së Shtetit Shqiptar për të patur metoda trajnimi që i përshtaten sfidave që paraqet trafikimi i personave sot, Prezenca e OSBE-së ka hartuar këtë manual "Trajnimi Trajnerësh" i cili prezanton një metodologji të shtjelluar trajnimi për stafin akademik dhe punonjësit e policisë me synim zhvillimin e trajnimeve në fushën e masave kundër trafikimit.

I konceptuar si një udhërrëfyes për trajnerë, ky Manual duhet të përdoret bashkërisht me botimet e mëparshme të OSBE-së si "Trafikimi i Qenieve Njerëzore, Manual për Punonjësit e Policisë" dhe "Trafikimi i Qenieve Njerëzore, Manual për Gjyqtarë, Prokurorë dhe Profesionistë të tjerë Ligjorë", të botuara në vitin 2021 në kuadrin e ndryshimeve të rëndësishme në legjislacionin penal në Shqipëri, dhe jo vetëm, ndryshime të cilat patën një ndikim të drejtpërdrejtë në punën e agjencive ligjzbatuese dhe organeve të drejtësisë në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore.

Manuali është konceptuar për trajnerët dhe stafin akademik të Akademisë së Sigurisë sjell njohuri dhe metoda trajnimi interaktive që mund të vihen në zbatim si në programet dhe kurrikulën e Akademisë por dhe në trajnime të tjera të zhvilluara nga Akademia apo nga Policia e Shtetit. Manuali përmban njohuri praktike nga koncepti i trafikimit, identifikimi i viktimave dhe hetimi, e deri në konceptet e hetimeve të përbashkëta ndërkombëtare apo përdorimi i teknologjisë për zbulimin e veprave të trafikimit.

Autor kryesor i këtij manuali është Z. Colin Carswell, oficer policie në pension dhe ekspert ndërkombëtar në fushën e anti-trafikimit. Në hartimin e manualit, në lidhje me legjislacionin shqiptar dhe praktikën e rasteve morën pjesë, Znj. Juliana Rexha, Oficere e Anti-Trafikimit e Prezencës së OSBE-së, Znj. Anila Trimi, eksperte vendase për trajtimin ndërdisiplinar të trafikimit të qenieve njerëzore dhe Znj. Jonita Kabashi, eksperte vendase për legjislacionin e mbrojtjes së fëmijës.

Hartuesit falenderojnë Prof.Dr. Ilirjan Mandro, Rektor i Akademisë së Sigurisë për mbështetjen dhe këshillimin gjatë procesit të hartimit të këtij manuali.

01

Hyrje në  
trafikimin  
e qenieve  
njerëzore





## Objektivat e kapitullit

Në përfundim të këtij kapitulli, pjesëmarrësit:

- Do të kuptojnë përkufizimin e trafikimit të qenieve njerëzore.
- Do të njohin tri elementet kryesore të trafikimit të qenieve njerëzore të cilat janë aktivitetet kryesore që formojnë secilin prej tyre, dhe dallimin domethënës midis të rriturve dhe fëmijëve.
- Do të kuptojnë domethënien e vendndodhjes dhe shtetit të origjinës, tranzitit dhe destinacionit.
- Do të vlerësojnë se si të drejtat e njeriut janë të rëndësishme në kontekstin e trafikimit të qenieve njerëzore.



## Ushtrim

- Bëjini grupit pyetjen: "Sa e vjetër është skllavëria?"
- Diskutojeni në grup të madh.



## Pikat kryesore të kapitullit

- Skllavëria ka ekzistuar në qytetërime për sa kohë që njerëzit kanë pasur qytetërim. Të dhënat më të hershme të skllavërisë datojnë rreth 6,800 Para erës sonë kur qytet-shtetet e para në Mesopotami përdornin si skllavër të burgosurit e kapur në luftë.
- Që prej atyre kohërave, tregtia e njerëzve si mall është bërë një prej formave më fitimprurëse të biznesit, dhe ka vijuar, pa ndërprerje për 8,000 vitet e fundit.
- Trafikimi i qenieve njerëzore, apo Skllavëria Moderne, siç i referohen në disa vende, nuk është më pak biznes sa ishte për ata të Mesopotamisë, Greqisë, Romës, apo të atyre që bënë tregtinë e skllavërve për në Amerikë.



## Fakt që duhet theksuar

***Në cilindo çast, vlerësohet se rreth 40.3 milionë njerëz ndodhen në skllavëri moderne, përfshirë 24.9 milionë në situatë pune të detyruar, dhe 15.4 milionë në situatë martese të detyruar.***

*Organizata Botërore e Punës (ILO)*

***Në Shqipëri në vitin 2022 u identifikuan 110 viktime të mundshme trafikimi dhe 2 viktime trafikimi ndërsa në vitin 2021 ishin identifikuar 154 viktime të mundshme dhe 5 viktime trafikimi.***

*Ministria e Brendshme*



## Ushtrim

Pyeteni grupin:

- Si shfaqet sot trafikimi i qenieve njerëzore?
- Si shfaqet trafikimi i qenieve njerëzore në Shqipëri?
- Diskutoni në grup të madh.



## Pikat kryesore të kapitullit

- Trafikimi i qenieve njerëzore është një biznes, i nxitur nga grupet e krimit të organizuar, për të përfituar para dhe shërbime nëpërmjet shfrytëzimit. Zakonisht është një sipërmarrje kriminale me rrezik të ulët/fitim të lartë.
- Ndonëse disa trafikantë veprojnë si individë ose në grupe të vogla, në pjesën më të madhe të rasteve ata janë të organizuar në rrjete kriminale ndërkombëtare. Këto grupe punojnë në bazë të vëllimit. Sa më shumë viktima të kontrollojnë, aq më shumë para nxjerr organizata apo biznesi.
- Trafikimi i qenieve njerëzore prek çdo vend të botës.
- Megjithëse mund të besohet se shumica e viktimave të trafikimit transportohen në distanca të mëdha, realiteti tregon se trafikimi i qenieve njerëzore ndodh si në nivel ndërkombëtar ashtu edhe brenda vendit - ai që njihet si "trafikimi i brendshëm".
- Skllavëria ndodh kur dikush zotëron dikë siç zotëron një pronë. Robërimi ose shërbimet e detyruara, siç mund të njihen ndryshe ndodh në rastin kur personi banon në mjediset e shtëpisë së punëdhënësit, punon për të dhe nuk mund të largohet, por punëdhënësi nuk e zotëron personin. Puna e detyruar do të thotë që je i detyruar të bësh punë për të cilën nuk ke rënë dakord, nën kërcënimin e ndëshkimit.
- Të dhënat zyrtare në Shqipëri konfirmojnë se trafikimi i femrave me qëllim shfrytëzimin seksual përbën numrin më të lartë të rasteve të identifikuara. Për Rast praktik, në vitin 2022 nga 110 viktima të mundshme trafikimi, 61 prej tyre ishin gra dhe vajza të shfrytëzuara seksualisht. Lypja e detyruar zë vendin e dytë të rasteve me 26 raste të identifikuara në vitin 2022. Një formë shqetësuese është detyrimi i të miturve për të kryer veprimtari kriminale siç vihet re dhe nga të dhënat zyrtare që raportojnë 14 raste po në këtë vit (Burimi: Ministria e Brendshme, Raporti Vjetor për Realizimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Masat kundër Trafikimit të Personave).



## PËRKUFIZIMI I NJOHUR NDËRKOMBËTARISHT PËR “TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE”

Në këtë kapitull trajtohen elementët e konceptit të trafikimit të qenieve njerëzore.

### AKTIVITET

Trajnuesi shfaq slide-t që tregojnë pikat kyçe si më poshtë:

Përkufizimi që jep Protokoli i Palermos për trafikimin e qenieve njerëzore është si më poshtë:



*Trafikimi... "nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës e formave të tjera të shtrëngimit, marrjes me forcë, mashtrimit, dredhisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vulnerabël ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi."*

Kodi penal Shqiptar e përkufizon trafikimin si :



*Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.*



## RAST PRAKTIK

*Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në lidhje me veprën penale të trafikimit, arsyeton: ...Gjykata çmon me këtë rast të sqarojë se, vepra penale e “Trafikimit të femrave”, e parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal, është veprë penale formale, domethënë që nuk kërkon ardhjen e ndonjë pasoje kriminale, në mënyrë që ajo të konsiderohet e kryer. Kjo veprë, që të konsiderohet e konsumuar, mjafton që të provohen të gjithë elementët e saj, që kanë të bëjnë me objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive dhe nuk kërkon ardhjen e asnjë lloj pasoje...”.*

*Vendimi nr.31, datë 14.06.2007, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndaj të pandehurit E.M.*

*Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, T., me vendimin e saj nr. 47, datë 23.10.2007, në lidhje me këtë çështje, ndër të tjera ka arsyetuar: “...Figura e veprës penale të trafikimit të femrave, konsiderohet e formuar edhe me ekzistencën e njërit nga elementët e saj, kur bëhet në format dhe qëllimet e sipër cituara të kësaj dispozite. Pra, do të mjaftonte edhe vetëm elementi i rekrutimit apo i transportimit etj., nëpërmjet formave dhe qëllimeve të lartpërmendura, që i pandehuri të ketë përgjegjësi penale sipas kësaj dispozite. Fakti, që i pandehuri nuk ia arriti qëllimit që ta shfrytëzojë të dëmtuarën për prostitutë, nuk bën që ai të mos përgjigjet penalisht, pasi ai i ka konsumuar të gjithë elementët e kësaj figure vepre penale...”.*

*Vendimi nr.47, datë 23.10.2007, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, ndaj të pandehurit E.M.*



## Pikat kryesore të kapitullit

- “Protokolli mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikut të Personave, veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve”, që njihet si “Protokolli i Palermos” u miratua në Palermo të Italisë me anë të një rezolute të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 15 nëntor 2000.
- Ai është një traktat shumëpalësh, i nënshkruar nga afro 190 shtete dhe ishte konventa e parë ndërkombëtare për luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, trafikimit të qenieve njerëzore, dhe terrorizmit.
- Shumica e ligjeve dhe Kodeve Penale vendase për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore bazohen te Protokolli i Palermos.

## TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE - TRE ELEMENTËT KRYESORË: "VEPRIMI, MJETET, QËLLIMI"



### Pikat kryesore të kapitullit

Lidhur me përkufizimin e trafikimit të qenieve njerëzore, kemi identifikuar tre elementët kryesorë: veprimi, mjetet dhe qëllimi.

### Veprimet - Çfarë është bërë

Veprimi është "çfarë është bërë" fizikisht.

Kjo përfshin:

Rekrutimin → Transportimin → Transferimin → Fshehjen → Pritjen e personave

Veprimi është në thelb procesi se si viktimat trafikohen duke nisur që nga momenti i rekrutimit deri tek realizimi i qëllimit, shfrytëzimi.



### Ushtrim

- Shtroni pyetjen për grupin "si" "rekrutohen" viktimat?
- Diskutojini përgjigjet në grup të madh.

## MJETET - SI KRYHET



### Pikat kryesore të kapitullit

- Që personi të trafikohet nuk duhet që ndaj tij domosdoshmërisht të ushtrohet dhunë apo kërcënim.
- Mashtrimet, gënjeshttrat, premtimet e rreme janë metodat më të zakonshme për rekrutimin e viktimave.
- Sipas Protokollit të Palermos, NËSE ndaj një personi të rritur përdoret ndonjë nga Mjetet e mësipërme atëherë dhënia e pëlqimit prej tyre për çdo formë shfrytëzimi apo detyrë që u caktohet, nuk merret parasysh.
- Fëmijë është çdo person nën moshën 18 vjeç.
- Protokollin e Palermos shprehet shumë qartë se për fëmijët, nuk kërkohet përdorimi i mjeteve të mësipërme (kërcënim, dhuna etj). Dhënia e pëlqimit nga ana e një fëmije nuk merret parasysh.
- Kjo nuk do të thotë se kjo fazë nuk ndodh për viktimat fëmijë, por se përkufizimi njih dhe pranon se fëmija nuk mund të japë një pëlqim të informuar për shfrytëzimin e tij apo saj, edhe nëse ai apo ajo bie dakord të udhëtojë apo e kupton se çfarë ka ndodhur.


## QËLLIMI - PSE BËHET



### Pikat kryesore të kapitullit

- "Qëllimi" është shfrytëzimi real ose qëllimi për ta shfrytëzuar një person.
- Kjo do të thotë se vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore mund të quhet e kryer edhe nëse shfrytëzimi nuk ka ndodhur ende, për Rast praktik kur një viktimë është shpëtuar gjatë udhëtimit të saj para se të ndodhë çdo formë shfrytëzimi.
- Thënë më thjesht, kjo ka të bëjë me mënyrën se si trafikanti përfiton nga shfrytëzimi i viktimës.

## GRAFIK I VEPRIMIT, MJETIT DHE QËLLIMIT



### Pikat kryesore të kapitullit

- Një keqkuptim i zakonshëm:

Ka një perceptim të gabuar sipas të cilit trafikimi duhet të përfshijë "transportimin" (ose lëvizjen) e viktimës përtej kufijve të një shteti. Trafikimi mund të ndodhë nga një qytet në tjetrin, nga një zonë rurale në një qytet, apo edhe më thjesht nga një rrugë apo ndërtesë në një tjetër.

## TERMINOLOGJI: SHTETET DHE VENDET E ORIGJINËS, TRANZITIT DHE DESTINACIONIT

### Ushtrim



- Secilit pjesëmarrës jepini si detyrë të shkruajnë, me fjalët e tyre, një përkufizim të shteteve të origjinës, tranzitit dhe destinacionit.
- Përzgjidhni një numër të vogël pjesëmarrësish që të japin përkufizimin e tyre.
- Diskutim në grup të madh për përgjigjet - fokusohuni te dallimet dhe pse?



## Pikat kryesore të kapitullit

- Në lidhje me trafikimin e brendshëm, ne përdorim terminologjinë "Vendndodhja e origjinës", "Vendndodhjet e Tranzitit" dhe "Vendndodhja e Destinacionit".
- Trafikimi i qenieve njerëzore nuk është gjithmonë ndërkombëtar. Kur dikush trafikohet brenda të njëjtit vend, ky lloj trafikimi quhet zakonisht "trafikim i brendshëm".



## SHTETI OSE VENDI I ORIGJINËS

### Pikat kryesore të kapitullit

- Shteti ose vendi i origjinës së viktimës dhe nga ku rekrutohet dhe/ose shpërngulet për herë të parë.
- Në terma ndërkombëtarë, vendi i origjinës ose "shtet i origjinës" është shteti ku zakonisht trafikantët gjejnë dhe rekrutojnë viktimat.
- Arsytet sociale dhe/ose ekonomike janë shpesh faktorët shtytës për një numër domethënës viktimash që bien pre e trafikimit.
- Mungesa e mundësive, niveli i ulët arsimor, varfëria, paqëndrueshmëria politike janë të gjithë faktorët që njihen si "faktorë shtytës" që i hedhin njerëzit në krahët e trafikantëve.
- Gjithashtu, janë edhe "faktorët tërheqës". Këto janë premtime për një jetë më të mirë, për punë, për pagesë më të mirë, etj. që i tërheqin viktimat në vendndodhje ose shtete të tjera.



## SHTETI OSE VENDI I TRANZITIT

### Pikat kryesore të kapitullit

- Në terma ndërkombëtarë, shtet tranzit është një shtet nëpër të cilin kalon viktimat e trafikimit ndërkohë që e transportojnë drejt vendit të destinacionit.
- Udhëtimi i viktimës së trafikimit nga vendi i origjinës drejt vendit të destinacionit mund të zgjasë për një kohë të gjatë dhe të kalojë nëpër disa shtete.
- Itinerari mund të jetë direkt por shpesh trafikantët i marrin viktimat duke kaluar në itinerare të stabilizuara që u ofrojnë trafikantëve një shkallë sigurie, dhe kanë kosto të ulëta transporti.
- Vendet e tranzitit shpesh përzgjidhen duke marrë parasysh vendndodhjen gjeografike dhe gjeopolitike, transportin me kosto të ulët, korrupsionin e zyrtarëve apo lidhjet me grupe të tjera të krimin të organizuar që janë të përfshira në trafikim dhe/ose "kontrabandimin" e personave.

## SHTETI OSE VENDET E DESTINACIONIT

### Pikat kryesore të kapitullit



- Në terma ndërkombëtarë, vendi i destinacionit është zakonisht shteti ku trafikantët kanë për synim të jetë destinacioni përfundimtar i viktimës së trafikimit dhe ku ajo do të shfrytëzohet.
- Vendet e destinacionit janë hallka e fundit në zinxhirin e trafikimit të qenieve njerëzore.
- Vendet e destinacionit janë përgjithësisht më të zhvilluara ekonomikisht se sa vendet e origjinës, duke ofruar fitime domethënëse financiare për trafikantët dhe shfrytëzuesit.
- Viktimat mund të shfrytëzohen edhe në vendet e tranzitit, për Rast praktik nëse mbahen (fshihen) në një vendndodhje ndërkohë që presin deri sa të rregullohet transporti për më tej.



### Të drejtat e njeriut

Trajneri prezanton sa më poshtë:

*Trafikimi i qenieve njerëzore është një krim global që bazohet në tregtimin dhe shfrytëzimin e njerëzve për përfitime. Njerëzit e të gjitha gjinive, moshave dhe prejardhjeve mund të bëhen viktimë të këtij krimi, i cili ndodh në çdo rajon të botës. Trafikantët përdorin dhunën, agjencitë e rreme të punësimit dhe premtimet e rreme për arsimim dhe mundësi punësimi për të detyruar dhe mashtruar viktimat e tyre.*

*Trafikantët përfitojnë nga pozita vulnerabël e personave të pambrojtur, të dëshpëruar ose thjesht që kërkojnë një jetë më të mirë. Trafikimi i qenieve njerëzore përkufizohet në Protokollin e OKB-së për Trafikimin e Personave, i cili plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional, si "rekrutimi, transporti, transferimi, strehimi ose marrja e një personi me mjete të tilla si kërcënim i forcës ose forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit me qëllim shfrytëzimi".*

*Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet (UNODC)*



## DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

### Pikat kryesore të kapitullit



- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut u hartua nga përfaqësues nga të gjitha rajonet e botës.
- Shpallur nga Kombet e Bashkuara më 10 dhjetor 1948, si një standard i përbashkët i arritjeve për të gjithë njerëzit dhe për të gjitha kombet.
- Ajo përcaktoi, për herë të parë, të drejtat themelore të njeriut që mbrohen në nivel universal dhe është përkthyer në më shumë se 500 gjuhë.
- Më 13 korrik 1995, Shqipëria u anëtarësua në Këshillin e Evropës. Duke qenë anëtare, Shqipëria është subjekt i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
- Neni 4 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar).
- Neni 4 mbron të drejtën e një personi duke parashikuar se askush nuk do të mbahet në skllavëri ose në robëri, apo të shtrëngohet për punë të detyruar.
- Ndonëse neni 4 nuk e përmend trafikimin, ka shumë çështje të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që e kanë zgjeruar përkufizimin e nenit 4 për të përfshirë trafikimin (Rantsev k. Qipros dhe Ruisë, § 272 dhe të tjerë).

### Ushtrim



- Ndajini pjesëmarrësit në grupe të vogla.
- Jepini secilit grup rast studimor si më poshtë:

***Siliadin k. France [2005]:***

***Një vajzë 15 vjeçare nga Togo u soll në Francë nga "Zonja D", që i pagoi udhëtimin. Vajzës i ishte thënë se do të punonte për Zonjën D deri sa të shlyente biletën e udhëtimit. Por, pas disa muajsh, "u dha hua" te një çift tjetër.***

***Ata e detyruan të punonte 15 orë në ditë, shtatë ditë të javës, pa pagesë, pa pushime, dhe pa shkollë. Vajza vishte rroba të përdorura dhe nuk kishte një dhomë të vetën.***

***Autoritetet ndërhyjnë kur u vunë në dijeni të situatës, por skllavëria dhe robërimi nuk përbënin vepër penale specifike në Francë në atë kohë.***

- Secilit grup kërkoni të marrin në shqyrtim:
  - ◆ A u cënuan të drejtat e njeriut të vajzës?
  - ◆ Jepni arsye për vendimin tuaj.
- Secili grup do të paraqesë gjetjet e veta.
- Trajnuesi informon grupin për rezultatet.

***Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh se vajza ishte mbajtur në robëri dhe se Franca kishte shkelur detyrimet e saj pozitive sipas parashikimit të ndalimit të skllavërisë dhe punës së detyruar. Ligji francez nuk i kishte dhënë vajzës mbrojtje specifike dhe të efektshme.***

## Neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (E drejta për një proces të rregullt)



### Pikat kryesore të kapitullit

- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka nxjerrë së fundmi, në 2021, një vendim lidhur me Nenin 6 në çështje të trafikimit të qenieve njerëzore ku viktimat ndiqen penalisht për krime që i kanë kryer gjatë kohës që shfrytëzoheshin (V.C.L. dhe A.N. k. Mbretërisë së Bashkuar (kërkesat nr. 77587/12 dhe nr 74603/12)).
- Gjykata gjeti se mungesa e hetimit të duhur për trafikimin e pretenduar i privoi viktimat nga informacioni i rëndësishëm që mund të ndikonte te ndjekja e tyre penale - privim që preku drejtpërdrejt të drejtën e tyre për mbrojtje.

## PËRMBLEDHJE



### Pikat kryesore të kapitullit

- Siç e pamë, trafikimi i qenieve njerëzore është një çështje mbarëbotërore, që prek çdo vend.
- Ai gjeneron fitime të jashtëzakonshme për kriminelët, shpesh të organizuar dhe që veprojnë në nivel ndërkombëtar.
- Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore janë burra, gra, dhe fëmijë. Trafikantët dhe shfrytëzuesit mund të jenë si burra edhe gra.
- Pavarësisht nga sfidat domethënëse si për të kuptuar shkallën e çështjes, numrat e viktimave të vërteta dhe metodat e ndërlikuara që përdorin shpesh trafikantët dhe shfrytëzuesit, nuk duhet të harrojmë asnjëherë parimet bazë themelore që është trafikimi i qenieve njerëzore ... veprimi, mjeti dhe qëllimi.
- Procesi i trafikimit të qenieve njerëzore është i thjeshtë në shumë drejtime.
  - ◆ Faza 1: Gjej njerëz vulnerabël
  - ◆ Faza 2: Rekrutoji duke shfrytëzuar nevojat dhe dëshirat njerëzore
  - ◆ Faza 3: Merr masa dhe menaxho transportimin e tyre nga A në B
  - ◆ Faza 4: Shfrytëzoji

*Për një informacion më të hollësishëm mbi trafikimin e qenieve njerëzore, referojuni Manualit të OSBE-së "Trafikimi i Qenieve Njerëzore. Manual për Punonjësit e Policisë", kapitulli 1.1.*

<https://www.osce.org/files/f/documents/8/f/513298.pdf>

02

Trafikimi

dhe

kontrabandimi

dallimet



## Objektivat e kapitullit

Në përfundim të këtij kapitulli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të rikujtojnë elementet e përkufizimeve ndërkombëtare të trafikimit të qenieve njerëzore (TQNj) dhe “kontrabandimit”<sup>1</sup> të njerëzve.
- Të shpjegoni dallimin midis këtyre dy dukurive.
- Të zbatoni përkufizimet ndërkombëtare në kontekste dhe trajta të ndryshme të TQNJ.

## HYRJE



### Pikat kryesore të kapitullit

- Lëvizja e njerëzve nga një vend në tjetrin, nga një rajon në tjetrin, është pjesë e historisë së njerëzimit.
- Migrimi është, shpesh, një pjesë kyçe e ndryshimit dhe zhvillimit si në nivel individual edhe në atë të shoqërisë.
- Megjithatë, ka disa anë të errëta të lëvizjes së njerëzve dhe kjo ka të bëjë me kontrabandimin dhe trafikimin e qenieve njerëzore.
- Në këtë pjesë, do të eksplorojmë dallimet themelore midis migracionit, kontrabandimit, dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

## MIGRACIONI



### Pikat kryesore të kapitullit

- Shumë njerëz transportohen ligjërisht për të punuar në mënyrë të ligjshme ose brenda vendit ose në rang ndërkombëtar.
- Migracioni mund të realizohet me anë të mjeteve të ligjshme ose të paligjshme si dhe mund të bëhet në bazë të një zgjedhjeje të lirë ose të detyruar mbi migrantin si një mjet për mbijetesë fizike ose ekonomike.

Migracioni trajton:

- Migracionin e përhershëm
- Punonjës të përkohshëm migrantë
- Refugjatët
- Migracionin e parregullt

<sup>1</sup> Kontrabandimi është termi i përdorur gjerësisht në dokumenta ndërkombëtare dhe sipas legjislacionit shqiptar i referohet veprës penale “dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”.

## TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE



### Pikat kryesore të kapitullit

- Trafikim është kur një i rritur gënjehet, mashtrohet, ose shtrëngohet të lëvizë dhe të shfrytëzohet (Për fëmijët është lëvizja dhe shfrytëzimi).
- Ata mund të mendojnë se po hyjnë ligjërisht në një vend për një arsye që e besojnë të ligjshme ose se po “kontrabandohen” për punë, por në të vërtetë shfrytëzohen kur mbërrijnë në destinacion.
- Viktimat e trafikimit mund të hyjnë në një shtet me dokumente të rregullta ose në mënyrë të paligjshme.
- Trafikimi i qenieve njerëzore mund të ndodhë si brenda shtetit edhe jashtë shtetit në nivel ndërkombëtar. Trafikimi brenda një vendi njihet si trafikim “i brendshëm”.
- Trafikimi është gjithmonë një krim, por një krim i kryer kundër një individi.

## KONTRABANDIMI



### Pikat kryesore të kapitullit

- Kontrabandimi është gjithmonë i paligjshëm.
- Ai ndodh kur një person paguan një tjetër për të transportuar diçka apo dikë në mënyrë të paligjshme nga një shtet në tjetrin.
- Kontrabandimi ndodh vetëm nga njëri shtet në tjetrin nëpërmjet kalimit të kufijve shtetërorë.
- Shërbimi përfundon me mbërritjen në destinacionin e rënë dakord më parë.
- Kontrabandimi i qenieve njerëzore përbën gjithmonë një krim, por një krim që kryhet kundër shtetit dhe jo kundër një individi.



### Ushtrim

- Pyetini pjesëmarrësit, individualisht, që “Me fjalët tuaja përshkruani dallimet kryesore midis trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandimit”.
- Diskutim në klasë me pjesëmarrësit lidhur me pikëpamjet e tyre për dallimet.



### Sigurohuni që të diskutohen dallimet kryesore si më poshtë:

- *Trafikimi është një krim kundër individit ndërsa kontrabandimi është krim kundër shtetit.*
- *Kontrabandimi është një ndërveprim tregtar midis një individi dhe një kontrabandisti. Individi paguan për një shërbim. Me arritjen në destinacion, transaksioni përfundon.*
- *Në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore, viktimat nuk ka zgjedhje, edhe në rast se mendon se ka. Qëllimi i zhvendosjes së viktimës së trafikimit është shfrytëzimi me mbërritjen në destinacionin final.*
- *Kontrabandimi ndodh vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me kalim të kufijve shtetërorë. Trafikimi i qenieve njerëzore mund të ndodhë si brenda shtetit edhe jashtë shtetit. Trafikimi brenda një vendi njihet si trafikim “i brendshëm”.*



## Pikat kryesore të kapitullit

- Njerëzit që kontrabandohen janë tejet vulnerabël ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit si gjatë udhëtimit edhe pas mbërritjes në destinacionin e rënë dakord.
- Trafikantët e qenieve njerëzore shpesh punojnë së bashku me bandat që kryejnë kontrabandimin e migrantëve, duke përdorur shërbimet e tyre, ku viktimat e trafikimit kalojnë përgjatë rrugëve të njohura të kontrabandimit.
- Një person që beson se është migrant i ligjshëm apo që ka paguar për të kaluar kufirin në mënyrë të parregullt, mund ta shfrytëzohet në vendin e destinacionit dhe për rrjedhojë të kthehet në viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore.

## PËRMBLEDHJE



### Pikat kryesore të kapitullit

- Kuptimi i ngjashmërive, por edhe i dallimeve është me rëndësi të madhe për të kuptuar trafikimin e qenieve njerëzore në krahasim me kontrabandimin.

#### Në këtë kapitull:

- Analizuar përkufizimet për Migracionin, Kontrabandimin, dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore.
- Eksploruar dallimet kyçe midis Kontrabandimit dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore.
- Pamë se si për individin dhe për viktimën e mundshme, dallimi midis migracionit, kontrabandimit dhe trafikimit nuk janë gjithmonë të qarta, ku individ është në një rrezik domethënës për abuzim, shfrytëzim, dhe shfrytëzim të mëtejshëm si gjatë udhëtimit edhe me mbërritjen e tij në destinacionin final.
- Përforcuam kuptimin e faktit se krimi i kontrabandimit është gjithmonë kundër një shteti ndërsa krimi i trafikimit të qenieve njerëzore është një krim kundër një personi.

*Për një informacion më të hollësishëm mbi dallimin midis Kontrabandimit dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore, referojuni Manualit të OSBE-së: “Trafikimi i Qenieve Njerëzore Manual për Gjyqtarë, Prokurorë dhe Profesionistë të tjerë Ligjorë”.*

<https://www.osce.org/files/f/documents/f/6/512644.pdf>

03

Shkaqet dhe  
pasojat:

Faktorët shtytës  
dhe tërheqës



## Objektivat e kapitullit

Në këtë kapitull do të trajtohen elementet e konceptit të "trafikimit të qenieve njerëzore", duke ju mundësuar të kuptoni bazat e çështjeve kryesore.

### Në fund të këtij kapitulli:

- Do të kuptoni "faktorët shtytës dhe tërheqës" dhe se si ata janë një faktor domethënës në trafikimin e qenieve njerëzore.
- Do të çmoni faktorët e ndryshëm që kanë ndikim te faktorët shtytës dhe tërheqës.

## HYRJE

### Pikat kryesore të kapitullit

- Janë të shumta arsyet që i nxisin njerëzit të kërkojnë një mundësi më të mirë në një vend tjetër. Gjatë analizës së veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore, ne përdorim termat "faktorët shtytës dhe tërheqës".
- Arsyet që e shtyjnë një person të lërë shtëpinë e vet dhe të kërkojë një jetë më të mirë mund të jenë të natyrës sociale, ekonomike, mjedisore ose politike.
- Kur një person migron nga një vend për shkak të kushteve të paqëndrueshme, si pasiguria apo papunësia, këtyre faktorëve u referohemi si faktorë shtytës.
- Personi "shtyhet" të largohet nga vendi i tij për shkak të një morie rrethanash.
- Faktorët që i tërheqin njerëzit drejt një mjedisi të ri mund të përfshijnë sigurinë, punësimin, qëndrueshmërinë politike dhe klimën. Këtyre faktorëve u referohemi si faktorë tërheqës. Personi tërhiqet në një vendndodhje të ndryshme.

## FAKTORË SHTYTËS

### Pikat kryesore në këtë kapitull

- Faktorët shtytës mund të jenë të ndryshëm dhe personal për individin. Megjithatë, qoftë në mënyrë specifike për trafikimin e qenieve njerëzore, qoftë për migracionin në përgjithësi, shpesh ka faktorë të përbashkët shtytës.

### Disa prej këtyre faktorëve të përbashkët janë:

- Varfëria
- Mungesa e mundësive sociale, ekonomike apo për edukim
- Papunësia
- Aftësia që individi beson se ka për të shlyer një borxh
- Uria
- Ndryshimet mjedisore dhe/ose fatkeqësitë natyrore
- Paqëndrueshmëria politike
- Lufta
- Pabarazitë gjinore
- Presioni i familjes dhe/ose komunitetit



## FAKTORËT TËRHEQËS



### Pikat kryesore të kapitullit

Faktorët shtytës dhe tërheqës janë si dy anë të së njëjtës monedhë - janë plotësisht të lidhur por edhe krejtësisht të ndryshëm dhe të kundërt me njëri-tjetrin.

#### Si faktorë tërheqës shpesh konsiderohen:

- Besimi për mundësi më të mira pune
- Mundësi për të mbështetur familjen
- Mundësi më të mira edukimi
- Qëndrueshmëria politike
- Siguria fizike
- Liria fetare dhe/ose liria politike
- Siguria mjedisore

Faktorët shtytës dhe tërheqës janë të shumtë, disa janë të përgjithshëm dhe shumë të zakonshëm, ndërsa të tjerë janë personal për individin.



### Ushtrim

- Në tabelë, vendosen në mënyrë rastësore një listë me "faktorë" (shih më poshtë). Studentëve u bëhet ftesa të vendosin një "faktor" nën titujt "Shtytës" ose "Tërheqës".
- "Faktorët" që do të vendosen janë:
  - Punësimi
  - Varfëria
  - Uria
  - Edukim më i mirë
  - Mungesë mundësish
  - Siguria Fizike

## PËRMBLEDHJE



### Pikat kryesore të kapitullit

- Në këtë sesion, pamë faktorët që e bëjnë një person të ndjejë nevojën për t'u larguar nga shtëpia, të kërkojë një jetë alternative ose më të mirë diku tjetër.
- Këta faktorë, faktorët shtytës dhe tërheqës, janë jo vetëm faktorë që e bëjnë një person vulnerabël ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, por janë edhe faktorë të lëvizjes vullnetare e tillë si migracioni.
- Faktorët shtytës dhe tërheqës mund të përmbliken si më poshtë:
- Faktorë shtytës janë ata që lidhen me vendin e origjinës.
- Faktorë tërheqës janë ata që lidhen me vendin e destinacionit.

04

# Format e shfrytëzimit



## Objektivat e kapitullit

Në këtë kapitull do të trajtohen elementët e konceptit të “trafikimit të qenieve njerëzore”, duke ju mundësuar të kuptoni bazat e çështjeve kryesore.

### Në fund të këtij kapitulli:

- Do të kuptoni format e ndryshme të trafikimit të qenieve njerëzore në botë sot.

## HYRJE

### Pikat kryesore të kapitullit

- Sot trafikimi i qenieve njerëzore shfaqet në format tradicionale të shfrytëzimit si dhe në forma të reja.
- Shfrytëzimi është dukuri globale dhe gjendet si në vendet në zhvillim edhe në ato të zhvilluara.
- Koncepti i “shfrytëzimit” mbetet i pandryshuar ... një njeri që shfrytëzon dhe nxjerr fitim domethënës nga puna e një tjetri. Fjala kyçe këtu është "shfrytëzim".
- Gjithashtu, është fakt se kur një person shfrytëzohet, është tejet vulnerabël ndaj formave të mëtejshme të shfrytëzimit. Viktima e shfrytëzimit mund ta gjejë veten të dhunuar fizikisht ose seksualisht apo të kenë kaluar në forma të tjera shfrytëzimi, si prostitucioni.
- Në këtë kapitull do të shikojmë disa forma shfrytëzimi që i ndeshim sot.



## Ushtrim

- Në grupe të vogla: rendisni 6 mënyra të ndryshme se si mund të shfrytëzohet një person.
- Grupet ndajnë përgjigjet e tyre në grup të madh.

### Pikat kryesore të kapitullit

- Shfrytëzimi mundet të marrë dhe merr shumë forma dhe është gjithmonë në ndryshim.
- Në terma të thjeshtë: shfrytëzimi ndodh ku trafikantët nxjerrin fitim nga përpjekjet, mundi ose puna e një viktime, siç u përshkrua në seksionin për "Qëllimin".
- Ka po aq forma të shfrytëzimit si pasojë e trafikimit të qenieve njerëzore sa ka pasur edhe më parë, në mos më shumë.

### Format më të përhapura të shfrytëzimit janë:

- Prostitucion
- Masazh erotik
- Shfrytëzim seksual i fëmijëve



- Veprimtari seksuale e organizaur nga grupe kriminale
- Punë në ndërtim
- Punë në bujqësi
- Lypje
- Vjedhje
- Shpërndarje substancash narkotike - Punë e detyruar shtëpiake
- Radikalizim terrorist
- Prokurim i organeve



## Ushtrim

- Shtroni pyetjen për grupin: "A janë vetëm gratë dhe fëmijët viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore?"
- Pasi të merrni disa përgjigje, informojini pjesëmarrësit se:

### **Sipas UNODC:**

- Burrat besohet se zënë rreth 25% të viktimave të trafikimit.
- 49% e viktimave të zbuluara janë gra të rritura.
- 33% e viktimave të zbuluara janë fëmijë.
- Gjithashtu, edhe vetë gratë mund të jenë trafikante, 28% e të gjithë trafikantëve të dënuar janë gra.

## TRAFIKIMI PËR SHFRYTËZIM SEKSUAL



### Pikat kryesore të kapitullit

- Burrat, gratë dhe fëmijët, që të gjithë janë vulnerabël ndaj trafikimit për qëllimin e shfrytëzimit seksual.
- Trafikimi me qëllim shfrytëzimin seksual mund të ndodhë jo vetëm në nivel ndërkombëtar por edhe brenda vendit.
- Shkalla e vërtetë e trafikimit për shfrytëzim seksual si në nivel ndërkombëtar edhe brenda vendit po fillon të njihet vetëm tani.

### **Mite**

- Një mit është se viktimat vijnë vetëm nga komunitete të varfra dhe të marginalizuara.
- Shumë viktimat mashtrohen, duke besuar se do të shkojnë të punojnë ligjërisht si ndihmëse në punë shtëpiake, pastruese apo edhe si modele.
- Një formë e zakonshme mashtrimi është ajo e "të dashurit", ku viktimat beson se ka një "të dashur" të besueshëm. Me kalimin e kohës, "i dashuri" e tregon veten se është "trafikant" dhe "shfrytëzues".

## SHFRYTËZIMI SEKSUAL



### Pikat kryesore të kapitullit

- Shfrytëzimi seksual, thënë ndryshe do të thotë se viktimat përdhuhet ose vuan nga sulme të tjera seksuale.
- Ky abuzim shpesh kryhet në mënyrë të përsëritur për një periudhë të gjatë kohe.
- Shpesh, ai kryhet nga trafikantët për të kontrolluar një viktimë.
- Shfrytëzimi seksual afatgjatë bëhet përgjithësisht për dy qëllime:
  1. Prostitucion, ku viktimat kontrollohet dhe prostituohet për të nxjerrë para për trafikantët.
  2. Shfrytëzim seksual në bazë grupi ku viktimat, shpesh fëmijë, rekrutohet (kryesisht ose me anë të një mashtrimi të "të dashurit" ose nëpërmjet mashtrimit duke fituar besimin duke u miqësuar dhe duke dhënë dhurata) dhe më pas përdoren për një kohë të gjatë për kënaqësitë seksuale të anëtarëve të bandës.

## PUNA E DETYRUAR



### Pikat kryesore të kapitullit

- Sikurse kemi parë në kapitujt e mëparshëm, nuk janë vetëm gratë dhe fëmijët viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore, por edhe burrat.
- Trajta më mbizotëruese e shfrytëzimit të burrave është puna në ndërtim dhe bujqësi.
- Burrat rekrutohen, shpesh nëpërmjet mashtrimit ku u thuhet se do të punojnë në punët e zakonshme të ndërtimit, duke besuar se do të jetojnë në kushte të arsyeshme dhe se do të marrin një pagë të drejtë.

## TRAFIKIM ME QËLLIM SHFRYTËZIMIT PËR PUNË



### RAST PRAKTIK

*Të tre bashkëpunuesit deklaruan se personi me emrin I.T, gjatë rrugës së përshkuar për transportimin e çantave me lëndë narkotike, i kërcënonte se do t'i vriste, duke mbajtur një armë në dorë, i urdhëronte të ecnin sa më shpejt dhe se po ky person goditi me armë të dëmtuarin A.N. Fakti që A.N u largua nga S. për të transportuar lëndë narkotike për llogari të personit me emrin I.T, e njoftuan edhe dëshmitarët në proces. Sipas dëshmitarit F.D, M.G u nis me shtatë persona të tjerë për të çuar hashash në shtetin G. dhe pronar i saj ishte I.T. (me të cilin edhe vetë kishte bashkëpunuar); sipas dëshmitarit Gj.S, personat që njoftuan A.N se do të nisej për në shtetin G. ishin nga F. dhe njiheshin shumë mirë me F.D; sipas dëshmitarit E.G, nga vëllai i tij, M.G,*

*mësoi se A.N nuk kishte mundur të vazhdonte rrugën dhe i e kishte goditur me automatik.*

*Deklarimet e bashktëpandehurve konfirmohen edhe me provat materiale të gjetura në vendin e ngjarjes, konkretisht me çantën që mbeti aty pasi A. nuk mund të vazhdonte rrugën dhe, me çorapen që sipas M.G i përkiste të pandehurit.*

*Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Nr.3/65/217/2017 ndaj të pandehurit I.T.*

## **PUNA E DETYRUAR - REALITETI**

- Me të mbërritur në destinacion, shumë prej tyre u thuhet se kanë borxh një shumë të madhe parash për transportin dhe kostot e jetesës. Ky është një borxh tejet i madh për ta shlyer.
- Viktimat gjenden në situatë detyrimi për shkak të borxhit, dhe praktikisht skllëvër borxhi.
- Sulmet dhe kërcënimet me dhunë janë të zakonshme dhe atyre u thuhet se duhet të punojnë deri sa ta shlyejnë borxhin deri në fund.
- Kushtet në të cilat detyrohen të punojnë burrat janë shpesh tejet të vështira dhe përgjithësisht masat e sigurisë mungojnë plotësisht.
- Vdekjet dhe lëndimet janë të zakonshme.

## **DETYRIMI PËR TË KRYER VEPRIMTARI KRIMINALE**

### **Pikat kryesore të kapitullit**

- Përdorimi i të rinjve apo personave vulnerabël për të kryer veprimtari kriminale është një nga mënyrat që krimi i organizuar i përdor për të realizuar fitime domethënëse me rrezik të ulët për veten.
- Persona të rinj dhe/ose vulnerabël mashtrohen, kërcënohen ose shtrëngohen që të kryejnë një krim. Nga këto veprime, ata vetë nuk fitojnë asgjë.
- Direktiva e BE 36/2011 mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore.
- Shumë shtete, përfshirë Shqipërinë, kanë të miratuar legjislacion për të mbështetur viktimat dhe për të garantuar që viktimat e trafikimit të mos ndëshkohen për krimet për të cilat janë detyruar t'i kryejnë.
- Pavarësisht nga kjo, viktimat e trafikimit për kriminalitet të detyruar shpesh ndiqen penalisht për veprimet e tyre.





## Ushtrim

- Pyetini pjesëmarrësit për format e ndryshme të shfrytëzimit kriminal.

### Më të zakonshmet janë:

- ◆ Lypja
- ◆ Vjedhja
- ◆ Shpërndarja e substancave narkotike
- ◆ Korrier droge
- ◆ Dhunë në banda
- ◆ Prodhimi i kanabisit
- Pasi të jetë identifikuar nga pjesëmarrësit lista e mësipërme (ose me ndihmë), ndajini në grupe të vogla.
- Secilit grup caktojini si detyrë që të identifikojë faktorët e mundshëm që do të identifikonin secilën formë të shfrytëzimit kriminal si trafikim i qenieve njerëzore.
- Diskutoni secilin krim në grup të madh, ku secili grup jep arsyetimin e vet.

## SHËRBBIMET E DETYRUARA SHTËPIAKE

### Pikat kryesore të kapitullit

- Të paguash dikë të të ndihmojë në shtëpi me punët apo për t'u kujdesur për fëmijët është për shumë persona një gjë e pranueshme dhe këto janë profesione të respektuara.
- Problemi është kur disa i abuzojnë dhe i shfrytëzojnë ata që janë në shërbim të tyre.



### RAST PRAKTIK

*"Më çonin me makinë 30 km çdo ditë në një qendër tregtare, ku duhej të rrija 12 orë çdo ditë për të shitur një revistë për bamirësi. Kur vinin të më merrnin për t'u kthyer, më bënin kontroll mos kisha mbajtur para, ai burri më rrihte nëse mendonte se mbaja ndonjë lek për vete. Më detyronin të punoja në rrugë gjatë gjithë dimrit pa ndonjë xhup apo diçka për të ngrënë apo për të pirë. Kur nuk punoja, duhej të gatujaja, të pastroja, dhe të kujdesesha për fëmijët e vegjël. Më lejohej të haja vetëm çfarë mbetej. Mund të flija vetëm në dyshemenë e kuzhinës."*

*Maria, 13 vjeç.*



## RAST PRAKTIK

*“Drejtoria e Policisë së Qarkut T. ka referuar në prokurori rastin e trafikimit të një personi të rritur, shtetases E.Xh, e cila shfrytëzohej për lypje, duke përfituar nga gjendja e saj fizike dhe mendore, rast ky i publikuar nga emisioni “Ça thu”, në datë 15.12.2014, në televizionin “Agon Chanel”. Nga ana e Prokurorisë janë kryer veprimet hetimore që ajo ka çmuar të nevojshme, duke arritur në përfundimin se shtetasja E.Xh është trafikuar me qëllim shfrytëzimin e saj për lypje, nga vëllezërit, të pandehurit I.Xh dhe Xh.Xh. Në këto rrethana, prokurori u ka komunikuar në përfundim të hetimeve, akuzën për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i personave të rritur”, parashikuar nga neni 110/ a i Kodit Penal”.*



### Ushtrim

- Organizojini sërish pjesëmarrësit në grupet e mëparshme.
- Secilit grup kërkojini të identifikojnë nga rasti studimor:
  - ◆ Nëse janë të pranishme, aspektet e Veprimit, Mjetit, dhe Qëllimit.
  - ◆ Cilat forma të shfrytëzimit janë të pranishme?
  - ◆ Secili grup më pas i prezanton gjetjet në grup të madh.



### Pikat kryesore të kapitullit

Punët e punëtorëve të shtëpisë që banojnë me familjen që i punëson.

- Forma e zakonshme e shfrytëzimit për shërbime të detyruara është kur një person nga një shtet tjetër vjen dhe punon si punëtor shtëpie duke jetuar me familjen pritëse.
- Në vend që t'i jepet një pagë e drejtë me standarde të arsyeshme jetese, ata punojnë në kushte të llojit të skllavërisë.



### Përvoja të zakonshme

- Viktimat e shërbimeve të detyruara zakonisht përjetojnë një ose më shumë nga sa më poshtë:
  - ◆ Kërcënohen, rrihen dhe/ose sulmohen seksualisht.
  - ◆ Nuk paguhen ose nëse paguhen shpesh janë në situatë detyrimi për shkak të borxhit.
  - ◆ U mbahet pasaporta.
  - ◆ Nuk kanë kontakt me miq ose familjarë.
  - ◆ Kërcënohen nga trafikanti se do t'i drejtohen policisë ose zyrës së migracionit.



## SEKTORI I PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES



### Ushtrim

- Lehtësoni diskutimin në grup.
- Si e identifikoni sektorin e prodhimit dhe shpërndarjes?
- Ku mund të gjendet trafikimi i qenieve njerëzore, anembanë botës, në këta sektorë?



### Pikat kryesore të kapitullit

- Sasia e produkteve që prodhohen dhe shiten në nivel global është e jashtëzakonshme dhe ka një kërkesë të pallogaritshme për produkte të lira dhe fitime të larta.
- Në mënyrë që oferta të përmbushë kërkesën dhe fitimet të jenë të larta, shumë burra, gra, dhe fëmijë nëpër botë trafikohen dhe/ose punojnë në skllavëri për të prodhuar ushqime, të mira, ose pjesë përbërëse.
- Ndërkohë që mund të jenë veshje për dyqane të shtrenjta në perëndim, nxjerrje kobalti për telefonat celularë, vjelje frutash apo perimesh që ne i hamë apo prodhimi masiv i pajisjeve elektronike, trafikimi dhe shfrytëzimi janë të pranishme në zinxhirët që furnizojnë ekonominë tonë .

## SKLLEVËR NË SITUATA KONFLIKTI



### Ushtrim

- Lehtësoni diskutimin në grup.
- Cilat forma të shfrytëzimit mund të ndodhin në zonat e konfliktit?
- Kërkojuni pjesëmarrësve të sjellin shembuj.



### Pikat kryesore të kapitullit

- Lufta ka rezultuar gjithmonë në lëndimin e të pafajshmëve dhe të tyre që nuk janë luftëtarë.
- Gjatë gjithë historisë, komunitete të tëra janë skllavëruar dhe shfrytëzuar, qoftë për punë, qoftë për shfrytëzim seksual - shpesh për të dyja.
- Bota sot nuk është ndryshe. Konfliktet vazhdojnë dhe njerëzit skllavërohen, shpërngulen dhe shfrytëzohen.
- Dy shembuj që vijnë nga një kohë shumë e afërt janë veprimet e Shtetit Islamik dhe të Boko Haram.

## NDAJENI ME GRUPIN:



### RAST PRAKTIK

*"Më rrëmbyen gjashtë muaj më parë kur në fshatin tonë mësynë Boko Harami. Në fillim më çuan në një pyll afër me Kamerunin. Pastaj më kthyen në një makinë seksi. Me radhë, flinin me mua. Tani jam shtatzënë dhe nuk jam në gjendje ta identifikoj babanë e fëmijës.*

*Asabe, moshë 23 vjeçe.*



### Pikat kryesore të kapitullit

- Shteti Islamik
  - ◆ Shteti Islamik mori rob qindra vajza dhe gra nga komuniteti Yazidi.
  - ◆ Shumë prej tyre u përdhunuan dhe u abuzuan fizikisht.
  - ◆ Ishte praktikë e zakonshme që viktimat Yazidi të nxirreshin në ekspozite dhe t'u shiteshin luftëtarëve në tregjet e skllëvërve.
- Boko Haram
  - ◆ Grupi terrorist Boko Haram, që vepron në Afrikën Perëndimore, kanë rrëmbyer qindra gra e vajza të reja.
  - ◆ Viktimat transportohen në kampe në xhungël ku përdhunohen në mënyrë të përsëritur dhe përdoren si skllave seksi si dhe detyrohen të punojnë të gatujnë dhe të pastrojnë.
  - ◆ Është praktikë e zakonshme që vajzat të nxirren në ankand ose të shiten si nuse të luftëtarëve.

## TERRORIZMI

### Ushtrim

- Lehtësoni diskutimin në grup.
- A mund të përfshijë terrorizmi edhe trafikimin e qenieve njerëzore?
- Kërkojuni të sjellin shembuj.



### Pikat kryesore të kapitullit

- Në ditët e sotme organizatat terroriste shfrytëzojnë gra dhe fëmijë si në trajtën e skllëvërve edhe në atë të bashkëshorteve, luftëtareve, madje edhe si kamikaze.
- Ne e dimë se pëlqimi i fëmijës është i pavlefshëm në konceptin juridik në lidhje me të provuarin e trafikimit. Ndaj, kur vajzat adoleshente udhëtojnë në zona konflikti për t'u bërë bashkëshorte ose kur fëmijët përdoren si luftëtarë apo si kamikazë ose synohen të përdoren si të tillë, kjo mund të përshkruhet me të drejtë si trafikim.
- Gjithashtu, ka raportime se ISIS-i ka përdorur viktimat të mbajtura si skllëvër dhe luftëtarë të lënduar për t'u marrë organet.

## PROKURIMI I ORGANEVE

### Pikat kryesore të kapitullit



- Transplanti i organeve është një praktikë e pranuar mjekësore kur organet e një personi të vdekur ose në disa raste, të një personi të gjallë, transplantohen në mënyrë të ligjshme te një tjetër me anë të një operacioni për të shpëtuar ose ndryshuar jetën e një personi.
- Është fakt se kërkesa për organe transplanti është shumë më e madhe se oferta.
- Kjo ka çuar në një situatë ku, shpesh në vendet në zhvillim, të varfrit shfrytëzohen dhe u heqin organet për një shumë relativisht të vogël parash.
- Ka pasur raportime të prokurimit të organeve me pranim nga shteti në disa vende, ku të burgosurve u hiqen organet, ose në zona konflikti ku organizata terroriste si ISIS-i përfitojnë nga prokurimi i organeve duke ua marrë të burgosurve dhe skllëvërve.

## PËRMBLEDHJE

### Pikat kryesore të kapitullit



- Në këtë kapitull eksploruam format më të zakonshme të shfrytëzimit në ditët e sotme si rrjedhojë e trafikimit.
- Kemi parë se si burrat, gratë, dhe fëmijët, që të gjithë mund të jenë viktimë.
- Fakt i përbashkët për të gjithë ata është se njerëzit shfrytëzohen, shpesh në mënyrat më të tmerrshme, për qëllimin e përfitimit financiar nga të tjerë.

05

# Metodat e rekrutimit



## Objektivat e mësimit

Në këtë kapitull do të eksplorojmë elementin kyç të trafikimit të qenieve njerëzore - rekrutimin e viktimës.

### NË FUND TË KËTIJ KAPITULLI:

- Do të vlerësoni dhe kuptoni metodologjitë e ndryshme të rekrutimit që përdorin trafikantët e qenieve njerëzore.
- Do të kuptoni dallimin midis vulnerabilitetit personal dhe atij rrethor dhe si ndodh.
- Do të vlerësoni mënyrën se si trafikantët i përzgjedhin viktimat.

## HYRJE



### Ushtrim

- Në mësim, kërkojuni pjesëmarrësve të risjellin në mend se çfarë janë Veprimi, Mjetet dhe Qëllimi?



### Pikat kryesore të mësimit

- "Veprimi" elementi i parë i trafikimit, në të vërtetë fillimi i përjetimit të viktimës, në mënyrë specifike përfshin rekrutimin e viktimës, si dhe përjetimet e mëvonshme fizike të viktimës, si për Rast praktik transportimi.
- Ky kapitull do të eksplorojë disa prej metodave më të zakonshme që përdorin trafikantët e qenieve njerëzore për të rekrutuar viktimat dhe se si viktimat bëhen pre e bindur ndaj trafikantëve.
- Pra, si i identifikojnë apo "i zgjedhin" viktimat e tyre?

## TRAFIKANTËT

### Pikat kryesore të kapitullit



- Trafikantët e qenieve njerëzore përgjithësisht nuk i zgjedhin viktimat në mënyrë rastësore.
- Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore shpesh vijnë nga situata në vendin e tyre të origjinës ku ata do të dëshironin një jetë më të mirë. Atyre u premtohen më pas rezultate që do t'u përmirësonin cilësinë e jetës.
- Trafikantët kërkojnë në mënyrë proaktive për të identifikuar viktimat të mundshme. Një Rast praktik i zakonshëm është që trafikantët ulen në një bar kafe dhe presin të afrohen vajza të reja për t'i futur në kurth me gënjeshtat dhe mashtrimet e tyre për një jetë më të mirë jashtë vendit.
- Shpesh ata mund të përdorin mekanizma, një kurth, në mënyrë që viktimat e mundshme të vijnë tek ata. Për Rast praktik, vendosin një njoftim në gazetë për punë me pagë të lartë jashtë shtetit.
- Trafikantët e qenieve njerëzore "si gjahtarë" kërkojnë gjithmonë duke shfrytëzuar ndjenjat më të thella, pozitën vulnerabël dhe nevojat dhe dëshirat bazë njerëzore të viktimat e mundshme.



## RAST PRAKTIK

*I pandehuri I.T, veprën penale të trafikimit të personave e kreu në formën e rekrutimit dhe të transferimit të të dëmtuarit dhe të personave të tjerë, duke shfrytëzuar gjendjen e vështirë ekonomike të tyre, me qëllim shfrytëzimin e tyre në forma të tjera shfrytëzimi, duke qenë si e tillë shfrytëzimi për transportimin e lëndës narkotike. Gatishmëria, vullneti i personave të shfrytëzuar, për të shkuar në punën e ofruar nga i pandehuri e personat e tjerë nuk merret parasysh nga gjykata, ndodhur para faktit që rekrutimi u bë duke përfitur nga gjendja e mjerueshme ekonomike e tyre dhe duke e shfrytëzuar atë.*

*Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Nr.3/65/217, viti 2017 ndaj të pandehurit I.T.*

## ÇFARË E BËN NJË VIKTIMË QË TË BJERË PRE E BINDUR Ë TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE?



### Ushtrim

- Kërkojuni pjesëmarrësve që të bëjnë individualisht një listë me gjashtë faktorë që mund ta bëjnë një person që të bëhet pre e bindur e viktimë e trafikimit.
- Ftojini pjesëmarrësit të japin përgjigjet dhe të diskutojnë në grup.



### Pikat kryesore të kapitullit

- Këta janë në të vërtetë "faktorë shtytës dhe tërheqës", ku një trafikant do të shfrytëzojë dëshirat e një personi për t'u larguar nga vendi i tij/saj aktual dhe për të kërkuar një jetë më të mirë. Ju mund të kishit renditur në listë cilindo nga faktorët shtytës dhe tërheqës.
- Megjithatë, ka edhe faktorë të tjerë më personal, apo vulnerabilitet individual të një personi që mund të shfrytëzohen nga një trafikant. Këto marrin rëndësi sidomos në rastin e trafikimit brenda vendit, si në veçanti të fëmijëve.
- Faktorë apo vulnerabilitet personal mund të jenë:
  - ◆ Të qenit viktimë e dhunës në familje.
  - ◆ Të qenit i pastrehë.
  - ◆ Të pasurit varësi nga droga ose alkooli.
  - ◆ Të vuash nga një gjendje e shëndetit mendor.
  - ◆ Të jesh në kërkim të një marrëdhënie të qëndrueshme.
  - ◆ Të kesh një dëshirë për ndërveprim shoqëror dhe ndjesi "përkatësie".
  - ◆ Të kesh vështirësi financiare.

## VULNERABILITETI (OSE NDRYSHE POZITA E DOBËT)



### Pikat kryesore të kapitullit

- Trafikantët janë ekspertë për identifikimin dhe shfrytëzimin e situatës vulnerabël, faktorëve individualë "shtytës dhe tërheqës" të vetë personit.
- Vulnerabiliteti mund të ndahet në dy kategori: "personal" dhe "rrethor".

VULNERABILITETI	
PERSONAL	RRETHANOR
Vulnerabiliteti personal mund të përfshijë:	Vulnerabiliteti rrethor mund të përfshijë:
◆ Të jesh ndryshe nga ata që të rrethojnë	◆ Rrethana të pafavorshme në familje dhe në komunitet
◆ Të mos jesh i/e arsimuar	◆ Ndikime kulturore dashakeqe
◆ Etniciteti dhe kultura	◆ Varfëria
◆ Gjinia	◆ Kontroll shtrëngues/detyrues
◆ Shëndeti mendor	◆ Afrimiteti për qëllime të këqija
◆ Feja	◆ Statusi i imigracionit
◆ Orientimi seksual	◆ Izolimi social
◆ Moshë	
◆ Viktimë e abuzimit fizik ose seksual	
◆ Varësia ndaj alkoolit ose drogës	
◆ I pastrehë	



### RAST PRAKTIK

**Të dhënat e përftuara:** nga prova dokument, Libri i Lindjeve në Spitalin Rajonal ... për vitin 1995, së bashku me kopjen e dokumentit "Çertifikatë Asistencë në Lindje" dhe, me Çertifikatën Familjare të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile ....; nga dëshmia e dëshmitares Xh., sipas të cilës E. e kishte vajzë dhe e braktisi dy ditë pas lindjes, duke e lënë me të atin dhe, e takoi në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçe; nga deklarimi dhe dëshmia e dëshmitares M., sipas të cilës Xh. e braktisi vajzën tre muaj pas lindjes dhe e takoi në moshë të rritur; nga deklarimi i bashkëpandehurit, sipas të cilit E. kishte probleme me babain; nga deklarimi i M., sipas të cilës E. ishte trajtuar keq dhe shfrytëzuar nga babai dhe njerka dhe; nga kallëzimi që E. kishte bërë në Komisaratin e Policisë ... për keqtrajtim dhe dhunë të ushtruar nga babai dhe njerka, të vlerësuara në tërësinë e tyre, provuan faktin e qenies së shtetasës E., në Vitin 2011 e mitur dhe "vulnerabël", jo vetëm për shkak të moshës por edhe për shkak të problemeve familjare dhe trajtimit të saj.

*E lindur në datë ...1995, jashtë martese, ajo u braktis nga nëna e saj dhe u rrit në shtëpinë e babait, ku u keqtrajtua dhe u dhunua nga ai dhe njerka.*

*Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Nr.06/87, viti 2016 ndaj të pandehurit M.O.*

## METODA TË ZAKONSHME REKRUTIMI



### Pikat kryesore të mësimt

- Metodatat që përdorin trafikantët e qenieve njerëzore për të futur në lak viktimat tyre përgjithësisht mendohen mirë prej trafikanteve dhe shpesh janë të besueshme.
- Metodatat e rekrutimit fokusohen jo vetëm te faktorët shtytës dhe tërheqës të vetë individit por edhe kërkojnë të shfrytëzojnë pozitën vulnerabël të individit.
- Për të mashtruar viktimat, trafikantët përdorin disa mashtrime të zakonshme.
  - ◆ Qasje personale e një miku, fqinji, të afërmi, madje një prindi.
  - ◆ Njoftim punësimi.
  - ◆ Agjenci punësimi të kontrolluara nga Banda të Krimet të Organizuar.
  - ◆ Mashtrime duke u hequr si i dashur.
  - ◆ Trafikim brenda vendit - banda të rrugës.

## MIQTË DHE FAMILJA



### Pikat kryesore të mësimt

- Vështirë të besohet, por një numër domethënës viktimash "rekrutohen" ose mashtrohen nga njerëz që i njohin. Kjo mund të realizohet nga miq, fqinjë, anëtarë të afërt të familjes, madje edhe prindërit.
- Një taktikë që përdorin zakonisht trafikantët është që e lejojnë viktimën të jetë e lirë nga shfrytëzimi i tyre, me kusht që të rekrutojnë viktimat të tjera për trafikantët. Viktima fillestare kthehet në shtëpi ku i ndihmojnë trafikantët të mashtrojnë viktimat të tjera të mundshme. Viktimat që rikthehen në shtëpi përdoren shpesh nga trafikantët si reklama për sukses.
- Ky është realiteti ku në disa situata prindërit mund t'u jenë borxhli bandave të krimet të organizuar, me anët të detyrimit për shkak të borxhit, ata lejojnë që t'ua marrin fëmijët dhe t'i çojnë jashtë shtetit për shfrytëzim.
- Megjithatë, është edhe një situatë sa trishtuese aq edhe e vërtetë ku në disa raste prindërit janë bashkëpunëtorë me trafikantët dhe me dëshirën e tyre lehtësojnë trafikimin e fëmijëve të tyre për përfitimet personale.
- Shfrytëzimi mund të jetë në forma nga më të ndryshmet: seksual, punë e detyruar shtëpiake, për punë dhe për krime (si lypja, vjedhja, kultivimi i kanabisit, ose trafikimi i substancave narkotike).



## SHFRYTËZIM PËR LYPJE



### RAST PRAKTIK

*Deklarimi i të miturit R.T 12 vjeç “Para disa ditësh isha duke luajtur me shokët pranë shtëpisë në zonën e B., në T. Aty është afruar një djalë, i cili së bashku me një tjetër më futën në makinë me zor. Gjatë tërheqjes, nga forca e ushtruar, kam marrë disa dëmtime fizike. Ata persona ishin të rritur, rreth të 30-ve. Më pas, më kanë lënë të lidhur në “Sheshin .....” dhe aty erdhën dy persona të tjerë të cilët më zgjidhën dhe më lanë të eci i lirë. Në atë kohë më është prezantuar një grua me emrin B. së bashku me një djalë, e cila më ka marrë dhe më ka çuar te autobuzi i S. duke u ulur në fund të tre. Gjatë rrugës jam ndier keq. Kur erdhëm në S., B. më nxori për të lypur nëpër lokale të ndryshme në S. Gjatë ditës dilja për të lypur dhe lekët ia jepja B., e cila vetëm në darkë më jepte për të ngrënë”.*

*Rasti është identifikuar dhe kthyer në familje. Personi i dyshuar për trafikim është mbajtur nën arrest me burg për trafikim të mituri.*



### Ushtrim

- Lehtësoni diskutimin në grup për pyetjet:
  - ◆ Shfrytëzimi i fëmijëve për lypje nga prindërit ose persona të tjerë përbën trafikim të fëmijëve?
  - ◆ Në rast se fëmija shfrytëzohet për lypje brenda vendit, kemi elementë të veprës penale të trafikimit?
  - ◆ Përbën trafikim shfrytëzimi për lypje i personave madhorë me paaftësi mendore?



### Gjykata E Lartë, Kolegji Penal, Vendim Njësues 217, Viti 2022

*Kodi ynë penal ka përfshirë tek vepra penale e keqtrajtimit të të miturit edhe keqtrajtimin nga prindërit, familjarët por dhe rastin e detyrimit të fëmijëve për të punuar apo lypur.*

*Në rastin e parë dallimi kryesor ndërmjet këtyre dy dispozitave trafikimi, neni 128/b, dhe keqtrajtimi i të miturit neni 124/b është subjekti aktiv i veprës penale, që në rastin e veprës penale ‘keqtrajtimi i të miturit’ është i posaçëm: prindi, kujdestari ose personi që është përgjegjës për rritjen dhe edukimin e tij.*

*Në rastin e veprës penale “trafikimi i të miturve”, subjekti aktiv është i përgjithshëm, por mund të jetë edhe një subjekt i posaçëm, personi që ka për detyrë të kujdeset për të miturin. Ky rast i fundit, evidentohet në kryerjen e trafikimit përmes “shitjes së të miturit” si një formë e trafikimit të tyre, që është një veprim i cili në praktikë, është realizuar edhe nga prindi, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor.*

*Shfrytëzimin për punë, shtytjen për të siguruar të ardhura, apo për të lypur Kodi ynë Penal i përfshin sërish tek vepra penale e keqtrajtimit të të miturit pag. 2 i nenit 124/b i cili parashikon: Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja, ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor/ fizik apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Nëse autori i detyrimit për shfrytëzim në punë, punë të detyruar apo lypje është një person tjetër që nuk është prindi ose i afërm i të miturit atëherë kemi veprën penale të trafikimit në njërin nga format e saj. Këto norma mbrojnë fëmijët nga kryerja e këtyre veprimeve edhe kur ato kryhen nga prindërit.*

## NJOFTIM PUNËSIMI

### Pikat kryesore të mësimit

- Një metodë tjetër e zakonshme që përdorin trafikantët për "rekrutimin" e viktimave është mashtrimi me anë të njoftimeve të punësimit në dukje të vërteta në gazeta dhe/ose online.
- Pagesa që ofrohet shpesh është konkurruese dhe punësimi ofrohet përgjithësisht në një vend të huaj.
- Njoftimet janë tejet të besueshme, jepen numra telefoni dhe madje ofrohet kontaktim personalisht. Shpesh, "agjenti" është një grua çka mundëson që viktima e mundshme të jetë më pak vigjilente dhe krijon një mjedis besimi dhe respekti.
- Shfrytëzimi me anë të kësaj metode shënjestron burra, gra dhe fëmijë adoleshentë.
- Llojet e shfrytëzimit që arrihen me këtë metodë janë:
  - ◆ Prostitucioni
  - ◆ Shërbimet e detyruara shtëpiake
  - ◆ Puna e detyruar: ndërtim, peshkim, bujqësi



### **"2600 paund për kontratë dhe vizë në Angli"**

**Në redaksinë e Fiks Fare mbërritën 3 denoncime, për një zyrë e cila reklamonte se ofronte viza pune për në Angli. Qytetarët denoncuan se punonjësit e kësaj zyre iu kërkonin deri në 2600 paund për kontratë pune dhe vize 3-vjeçare për në Londër, Mançester dhe Liverpool.**

<https://www.balkanweb.com/2600-paund-per-nje-vize-ne-angli-perdorin-rrjetet-sociale-dhe-pretendojne-se-bashkepunojne-me-agjenci-angleze-si-po-mashtrohen-shqiptaret-nga-kompanite-fantazme/>

## I DASHURI I RREMË



### Pikat kryesore të mësimimit

- Një prej konceptimeve të gabuara të zakonshme në trafikimin e qenieve njerëzore është se ata që mashtrohen dhe shfrytëzohen janë të varfrit. Ndonëse varfëria është një faktor, ajo nuk është absolutisht e vetmja.
- Një mashtrim i zakonshëm në raste shfrytëzimi seksual është mbiquajtur "i dashuri", një i dashur i rremë.
- Ky rast ndodh kur një burrë, pjesë e rrjetit të trafikimit, gjuan në mënyrë aktive për vajza e gra të reja, për të zënë miqësi me to e të bëhet i dashuri i tyre.
- Mashtrimi ndodh përgjatë një periudhe kohe ku viktima krijon besim të plotë të "i dashuri" i saj. Viktima joshet dhe më pas bie pre.

### SHFRYTËZIMI NDËRKOMBËTAR

- Në një moment të caktuar, "i dashuri" e fton viktimën t'i bashkohet atij jashtë shtetit, duke i ofruar një jetë më të mirë, me më shumë adrenalinë, më fitimprurëse.
- Gjatë udhëtimit, apo në destinacion, shumë viktima kanë raportuar se janë përdhunuar, disa herë nga shumë burra.

### SHFRYTËZIMI BRENDIA VENDIT

- Në rastin e trafikimit brenda vendit, viktima që është joshur e mashtuar nga "i dashuri" me dhurata dhe vëmendjen e treguar ndaj saj, mund ta gjejë veten që e lëvizin në vende të ndryshme, brenda qytetit apo në të gjithë vendin.
- I dashuri i kërkon asaj më pas që të bëjë seks me burra të tjerë, shpesh me shumë të tjerë.



### RAST PRAKTIK

*E mitura B. e larguar disa herë nga banesa e saj dhe e shpallur në kërkim policor, nëpërmjet komunikimeve në rrjetin social Facebook ka krijuar njohje dhe miqësi me shtetasen F. (e thirrur A. e vogël), banore e fshatit G.j, E. që ka lidhje shoqërore me të pandehurin P., i pandehuri ka qenë i interesuar për t'u njohur me të dëmtuarën dhe janë takuar mes tyre në E. me ndërmjetësinë e F.*

*Duke qenë në moshë më të madhe (rreth 26 vjeç) dhe duke shfrytëzuar gjendjen e të dëmtuarës B. tejet vulnerable, i pandehuri nëpërmjet mashtrimit se kishte për qëllim lidhje martesë mes tyre e ka zhvendosur në banesën e tij në G.j, E. duke bashkëjetuar me të dhe e ka shfrytëzuar për qëllime prostitucioni për një periudhë rreth 8 muaj, kohë gjatë së cilës ka bërë edhe prezantimin "ceremonial" të familjeve respektive, në funksion të këtij qëllimi.*

*I pandehuri P. ndërmjetësonte gjetjen e shtetasve (klientë) për të kryer marrëdhënie seksuale me pagesë me të miturën B., të cilën e transportonte në vendtakimet me klientët me automjetin dhe përfitonte vlera monetare nga*

*pagesa e këtij akti prej tyre.*

*I pandehuri P. e nxirrte të miturën të kërcente për të fituar vlera monetare edhe tek Bar "...", në G., lokal që frekuentohej shumë nga shtetas të huaj, punëtorë në Hidrocentralin në ndërtim në fshatit B.*

*Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Nr 135, viti 2016 ndaj të pandehurit P.Ç.*

## TRAFIKIMI I BRENDSHËM - BANDAT DHE DROGA

### Pikat kryesore të kapitullit

- Në të gjithë botën bandat kriminale rekrutojnë fëmijë për të vepruar për llogari të tyre.
- Veprimtaria e tyre përfshin shpërndarje droge, transport të parave dhe akte dhune. Shpesh, vajzat rekrutohen të përdoren si për vepra kriminale edhe për shfrytëzim seksual.

Sipas të dhënave zyrtare në Shqipëri nga 110 viktimat të mundshme trafikimi, 14 raste janë të mitur të shfrytëzuar për të kryer veprimtari (Burimi: Ministria e Brendshme, Raporti Vjetor për Realizimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Masat kundër Trafikimit të Personave).

### FËMIJËT

- Për rekrutim shënjestrohen fëmijë që mund të jenë edhe 11 vjeç. Ata u binden udhëzimeve të më të rriturve por edhe mbartin rrezikun e arrestimit dhe ndjekjes penale, duke mbrojtur kështu trafikantët.
- Mbani parasysh - fëmijë është kushdo person nën 18 vjeç dhe ata nuk mund të japin pëlqimin për shfrytëzimin e tyre, edhe nëse besojnë se me dëshirë i thonë "po" detyrës që ua ka dhënë shfrytëzuesi.



### RAST PRAKTIK

*D. është 12 vjeç dhe jeton në E. Deri në moshën 9 vjeç ka marrë shërbim rezidencial pranë një institucioni jopublik pasi nëna e tij ndërroi jetë dhe për shkak të kushteve social ekonomike i ati nuk mund të kujdesej për të. Pas kthimit në familje, në moshën 9 vjeçare, D. nuk frekuenton më shkollën, largohet në mënyrë të vazhduar nga banesa dhe shoqërohet me persona të rritur. Pjesën më të madhe të ditës e kalon në rrugë.*

*Në shoqërimin e bërë në komisarjat nga skuadra e terrenit e punonjësve socialë të Bashkisë, rasti tregoi mbi lëndën narkotike të cilën e shiste gjatë pasditeve nëpër baret e qytetit si dhe shuma prej 300 euro të cilën e kishte në xhep. Gjatë intervistimit djali refuzoi të tregojë nga e merr lëndën narkotike dhe shfaq frikë të vazhdueshme.*

*Rasti është marrë në mbrojtje të menjëhershme nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës.*

## REKRUTIMI

- Rekrutimi është një proces i joshjes me mashtrim duke dhënë dhurata, ushqime, veshje dhe/ose një sens përkatësie dhe mbrojtjeje. Viktimave shpesh u ofrohen mundësi për të fituar para që nuk mund të arrihen në mënyrë të ligjshme.
- Pas "rekrutimit", viktimat e gjejnë veten në borxh, të kërcënuar dhe të sulmuar nga shfrytëzuesit. Këto janë mekanizma kontrolli për të siguruar bindje në vazhdimësi.

## SKLLEVËR TË KONFLIKTEVE

### Pikat kryesore të kapitullit

- Në zonat e konfliktit në zona të ndryshme të botës, burrat, gratë dhe fëmijët merren me forcë nga palët ndërluftuese dhe shfrytëzohen.
- Përgjithësisht, burrat dhe djemtë i vendosin të luftojnë, ndërsa gratë dhe vajzat përdoren si sklleve shtëpie dhe seksi.
- Gratë dhe vajzat e moshës që mund të lindin fëmijë shpesh "martohen" me luftëtarët.
- Në disa zona konflikti, funksionojnë tregjet fizike të skllëve ku viktimat nxirren në paradë dhe i shiten atij që ofron çmimin më të lartë.
- Shembujt më aktualë për këtë janë Boko Haram në Afrikën Perëndimore dhe ISIS në Siri dhe Irak, por gjithsesi këta nuk janë të vetmit.
- Çdo burrë, grua, ose fëmijë që merret nga shtëpia e vet dhe detyrohet të kryejë veprimtari si detyrimi për t'u martuar me dikë, detyrimi për të kryer seks, detyrimi për të kryer punë shtëpie apo detyrimi për të luftuar është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore.

## PËRMBLEDHJE

### Pikat kryesore të kapitullit

- E nisëm këtë kapitull duke theksuar se "rekrutimi" i viktimave është pjesë e procesit të trafikimit, të cilin Protokollin e Palermos e konsideron si "Veprimi".
- Mënyra se si arrihet rekrutimi konsiderohet si "Mjetet".
- Ky kapitull jep disa shembuj praktikë për mënyrën e rekrutimit të viktimave nëpër botë.
- Në kapitullin e radhës, do të shikojmë mekanizmat e kontrollit ku elementi "Mjete" i Protokollit zë një vend qendror.

06

# Metodat e kontrollit



## Objektivat në këtë kapitull

### Pikat kryesore

- Në këtë kapitull, do të eksploroni elementin e konceptit të trafikimit të qenieve njerëzore, mënyrën se si trafikantët shpesh kontrollojnë viktimat e trafikimit.
- Në fund të këtij kapitulli:
  - ◆ Do të keni njohuri bazë për mekanizmat e kontrollit që ushtrojnë trafikantët mbi viktimat.
  - ◆ Do të njihni mënyrat e ndryshme se si trafikantët kontrollojnë viktimat.
  - ◆ Do të kuptoni se si Protokoli i Palermos i përkufizon metodat e kontrollit.

## HYRJE



### Pikat kryesore të këtij kapitulli

- A janë gjithmonë të kyçura dyert e ambienteve ku mbahen viktimat?
- A nevojitet të jenë?
- Ka një perceptim të gabuar se të gjitha viktimat e trafikimit qëndrojnë vetëm të mbyllura në vendin ku banojnë, i rrahin, dhe i detyrojnë të bëjnë "punën". Në shumë raste ky është një perceptim i gabuar. Kontrolli i viktimave mund të jetë një proces shumë më i padukshëm.
- Procesi i mbajtjes nën kontroll të viktimës dhe i thyerjes së vullnetit mund të fillojë që me udhëtimin e tyre drejt "mundësisë së re".
- Në këtë kapitull, do të eksplorojmë disa prej mekanizmave të kontrollit që përdorin trafikantët, duke ju mundësuar shfrytëzimin e viktimave, shpesh për periudha shumë të gjata.



## MJETET

### Pikat kryesore në këtë kapitull

- Nga kapitulli i parë mund të kujtoni se përkufizimi i trafikimit të qenieve njerëzore përfshin Veprimin, Mjetet dhe Qëllimin.
- "Mjetet", elementi i dytë i trafikimit, është në të vërtetë mekanizmi që përdorin trafikantët si për të rekrutuar ashtu edhe për të garantuar bindje nga ana e viktimës.
- Kjo mund të arrihet nëpërmjet elementeve të vëna në dukje të "Mjetet" si dhe nëpërmjet taktikave të tjera më të fshehta.

## KOMBINIM I MJETEVE TË KONTROLLIT

- Në vend që të mbështeten në një mekanizëm të vetëm kontrolli, trafikantët përdorin shpesh disa masa kontrolli.
- Është e rëndësishme të kuptojmë se meqë viktima nuk është dhunuar nuk do të thotë se nuk po mbahen nën kontroll.
- Kombinimi i mjeteve të kontrollit do të variojë në varësi të:
  - ◆ Viktimës individuale
  - ◆ Llojit të shfrytëzimit
  - ◆ Fazës së procesit të trafikimit
  - ◆ Natyrës së vendndodhjes
  - ◆ Mundësive që paraqiten nga rrethanat
  - ◆ Bindja ose sjellja e viktimës

## FAZAT E KONTROLLIT

Mekanizmat e kontrollit zgjidhen nga trafikantët e në varësi të sjelljes së viktimës ose gjatë udhëtimit pasi është realizuar rekrutimi nëpërmjet mashtrimit.



### Ushtrim

- Ndajini pjesëmarrësit në 8 grupe.
- Secilit grup jepini një copë letër ku është printuar një nga sa më poshtë.
- Si grup pjesëmarrësish, kërkojuni që të gjithë bashkë t'i rendisin metodat sipas radhës dhe t'i prezantojnë.

### MASHTRIMI

*"Udhëtimi do të jetë i gjatë dhe i vështirë po me të mbërritur çdo gjë do të jetë OK. Për punën çdo gjë në rregull dhe puna po të pret/ Siç të thashë, paga është shumë e mirë."*

### BASHKËPUNIMI

*"Së shpejti do të kalojmë kufirin. Tani, që të mos të të kapin, duhet të tregohesh e qetë dhe pa folur. Nëse na ndalojnë, thuaju atë që të mësuam ne të thuash."*

### DETYRIMI PËR SHKAK TË BORXHIT

*"Mos u shqetëso për paratë e udhëtimit. Na i kthe nga rroga kur të kesh arritur atje."*

### KËRCËNIME TË NËNKUPTUARA

*"Puna që të premtuan nuk është më e disponueshme. Megjithatë, mos u shqetëso. Të kemi gjetur punë tjetër. Po duhet të bësh si të të thonë për të na kthyer borxhin ose do të futesh në telashe!"*



**KËRCËNIME PËR DHUNË**

"Nuk po punon aq sa duhet dhe gjithmonë ankohesh. Mbylle gojën, puno më fort dhe bëj ç'të të thonë, ndryshe do hash dru. Ti e di mirë që nuk ta kursejmë."

**RRITJE E DETYRIMIT PËR SHKAK TË BORXHIT**

"Rrugën ta paguam ne. Të siguruam për të ngrënë e për të fjetur. Tani këtu nuk ka më punë. Prandaj do të shkosh diku tjetër. Transferimi do të ketë shumë më shumë kosto, dhe do të na i paguash shpenzimet mbrapsht bashkë me interesin."

**LËSHIME**

"Duke parë që ke punuar shumë dhe nuk ka ne hapur telashe, mund të bësh një telefonatë me familjen. Po punove kështu dhe sillesh mirë, do të tregojmë kujdes për ty dhe do të të japim telefon që t'i kontaktosh kur të duash."

**PËRDORIMI I DHUNËS**

"Të paralajmëruam po s'na dëgjove. E ke hak drurin. Para se të mos bindesh prapë, mbaje mend se herës tjetër do të jetë më keq, do të të bëjmë Rast praktik. Mos harro se e dimë ku banon dhe ku shkon në shkollë motra jote e vogël."

**KUJTESË PËR TRAJNUESIN:**

Renditja e duhur është:

- ◆ Mashtrimi
- ◆ Bashkëpunimi
- ◆ Detyrimi për shkak të borxhit
- ◆ Kërcënime të nënkuptuara
- ◆ Kërcënime për dhunë
- ◆ Rritje e detyrimit për shkak të borxhit
- ◆ Lëshime
- ◆ Përdorimi i dhunës

**RAST PRAKTIK**

**Me veprimet e kryera prej tyre rezultoi se të pandehurit A. dhe I. e kanë rekrutuar të dëmtuarën, i pandehuri A. e ka mbajtur në një banesë e ka mbikëqyrur duke kontrolluar lëvizjet e saj, më tej nëpërmjet të pandehurit Q. kanë marrë masa për pajisjen e saj me pasaportë për të siguruar mundësinë e saj të lëvizjes për të udhëtuar në Itali me qëllim shfrytëzimin për prostitucion.**

**Në deklaratimet e saj e dëmtuara sqaron mënyrën sesi A. dhe I., bashkëpunonin me njëri-tjetrin për të gjetur klientët për vajzat, lekët që merrnin për çdo raport seksual, e dëmtuara M. ka qenë prezent në shumë biseda që të pandehurit kanë bërë me njëri-tjetrin në lidhje me vajzat që ata shfrytëzonin.**

**Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Nr. 22/162, viti 2016, ndaj të pandehurve Q.R, A.R, I.Gj.**



## Ushtrim Dhuna fizike

- Bëjini pyetjen grupit: "A është e vërtetë që vetëm gratë dhe vajzat dhunohen seksualisht si viktimat të trafikimit?"
- Ftojini grupin të japë përgjigje dhe diskutoni.



## Pikat kryesore në këtë kapitull:

- Burrat, gratë dhe fëmijët që të gjithë mund të dhunohen fizikisht dhe seksualisht gjatë trafikimit të tyre.
- Edhe me anë të mashtrimit, kërcënimeve dhe shtrëngimit viktimat dhunohen nga trafikantët si seksualisht edhe fizikisht.
- Dhunimi nuk ka si qëllim vetëm dëmtimin e viktimës apo kënaqësisë seksuale të trafikantëve.
- Ai thyen shpirtin dhe vullnetin e viktimës.
- Gjithashtu, shkakton frikë te viktimat. Frikë se çfarë mund t'u ndodhë përsëri por edhe se çfarë mund t'i ndodhë familjes nëse largohen apo nuk binden.

## PËRMBLEDHJE



## Pikat kryesore të kapitullit

- Në fillim të këtij kapitulli, ne shtruan pyetjet...
  - ◆ "A janë gjithmonë të kyçura dyert e ambienteve ku mbahen viktimat?"
  - ◆ A nevojitet të jenë?"
- Pas përfundimit të këtij kapitulli, ju e kuptoni tashmë se mekanizmat e kontrollit që ushtrojnë trafikantët mbi viktimat, disa herë janë të dukshme, mizore, dhe fizike ndërsa disa herë të tjera janë shumë të kamufluara.
- Trafikantët vazhdojnë të përdorin frikë, shtrëngim, besim, besnikëri, bindje dhe shpresë me qëllim që të vazhdojnë të kontrollojnë dhe shfrytëzojnë viktimat.
- Shkalla e kontrollit që ushtrohet mbi viktimën shpesh nënkupton se trafikantët nuk kanë të nevojshme mbajtjen e viktimave në ambiente të mbyllura.

*Për një informacion më të hollësishëm mbi metodat e kontrollit dhe çështjen e pëlqimit të viktimës, referojuni Manualit të OSBE-së "Trafikimi i Qenieve Njerëzore. Manual për Punonjësit e Policisë", kapitulli 1.6. <https://www.osce.org/files/f/documents/8/f/513298.pdf>*

07

Trafikimi i  
fëmijëve



## Objektivat e kapitullit

Në këtë kapitull do të eksploroni komponentët kyç të trafikimit të fëmijëve, duke ju mundësuar të kuptoni bazat e çështjeve kryesore.

Në fund të këtij kapitulli:

- Do të kuptoni elementët që formojnë "trafikimin e fëmijëve" sipas Protokollit të Palermos.
- Do të njihni se fëmijët nuk mund të japin pëlqim për shfrytëzimin e tyre.
- Do të kuptoni se fëmijët gëzojnë të drejta të posaçme.

## HYRJE



### Pikat kryesore të kapitullit


- Në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimin, fëmijët duhet të konsiderohen gjithmonë veçmas dhe në mënyrë dallueshme nga të rriturit.
- Ata kanë nevojat e tyre të posaçme për jetesë dhe për siguri. Protokollit i Palermos, dhe rrjedhimisht pjesa më e madhe e legjislacionit vendas, shprehin shumë qartë dallimet kryesore midis viktimave fëmijë dhe viktimave të rritur të trafikimit të qenieve njerëzore.
- Shpesh, duke qenë nën kontrollin ose të drejtuar nga persona të rritur (qoftë prindërit e tyre apo persona të tjerë) nuk e njohin veten si viktimë. Për këtë arsye, duhet që të gjithë të ndërmerim veprime proaktive për identifikimin dhe mbrojtjen e tyre. Profesionistët kanë detyrimin si ligjor edhe moral për ta bërë këtë.
- Mbani parasysh, një person nën moshën 18 vjeç është GJITHMONË fëmijë. Ata mund të jenë 7 vjeç, mund jenë 17 vjeç. Por, kur vjen puna te trafikimi i qenieve njerëzore, nëse janë nën moshën 18 vjeç, janë fëmijë.

## TRAFIKIMI I FËMIJËVE



### Pikat kryesore të kapitullit

- Është e rëndësishme të kuptojmë se, në lidhje me fëmijët dhe se me elementët e veprës penale që fëmija të quhet viktimë e trafikimit, Protokollit i Palermos i redukton këto elementë kryesorë nga tre në dy.
- Për trafikimin e fëmijëve, është e nevojshme të plotësohen VETËM dy elementë:
  - ◆ Veprimi
  - ◆ Qëllimi
- Kjo për arsye se fëmija nuk mund të japë pëlqimin për shfrytëzimin e tij apo të saj. Kjo do të thotë se elementi i "mjetit", mënyra me të cilën është detyruar, shtrënguar, mashtruar, etj. fëmija nuk zbatohet në këtë rast.
- Sigurisht, këto elemente të "mjetit" mund të ndodhin edhe në rastin e një fëmije, por aspekti i rëndësishëm është se fëmija është viktimë e trafikimit edhe në mungesë të "mjetit".
- Fëmija nuk mundet ASNJËHERË të japë ligjërisht pëlqimin për shfrytëzimin e tij apo të saj.



### RAST PRAKTIK

*Në një rast të hetuar nga Drejtoria Vendore e Policisë T..., një vajzë 13 vjeç nga një zonë periferike e T... largohej për ditë të tëra nga banesa ku jetonte me mamanë dhe motrën më të vogël dhe rrinte në shoqërinë një vajze dhe djali të rritur. Këta i kishte njohur në rrjetet sociale dhe i takonte rregullisht në lokale larg banesës. Të dy i kishin ofruar të shpërndante për ta substanca narkotike në zonën e B. në T. dhe në D. Në vendet ku shpërndante substancat e transportonin djali dhe vajza e rritur ose një mik tjetër i tyre. Gjatë intervistës së vajzës në komisarjat në prani të Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës, lindi dyshimi se e mitura mund të jetë dhe e shfrytëzuar seksualisht. Rasti po hetohet dhe vajza është referuar për mbrojtje në një strukturë të mbrojtjes sociale si viktimë trafikimi.*



### Pikat kryesore të kapitullit

- Çdo ditë në vende të ndryshme të botës, ka fëmijë që shfrytëzohen për lypje, për vjedhje apo për krime të tjera si shpërndarja e substancave narkotike, ndërkohë që duhet të jenë të mbrojtur, të marrin arsimim, dhe të mos shfrytëzohen për të përfituar të tjerët, qofshin këta edhe pjesëtarë të familjes.

### Pikat kryesore të kapitullit

- Në rastet kur kemi të bëjmë me viktimë të mundshme të trafikimit që janë fëmijë, është e rëndësishme të mbahet parasysh sa më poshtë:
  - ◆ Fëmijët nuk mund të japin pëlqimin për shfrytëzimin e tyre.
  - ◆ Shikoni të gjitha rrethanat.
  - ◆ Pyeteni veten - a duhet që një fëmijë të bëjë atë gjë, në atë vend, në atë kohë, në ato kushte?
  - ◆ Ju mund të keni detyrimin ligjor dhe profesional, por ne të gjithë kemi detyrimin moral për t'i mbrojtur fëmijët.

- ◆ Mos u mashtroni nga justifikimet.
- ◆ Të gjithë fëmijët kanë të drejta themelore, përfshirë të drejtën për të qenë të sigurt, të marrin arsimim dhe të kenë shanse në jetë.
- ◆ Fëmijët nuk duhet të vendosen në rrezik dhe të përdoren si gjenerues të ardhurash për të tjerë.
- ◆ Përvoja na tregon se shpesh shfrytëzuesit i mësojnë fëmijët se çfarë të thonë. Kjo mund të përfshijë nga dhënia e emrave të rremë deri te një skenar i detajuar apo modele gënjeshtresh.



## RAST PRAKTIK

*Rasti i fëmijës E.K, djalë 13 vjeç, menaxhohet prej disa muajsh nga Punonjësja për Mbrojtjen e Fëmijëve e njëjës prej Njësive Administrative në T. Fëmija shoqërohet shpesh në komisariate të ndryshme të qytetit T. për shkak se përfshihet në vepra të ndryshme penale, kryesisht vjedhje në bashkëpunim me të mitur të tjerë. Vetëm në njërin komisarjat. Në pak muaj janë bërë më shumë se 50 kallëzime ku është i përfshirë ky i mitur si autor. Për shkak të moshës ai nuk mund të procedohet penalisht.*

*Nga vlerësimet e bëra nga specialistët që kanë qenë në kontakt me fëmijën, ka prova të mjaftueshme se fëmija është objekt shfrytëzimi nga fëmijë dhe të rritur të tjerë për të vjedhur dhe dyshohet se mund të jetë dhe i abuzuar seksualisht.*

*Fëmija është braktisur që në vogëli nga prindërit, është rritur nga gjyshërit nga ana e babait, ndërkohë që me nënën nuk ka marrëdhënie, madje as fytyrën nuk ia kujton. Sipas Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës nëna jeton në një vend të Bashkimit të Evropian. Nga verifikimet e bëra në regjistrin e gjendjes civile, rezulton se fëmija është me atësi të panjohur. Rrjedhimisht nuk mund t'i kërkohet babait të tij të mbajë përgjegjësi ligjore për fëmijën. Gjendja civile e fëmijës është në një qytet tjetër të Shqipërisë. Ai e ka braktisur shkollën që në klasë të katërt. Pavarësisht përpjekjeve të punonjësve për shoqërimin e fëmijës në shkollë, bashkëpunimit me gjyshen dhe mësuesit, bashkëpunimin me fëmijët e tjerë të shkollës, fëmija nuk u rikthye në shkollë. Fëmija ka probleme me sjellje, konsumon lëndë narkotike, largohet shpesh nga shtëpia dhe nuk i bindet autoriteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve.*

08

---

# Identifikimi i viktimës



## Objektivat e kapitullit

Në këtë kapitull do të eksploroni komponentët kryesorë të trafikimit të qenieve njerëzore, duke ju mundësuar të kuptoni bazat e çështjeve kryesore.

Në fund të këtij kapitulli, pjesëmarrësit:

- Do të kuptojnë në mënyrë praktike indikatorët e trafikimit.
- Do të kuptojnë sfidat për identifikimin e viktimave të mundshme dhe se si t'i kapërcejnë ato.
- Do të vlerësojnë rëndësinë e kontaktit të parë me një viktimë të mundshme dhe të kenë njohuri bazë për strategjitë e suksesshme për kontaktin e parë.
- Do të kuptojnë rëndësinë e mbështetjes praktike dhe të efektshme për viktimën.

## HYRJE

### Pikat kryesore të kapitullit

- Kushdo ka të paktën përgjegjësinë morale dhe shoqërore për të siguruar që mund të dallojnë indikatorët që një person është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore.
- Shumë profesionistë kanë detyrimin ligjor për të qenë në gjendje të dallojnë indikatorët dhe më pas të bëjnë diçka për këtë.
- Viktimat mund të mos jenë të gatshme të tregojnë, ndoshta nuk e shohin veten si viktimë ose kanë frikë se mund të ndërshkohen nga abuzuesit e tyre. Viktimat mund të mos dallohen gjithmonë si të tilla nga ata që kontaktojnë me ta.
- Për identifikimin e viktimave shpesh ka sfida domethënëse. Ka shumë arsye për këtë. Por, një fakt është i vërtetë: nuk ka një buton magjik... si për viktimën që të kërkojë ndihmë ose për të tjerë që t'i identifikojnë.
- Në këtë kapitull, do të eksplorojmë aspekte kyçe të identifikimit të viktimave të trafikimit dhe disa prej sfidave.



Për pjesëmarrësit, shfaqni citimin e mëposhtëm:

***“Ju punoni me njerëz që kanë qenë në një mjedis ku ishin si skllavë.... Tani u duhet të mësojnë se janë në një mjedis ku ata janë njerëz.”***

Një i mbijetuar i trafikimit të qenieve njerëzore



## Ushtrim

- Diskutoni në grup të madh se çfarë donte të thoshte i mbijetuari me atë që tha?
  - ◆ Nxirrni aspektet kyçe të të qenit skllav, dhe pse nuk ndiheshin njerëz.





## IDENTIFIKIMI I VIKTIMAVE

### Pikat kryesore të kapitullit

- Mund të duket një pyetje më se e qartë, por në të vërtetë, e kujt është përgjegjësia për identifikimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore?

Për një informacion më të hollësishëm mbi treguesit e trafikimit të qenieve njerëzore, referojuni Manualit të OSBE-së “Trafikimi i Qenieve Njerëzore. Manual për Punonjësit e Policisë”, kapitulli 2.  
<https://www.osce.org/files/f/documents/8/f/513298.pdf>



### Ushtrim

- Kërkojuni pjesëmarrësve që individualisht, të rendisin sa më shumë profesione, që kanë përgjegjësi për të qenë në gjendje të identifikojnë viktimat të trafikimit.
- Në grup të madh, diskutoni pyetjen, duke i ftuar pjesëmarrësit të marrin pjesë dhe të ndajnë përgjigjet e tyre.



### Pikat kryesore të kapitullit

- Të gjithë kemi përgjegjësinë morale për të dalluar indikatorët e trafikimit të qenieve njerëzore.
- Shumë profesione kanë detyrimin ligjor për të qenë në gjendje të dallojnë indikatorët dhe më pas të bëjnë diçka për këtë.
- Profesionet kryesore që do të jenë në linjën e parë të dallimit të shenjave të trafikimit janë:
  - ◆ Punonjësit e agjencive ligjzbatuese
  - ◆ Punonjësit e kufirit
  - ◆ Punonjësit socialë
  - ◆ Mësuesit
  - ◆ Zyrtarët e qeverisjes vendore
  - ◆ Avokatët
  - ◆ Profesionistët e kujdesit shëndetësor
  - ◆ Pronarët e banesës
  - ◆ Zyrtarët e ambasadës
  - ◆ Inspektorët e tatimeve
  - ◆ Agjencitë e punësimit
  - ◆ Punonjësit e qendrës së ndalimit të migrantëve të parregullt
  - ◆ Në disa raste dhe ushtria

Për një informacion më të hollësishëm mbi Identifikimin, referojuni Manualit të OSBE-së “Trafikimi i Qenieve Njerëzore. Manual për Punonjësit e Policisë”, kapitulli 3.2

<https://www.osce.org/files/f/documents/8/f/513298.pdf>

## SI DUKET NJË VIKTIMË E TRAFIKIMIT?

### Pikat kryesore të kapitullit

- Një prej aspekteve më të vështira lidhur me viktimat të trafikimit është dallimi se kush mund të jetë një viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore.
- Gjëja më e keqe që mund të bëjë dikush është të presupozojë se dikush nuk është viktimë e trafikimit.
- Siç e kemi parë në këtë kapitull, trafikimi i qenieve njerëzore në ditët e sotme mund të jetë në forma të ndryshme dhe viktimat mund të vijnë nga shtete të ndryshme dhe prejardhje të ndryshme.
- Format e shfrytëzimit janë të shumta.
- Viktimat mund të preken nga trafikimi për një mori arsyesh - kërcënime, intimidim, mashtrim, bashkëpunim i familjes, arsye financiare.
- Mbani parasysh, eksperiencia e secilës viktimë është unike!

## VIKTIMË E MUNDSHME?

- Si duket një viktimë e mundshme e trafikimit?
- Disa njerëz mendojnë se kjo është një gjë e dukshme dhe e qartë. Por, a është në të vërtetë?
  - ◆ A njihen në të vërtetë të gjitha viktimat e mundshme se janë në situatën në të cilën janë?
  - ◆ A njihen si viktima kur janë duke u shfrytëzuar?
  - ◆ A njihen si viktima kur janë duke u lëvizur nga një vend në tjetrin?

## EKSPERIENCA TË ZAKONSHME TË VIKTIMAVE

### Pikat kryesore të kapitullit

Dhunë fizike

- Kjo mund të jetë e padukshme, e fshehtë, ose ekstreme.
- Shpesh, viktimat sulmohen fizikisht.
- Disa raste të sulmit ndaj viktimave përfshijnë:
  - ◆ Një vajzë 9-vjeçare, shërbente në një familje, u dogj me lugë të nxehtë dhe një hekur për hekurosje.
  - ◆ Një djalë vietnamez u rrah, nga trafikanti, me shkop metalik.
  - ◆ Një vajzë rumune u rrah dhe i kërkuan ku kishte fshehur paratë e fituara nga lypja.
  - ◆ Një fëmijë 3-vjeçar u dogj me cigare dhe puro.
- Kërcënimi i dhunës në vetvete, apo të shohësh të tjerët që lëndohen, shpesh mjafton për të frikësuar dhe kontrolluar viktimat.



## RAST PRAKTIK

*L.B, 3 vjec, është identifikuar nga skuadrat e terrenit duke lypur i vetëm në rrugët e T. Fëmija është gjendur i pa veshur mirë dhe i pa ushqyer dhe me shenja dhune në trup. Në bazë të verifikimeve rasti është raportuar edhe më parë nga qytetarë pranë Linjës së Këshillimit për Fëmijë Alo 116 111. Pas shoqërimit të fëmijës në komisariat nga punonjës të skuadrës së terrenit dhe punonjës për mbrojtjen e fëmijës bëhet i mundur dhe identifikimi i nënës – e cila në bazë të informacionit gjatë deklarimit të saj, ushtron prostitucion dhe fëmijën ua lë personave të tjerë për t'u kujdesur për të ose e merr me vete gjatë ushtrimit të prostitucionit.*

*Të ardhurat e përfituara nga lypja e djalit merreshin nga nëna dhe bashkëjetuesi i saj.*

*Fëmija u mor në mbrojtje të menjëhershme nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe ndaj nënës u në kallëzim për keqtrajtim të mituri nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës.*



## Pikat kryesore të kapitullit

### TRAUMË PSIKOLOGJIKE

- Nuk mund të nënvlerësohet dëmi psikologjik që përjeton një viktim trafikimi.
- Heqja e plotë e aftësisë për të kontrolluar jetën e tyre, jetesa në frikë e vazhdueshme dhe mungesa e plotë e respektit për veten mund të kenë një ndikim të thellë.
- Viktimat e trafikuar në një vend të ndryshëm nga vendi i origjinës mund të udhëtojnë për një kohë shumë të gjatë. Ka shumë raste ku udhëtimi zgjat për 12 muaj dhe kalojnë në 8 ose më shumë shtete. Gjatë të gjithë udhëtimit, çdo ditë, viktimat përballen me kërcënime dhe përdorim të forcës dhe/ose sulm seksual. Kjo mund të ndodhë fizikisht ndaj atyre ose personave të tjerë në grupin e tyre. Ky përjetim ka një ndikim të rëndë psikologjik mbi viktimën.
- Shumë viktimat, për rrjedhojë, diagnostikohen me stres post traumatik (PTSD) ose gjendje të tjera të rënda të shëndetit mendor.

### PËRDHUNIM DHE SULM SEKSUAL

- Burra, gra dhe fëmijë kanë qenë viktimat të përdhunimit dhe sulmit seksual gjatë gjithë procesit të trafikimit.
- Ai përdoret jo vetëm si një formë e shfrytëzimit, p.sh. prostitucion, po edhe si një mekanizëm kontrolli nga ana e trafikantëve. Përdoret për të ushtruar dominancë mbi një viktimë, për t'i degraduar ata dhe me raste për arsyen e vetme të kënaqësisë seksuale të trafikantëve.
- Përdhunimi dhe sulmi seksual, shpesh i përsëritur dhe i kryer nga më shumë se një burrë, ka një efekt shkatërrues të viktimat, duke çuar shpesh në trauma të rënda fizike dhe psikologjike.

## SISTEMI I BINDJEVE

- Bindjet e një viktime mund të përdoren kundër tyre nga ana e trafikantëve.
- Për Rast praktik, një viktimë që vjen nga një kontekst i rreptë fetar mund të ketë frikën e ekspozimit të familja dhe/ose komuniteti për shfrytëzimin e tyre, për Rast praktik, prostitucion.
- Në disa komunitete afrikane ka një bindje të fortë në Juju ose bindje e besime të ngjashme.
- Shpesh ekziston së bashku me bindjet e përgjithshme fetare.
- Bindjet si të viktimave edhe të familjeve të tyre shfrytëzohen nga trafikantët, të cilët i bindin se janë në kontrollin e Juju dhe se do t'u ndodhë një e keqe shumë e madhe atyre ose një të afërmi nëse nuk u bindjen trafikantëve.



**RAST PRAKTIK** i raportit psikologjik të një viktime trafikimi të asistuar nga strehëzat për viktimat e trafikimit në Shqipëri. Marrë nga materialet e “Gjyq imitues i veprave penale të trafikimit të personave”, OSBE, shkurt 2022.

*Në kontaktet e para me rastin ajo ka shfaqur disa simptoma të shqetësimeve psikologjike që i ka manifestuar me probleme me gjumin, izolim social, shpërthime zemërimi dhe paqëndrueshmëri emocionale. Nga sa ka raportuar, përfituesja nuk ka pasur evente jetësore madhore traumatike me parë, përveç eksperiencës së trafikimit.*

## KONTROLLIM I HAPUR

- Shpesh trafikantët u i privojnë viktimat nga aftësia për të kontrolluar apo drejtuar vetë jetën e tyre.
- Trafikantët dihet se:
  - ◆ U marrin viktimave dokumentet e udhëtimit dhe/ose identitetit.
  - ◆ U heqin ose u kontrollojnë aftësinë viktimave për të kontaktuar miqtë apo familjarët.
  - ◆ Sigurohen që [viktimat] janë në varësi të trafikantëve për ushqim, veshmbathje dhe akomodim.
  - ◆ Kontrollojnë aksesin e viktimave për para.
  - ◆ Mbjellin ose përforcojnë te viktimat frikën e tyre dhe mosbesimin të zbatimi i ligjit dhe të autoritetet.
  - ◆ I mbajnë viktimat të izoluara (sidomos në fazat e hershme) duke i privuar nga çdo kontakt me të tjerë apo me komunitetin lokal.
- Mbani parasysh se viktimat nuk janë gjithmonë të kyçura me dryn. Metodrat e kontrollit shpesh janë më të padukshme.



## RAST PRAKTIK

*Atë ditë dhe në vijim, e dëmtuara Xh., ka qënë nën mbikqyrjen e E., paratë e fituara ia dorëzonte atij, ndërsa për mënyrën e sjelljes dhe të 'punës' si prostitutë, është instruktuar nga shtetësja M.*

*Nga analiza e provave rezulton se e dëmtuara, ka shkuar sëbashku me të pandehurin E., në një dhomë që u ka treguar M., dhe e dëmtuara, është përpjekur që të ndryshonte mendjen e të pandehurit E., që ai të mos e detyronte të bënte atë punë ndërsa ai i ka thënë se "ke për ta bërë atë punë sepse ky ishte dhe qëllimi që ai e ka shoqëruar në Z". Ky ka qënë momenti që e dëmtuara Xh., e mitur, vetëm 16 vjeç, është trembur dhe pasi ka kuptuar se ishte e vetme në shtetin Z, nën kërcënimin e E., e detyruar t'i nështrohej situatës së krijuar, jashtë vullnetit të saj është shfrytëzuar nga i pandehuri, për qëllime prostitucioni duke kryer marrëdhënie seksuale me pagesë.*

*Lidhur me shfrytëzimin e të dëmtuarës për qëllime prostitucioni, gjykata bazuar në deklaratimet e të dëmtuarës, e cila ka dhënë shpjegime të hollësishme me detaje, duke treguar edhe vendet shoqëruar edhe me fotografitë përkatëse ardhur nëpërmjet letërporosisë, krijon besueshmërinë, pasi deklaratimet e të dëmtuarës konfirmohen, përputhen plotësisht në pjesën më të madhe me provat shkresore, pjesë që lidhet me elementët objektivë dhe të mundshëm për t'u verifikuar, duke krijuar kështu besueshmërinë e deklaratimeve të të dëmtuarës edhe për pjesët e tjera që lidhen me elementë subjektivë që janë të vështirë ose të pamundur për t'u konfirmuar, por janë elementë të veprës penale dhe të fajësisë së autorit.*

*Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, 19/162, viti 2015 ndaj të pandehurit E.T.*

## VULNERABILITETET

- Trafikantët janë ekspertë për identifikimin dhe shfrytëzimin e vulnerabilitetit, faktorëve individualë "shtytës dhe tërheqës" të vetë personit.
- Vulnerabiliteti mund të ndahet në dy kategori: "personal" dhe "rrethanor".
- Vulnerabiliteti personal mund të përfshijë:
  - ◆ Të jesh ndryshe nga ata që të rrethojnë
  - ◆ Të mos kesh arsimim
  - ◆ Etniciteti dhe kultura
  - ◆ Gjinia
  - ◆ Shëndeti mendor
  - ◆ Orientimi seksual
  - ◆ Mosha
  - ◆ Viktimë e abuzimit fizik ose seksual
  - ◆ Varësia ndaj alkoolit ose drogës
  - ◆ I pastrehë

- Vulnerabiliteti rrethanor mund të përfshijë:
  - ◆ Rrethana të pafavorshme në familje dhe në komunitet
  - ◆ Ndikime kulturore të pafavorshme
  - ◆ Varfëria
  - ◆ Kontroll shtrëngues
  - ◆ Mashtrim duke fituar besimin
  - ◆ Statusi i imigracionit
  - ◆ Izolimi social
  - ◆ Barriera gjuhësore
  - ◆ Mospasja e mundësive për një punësim të mirë
  - ◆ Prezenca e abuzuesit
  - ◆ Sjellje me rrezik

## INDIKATORËT E TRAFIKIMIT

### Pikat kryesore të kapitullit

- Shpesh ka indikatorë, apo elementë sugjerues, që një person mund të jetë viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore. Identifikimi i viktimës nuk është shkencë ekzakte, por ka disa indikatorë të pranishëm.
- Më kryesorja është që të dalloni indikatorët që janë të pranishëm dhe të merren veprimet e duhura më pas.
- Lista e indikatorëve të mundshëm është shumë e gjerë dhe e pamundur për ta trajtuar me hollësi në këtë kapitull.
- Jo të gjithë indikatorët janë të pranishëm në të gjitha situatat që përfshijnë trafikim të qenieve njerëzore.

### Pikat kryesore të kapitullit

Shfaqeni citimin e mëposhtëm para grupit të madh

***Megjithëse prania ose mungesa e ndonjërit prej indikatorëve as vërteton dhe as hedh poshtë se po ndodh trafikimi i qenieve njerëzore, prania e tyre duhet të çojë në hetim.***

***UNODC Indikatorët e trafikimit të qenieve njerëzore***





*Në legjislacionin shqiptar, treguesit e trafikimit shtjellohen hollësisht në dokumentin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 499, datë 29.8.2018.*

*Në bazë të këtyre procedurave, procesi i identifikimit të një viktime trafikimi kalon në dy faza kryesore:*

- *në identifikimin fillestar; dhe*
- *identifikimin formal.*

*Procesi në vetvete nuk është thjesht një veprim burokratik, por shoqërohet me marrjen e masave konkrete në lidhje me rastin, siç shprehet dhe në vetë formulimin e konceptit ku fjala “reagim” shoqëron fjalën identifikim. Masat reaguese, pra ndjekja e rastit me hapa konkrete kryesisht të orientuara drejt asistencës fillestare janë të domosdoshme veçanërisht në çështjet e trafikimit të fëmijëve, ku marrja e menjëhershme në mbrojtje e fëmijës që është në një situatë rreziku, pavarësisht nëse më vonë zbulohet që është ose jo viktimë trafikimi, është parimi që duhet të udhëheqë vendimmarrjen e çdo profesionisti në një rast të mundshëm trafikimi të fëmijës.*

*Procedurat Standarde të Veprimit cilësojnë si “Identifikim dhe reagim fillestar” tërësinë e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë dhe brenda territorit të RSH-së, si të institucioneve vendore, ashtu edhe qendrore që bën të mundur përcaktimin se një person i/e mitur apo i/e rritur është viktimë e mundshme e trafikimit të personave. Mjetet e identifikimit fillestar janë treguesit dhe intervista: në rast se në sjelljen dhe paraqitjen e personit ka elemente që janë të përfshira në listën e treguesve, atëherë personi kalohet në intervistë fillestare.*

*Përsa i përket “Identifikimit formal”, ai është identifikimi i një personi si viktimë trafikimi, i kryer vetëm nga Grupi/Struktura përgjegjëse për identifikim formal në bazë të formatit të intervistës formale të përfshirë në këto procedura. Në dallim nga identifikimi fillestar, i cili bazohet në një listë treguesish dhe intervistë të personit, mjeti i vetëm i identifikimit formal është intervista formale/zyrtare.*



## Ushtrim

Kërkohen: ngjyrues, tabelë me fletë të bardha të mëdha, ngjitës shirit.

- Në grupe të vogla, u kërkoni pjesëmarrësve të identifikojnë sa më shumë "indikatore të trafikimit" që të mundeni, duke i renditur në tabelë.
- U kërkoni grupeve të ndajnë me grupin e madh indikatorët e identifikuar.
- Ngjitini fletat e mëdha të bardha në mure ku të jenë të dukshme për pjesëmarrësit.
- Rikthejuni listave, duke treguar indikatorët që u identifikuan dhe duke theksuar ata që nuk u identifikuan.

### **INDIKATORËT E TRAFIKIMIT - DUKJA DHE SJELLJA**

- Lëndimi fizik.
- Probleme shëndetësore.
- Rraskapitja nga lodhja.
- Mospasja e sendeve personale dhe dokumenteve të identitetit.
- Veshja vazhdimisht e vetëm një palë rrobave.
- Sjellje me frikë ose e tërhequr.
- Varësia nga të tjerët.
- Komunikim i kontrolluar nga një person tjetër.
- Aftësi të dobëta gjuhësore.
- Nuk e njeh zonën përreth.
- Tatuazhe dhe shenja të tjera që tregojnë pronësi.

### **INDIKATORË TË TRAFIKIMIT - RRETHANAT PERSONALE**

- Kontakte të limituara me familjen, miqtë, dhe komunitetin.
- Lëvizje të kontrolluara dhe nuk ka mundësi të udhëtojë vetëm.
- Ka kontroll të kufizuar ose nuk ka fare kontroll personal mbi fitimet.
- Nuk janë të vetëdijshëm se janë viktimë.
- Tregues se prona është marrë nga një person tjetër ose grup.
- Përfshirë në veprimtari kriminale.
- Gjithmonë në shoqërinë e një personi tjetër.
- Ka frikë nga hakmarrja mbi veten ose familjen.

### **INDIKATORË TË TRAFIKIMIT - KUSHTET E PUNËS DHE TË JETESËS**

- Punon dhe jeton në të njëjtin vend ose godinë.
- Kushte pune të papërshtatshme ose pa siguri.
- Kushtet e akomodimit janë të pista, johigjienike, dhe të mbipopulluara.
- Janë ndërmarrë hapa për të kufizuar aksesin për të hyrë apo për të dalë nga një pronë ose ndërtesë.
- Transportohet midis disa vendndodhjeve specifike.



- Ndryshim i shpeshtë i vendit të punës dhe vendbanimit.
- Bën një punë të ndryshme nga ajo e specifikuar në kontratën e punës.



## Ushtrim

- Duke përdorur një tabelë, ftojini pjesëmarrësit të vendosin indikatorët e trafikimit nën titullin e duhur, Dukja dhe sjellja, Rrethanat personale, Kushtet e punës dhe të jetesës.
  - ◆ Kontroll i kufizuar ose nuk ka fare kontroll personal mbi fitimet.
  - ◆ Punon dhe jeton në të njëjtin vend.
  - ◆ Nuk ka kontakt me miq ose familjarët.
  - ◆ Nuk ka sende personale ose dokumente.
  - ◆ Shfaq probleme shëndetësore, rraskapitje, ose lëndim.
  - ◆ Ka frikë ose është i tërhequr.
  - ◆ Në vend të tij flasin të tjerët.
  - ◆ Punon në kushte të mungesës së sigurisë ose të parregulluara.



## RAST PRAKTIK

*Në përfundim gjykata konkludon se me të gjitha provat e parashtruara më sipër të analizuara në tërësinë e tyre provohet fakti se i pandehuri P., duke përfituar nga mosha e mitur, fakt që prezumon deformimin e vullnetit të saj dhe gjendja vulnerabël e të dëmtuarës B., e rekrutoi atë, e vuri nën kontroll përmes një fejese fiktive, e zhvendosi nga qyteti D. në qytetin E. dhe e shfrytëzoi për të fituar para, duke e nxjerrë të kërcente tek Bar ..., në E. dhe duke ofruar shërbime seksuale kundrejt pagesës dhe në zonat përreth, duke gëzuar të ardhurat e siguruara në rrugë kriminale dhe e transferoi atë drejt Kosovës për ta shfrytëzuar përsëri.*

*Lidhja e të pandehurit me të miturën B., provohet se nuk është një lidhje e qëndrueshme dhe për qëllime martesore, pavarësisht se në dukje duket si e tillë për shkak edhe të angazhimit të familjeve përkatëse.*

*Kjo duket haptazi si nga mënyra vulgare e komunikimit, mjediset joserioze që frekuentonin, si dhe fakti i provuar që e dëmtuara B. ofrohej për shërbime seksi, në dijeni të plotë dhe nën kontrollin e të pandehurit. Lidhja mes tyre nuk ka patur qëllime serioze, pasi ekspozimi i të dëmtuarës në mjedise të tilla dhe afrimi me persona të tjerë meshkuj nuk është sjellja tipike e të fejuarit ndaj të fejuarës, por sjellja tipike e tutorit kundrejt viktimës së shfrytëzuar prej tij.*

*Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, 135/2016 ndaj të pandehurit P.Ç.*



## ELEMENTË SUGJERUES

### Pikat kryesore të kapitullit

- Shpesh ka elementë sugjerues që duhet të na sinjalizojnë se personi mund të jetë një viktimë e trafikimit.
- Element të tillë mund të na vijnë në ndihmë për të identifikuar se një person mund të jetë në një situatë kontrolli ose shfrytëzimi.

#### **Kush po flet?**

- A po flet viktimat e mundshme?
- Nëse janë me të tjerë, kush po flet në të vërtetë?
- A u përgjigjet dikush tjetër të gjitha pyetjeve, madje edhe atyre që u drejtohen të tjerëve?
- A e ndërpresin viktimën e mundshme?
- A lejohet të flasë viktimat e mundshme?
- A duket se kanë frikë të flasin?

#### **Kush i mban dokumentet e udhëtimit?**

- A i kanë vetë viktimat e mundshme dokumentet e tyre?
- Nëse jo, pse?
- Kush i mban dokumentet?

#### **Kush i merr paratë?**

- A ka viktimat e mundshme në zotërim shuma parash?
- A kanë një kartë bankare për tërheqje parash cash?

#### **Si ka arritur këtu?**

- Si ka mbërritur këtu ku është viktimat e mundshme?
- A flasin në përgjithësi dhe jo në mënyrë specifike? Konfuzë? Të pasigurt?
- A ishte një itinerar i pazakontë?
- Metodë e pazakontë?
- A duket realist udhëtimi i tyre?

#### **A kanë lëndime?**

- Fakti që dikush nuk ka lëndime nuk do të thotë se ai apo ajo NUK është viktimë e trafikimit. Por është e rëndësishme të sqarohet nëse ekzistojnë apo jo lëndimet.
- Trafikantët përdorin metoda të ndryshme, në kohë të ndryshme, për të ushtruar kontroll mbi viktimat. Dhuna apo kërcënimi për dhunë mund të jetë një prej tyre.

- Mbani parasysh se trafikimi i qenieve njerëzore nga trafikantët shihet si biznes. Nga këndvështrimi i tyre, ata mund të mos duan të dëmtojnë mallin e tyre, domethënë viktimën, ose mund të shkaktojnë lëndime në mënyra dhe pjesë të trupit që nuk janë të dukshme.

### **Ku po qëndrojnë?**

- Ku po qëndron viktimia e mundshme?
- Ku i kanë sendet vetjake?

## **SFIDAT**

### **Pikat kryesore të kapitullit**

Për identifikimin e viktimave të mundshme, ose për dëshirën e viktimës për ta deklaruar veten viktimë, ka disa sfida.



### **Ushtrim**

- Kërkojini grupit të madh të rendisin sfidat e përpjekjeve për identifikimin e viktimave të mundshme.
- Kërkojuni pjesëmarrësve që janë përgjigjur ta shtjellojnë më tej përgjigjen - pse e thoni këtë?
- Shfaqeni secilin prej titujve me radhë (në një slide), dhe kërkojini grupit të madh të identifikojë sfidat e ndryshme.
- Shfaqini pikat kryesore (bullet point) pasi grupi i madh të ketë thënë të gjitha përgjigjet.

## **FRIKË**

- Trafikantët mundet të kontrollojnë, dhe zakonisht e bëjnë, viktimat me anë të frikës.
- Frika nga lëndimi, madje edhe nga vdekja.
- Gjithashtu, është praktikë e zakonshme që trafikantët ta kërcënojnë viktimën që nëse përpiqet të arratiset apo të informojë dikë atëherë do të lëndojnë një pjesëtar të afërt të familjes.

## **MOSBESIM**

- Disa viktimia, në eksperiencën e vet të jetës apo të ndikuar nga trafikantët, kanë mosbesim karshi autoriteteve.
- Viktimat i shohin shpesh autoritetet shtetërore si të korruptuar dhe që nuk u zihet besë.
- Trafikantët i përforcojnë pasiguritë, frikërat dhe bindjet e viktimave se ata do të trajtohen si kriminelë apo migrantë të paligjshëm nëse zbulohen nga ana e autoriteteve.



## MOSNJOHJE E TË DREJTAVE

- Disa viktima vijnë nga shtete që nuk kanë sisteme të zhvilluara të të drejtave të individit.
- Edhe në ato vende që i kanë, viktimat mund të jenë të keqinformuara ose nuk janë në dijeni se cilat janë të drejtat e tyre ligjore të njeriut.

## FAJ DHE TURP

- Për shumë viktima, faji dhe turpi i asaj që i kanë detyruar të bëjnë është mbytës. Ata besojnë se familjet dhe komunitetet e tyre nuk do ta kuptojnë pozitën e tyre.
- Faji dhe trupi mund të lindin nga bindje fetare, si dhe nga norma sociale, familjare dhe komunitare.
- Është një dukuri e zakonshme që viktimat fajësojnë veten për situatën dhe shfrytëzimin e tyre.

## GJUHA

Duke mos qenë në gjendje të flasin gjuhën e vendit të destinacionit (ose të atij të tranzitit) krijon barriera për identifikimin e viktimës.

Kjo u mundëson trafikantëve t'i mbajnë viktimat në izolim social, të eliminojnë mundësitë që të kërkojnë ndihmë dhe forcon varësinë e viktimës ndaj trafikantëve, kombinuar me aftësinë e trafikantëve për të vazhduar intimidimin.

## ÇFARË DUKET E DREJTË DHE ÇFARË DUKET E GABUAR?

### Pikat kryesore të kapitullit

- Pavarësisht nga profesioni që kemi, në përditshmërinë e jetës sonë private dhe profesionale, ne e dimë se çfarë duket dhe ndjejmë se është mirë, çfarë është e drejtë dhe çfarë nuk është.
- Pikat e mëposhtme janë faktorë kyç që mund të zbatohen për këdo në identifikimin e situatave të mundshme shfrytëzimi dhe identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit.
  - ◆ Njihet mjedisin tënd.
  - ◆ Çfarë duket dhe ndihet si normale?
  - ◆ Si reagojnë shumica e njerëzve?
  - ◆ Gjuha e trupit është e rëndësishme. Njerëzit, po aq sa kafshët, përdorin gjuhën e trupit për të ndihmuar në komunikim. Gjuha e trupit e një personi mund të komunikojë në mënyrë të efektshme çdo emocion njerëzor.
  - ◆ Nëse situata duket si një abuzim dhe shfrytëzim, atëherë ndoshta ashtu është.
  - ◆ Nëse duket si diçka e gabuar, atëherë kontrolloje ose raportojë. Mos e injoro.

## PËRMBLEDHJE



### Pikat kryesore të kapitullit

- Në këtë kapitull, kemi parë se kush është përgjegjës për identifikimin e viktimave. Të gjithë kemi detyrimin moral, por disa profesione dhe kompani kanë një detyrim ligjor.
- Ne eksploruam disa sfida për identifikimin e viktimave të trafikimit si dhe pamë disa prej eksperiencave më të zakonshme të shprehura nga viktimat, por gjithmonë duke mbajtur parasysh se eksperiencia e çdo viktime është unike!
- Pika kryesore për t'u mbajtur mend:
  - ◆ Viktimat rrallë e tregojnë menjëherë abuzimin ose shfrytëzimin.
  - ◆ Marrëdhëniet me të tjerët duhet të eksploroohen me imtësi - kujt i besojnë dhe pse? Po ashtu, kujt nuk i besojnë dhe pse?
  - ◆ Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore nuk duhet të ndiqen penalisht, apo të kërcënohen me ndjekje penale, për krime të kryera si rezultat i të qenit i trafikuar.
  - ◆ Në praktikë, në lidhje me viktimat, ne kërkojmë të identifikojmë, të dallojmë, të ruajmë, dhe të raportojmë.

*Për një informacion më të hollësishëm mbi trafikimin e qenieve njerëzore, referojuni Manualit të OSBE-së “Trafikimi i Qenieve Njerëzore Manual për Gjyqtarë, Prokurorë dhe Profesionistë të tjerë Ligjorë”, kapitulli 5. <https://www.osce.org/files/f/documents/f/6/512644.pdf>*

09

Intervista  
fillestare -  
teknika  
konjitive  
e intervistimit



## Objektivat e kapitullit

Në përfundim të këtij kapitulli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të përcaktojnë sfida që mund të dalin gjatë intervistave të shqyrtimit paraprak (screening) për Trafikimin e Qenieve Njerëzore.
- Të shprehin qëllimin e intervistës fillestare për Trafikimin e Qenieve Njerëzore.
- Të kuptojnë plotësisht kontaktin e parë të viktimës.
- Të risjellin në vëmendje elementet bazë të modelit PEACE për intervistimin.
- Të përshkruajnë mënyrën se si modeli PEACE mund të zbatohet për intervistat fillestare për TQNJ.

## HYRJE



### Pikat kryesore të kapitullit

- Takimi i parë me një viktimë të mundshme trafikimi, duhet të menaxhohet me kujdes.
- Kontakti i parë është një dritare mundësie që ka pak gjasë të përsëritet. Është një mundësi për të treguar empati dhe për të ndërtuar besimin e viktimës së mundshme.
- Në të kundërt, nëse nuk menaxhohet mirë, rrezikohet të përforcohen të gjitha stereotipet negative të viktimave të trafikimi në lidhje me autoritetet ligjzbatuese, të përforcohet frika që kanë nga punonjësit e mbrojtjes së ligjit dhe të mos fitohet dot besimi i viktimës.
- Pyetjet e intervistës fillestare mund ta ndihmojnë punonjësin e policisë që të identifikojë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të ndihmojë viktimat e trafikimit të marrin mbrojtje dhe shërbimet që u nevojiten.

## QËLLIMI I INTERVISTËS FILLESTARE



### Pikat kryesore të kapitullit

- Qëllimi i intervistës fillestare është të identifikohet nëse ka motive të arsyeshme për të dyshuar se një person është trafikuar dhe, nëse po, cilat veprime duhen ndërmarrë.
- Në përgjithësi, intervista fillestare zhvillohet pasi janë identifikuar disa indikatorë. Kjo me gjasë do të ndodhë gjatë veprimeve rutinë të intervistimit fillestar në kufi, porte, dhe aeroporte.
- Punonjësit e policisë që kryejnë intervistën fillestare mund të përballen me një sërë sfidash të veçanta, përfshirë:
  - ◆ Koha - shpesh, ka shumë pak kohë në dispozicion.
  - ◆ Vendndodhja - me gjasë zhvillohen në vende që janë më pak se ideale dhe të kufizuara.
  - ◆ Privatësia - mund të ndikojë dhe vendndodhja, por përgjithësisht privatësia mungon sepse mund të jenë të pranishëm dhe persona të tjerë, përfshirë trafikantët e mundshëm.



*Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen E Viktimave Dhe Viktimave të Mundshme Të Trafikimit miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 499, datë 29.8.2018, përcaktojnë treguesit e trafikimit dhe intervistën e viktimës së mundshme të trafikimit si mjetet kryesore për Identifikim fillestar” të viktimës së trafikimit dhe sërish “intervistën formale” si mjetin e vetëm të identifikimit formal të viktimës së trafikimit.*

## ÇFARË ËSHTË NJË INTERVISTË FILLESTARE?



### Pikat kryesore të kapitullit

- Një intervistë fillestare mund të jetë përballja e parë me një viktimë të mundshme ose mund të jetë ajo kur viktima e mundshme ndodhet në një vend ku ka siguri.
- Intervista fillestare mund t'i shërbejë punonjësit të policisë të identifikojë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të ndihmojë viktimat e trafikimit të marrin mbrojtje dhe shërbimet që u nevojiten.
- Para zhvillimit të intervistës fillestare, duhet të jeni të përgatitur që të bazoheni te ekspertiza juaj e trafikimit të qenieve njerëzore dhe te mbështetja e punonjësve të tjerë të strukturave të policisë, si dhe kur e parashikojnë procedurat të mbështeteni dhe te bashkëpunimi me strukturat e mbrojtjes sociale.
- Mënyra se si zhvillohet intervista fillestare, llojet e pyetjeve që bëhen, mënyra e sjelljes së intervistuesit, mjedisi ku zhvillohet që të gjitha kanë një rëndësi kyçe për rezultatin.

## INTERVISTË APO BISEDË?



### Pikat kryesore të kapitullit

- Në të vërtetë, intervista është një bisedë e menaxhuar. Në kontekstin e zbatimit të ligjit, ajo mund të jetë me një të dyshuar, me një viktimë ose me një dëshmitar.
- Është një bisedë, por është një bisedë me një qëllim. Ajo ka nevojë të ketë një strukturë dhe duhet të menaxhohet si duhet.
- Praktika më e mirë e pranuar gjerësisht në lidhje me strukturën që duhet përdorur njihet si modeli PEACE. Ndjekja e këtij modeli lehtëson menaxhimin e një bisede të mirë.
- Modeli PEACE është model i një interviste konjitive dhe është përshtatur për përdorim nga të gjitha Forcat e Policisë në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe nga shumë agjenci ligjzbatuese në të gjithë botën.
- Në gjuhën angleze PEACE do të thotë:
  - ◆ Plan and Prepare (planifiko dhe përgatitu)



- ◆ Engage and Explain (angazhohu dhe shpjego)
- ◆ Account, clarification and challenge (rrëfim, qartësim dhe sfidë)
- ◆ Closure (mbyllje)
- ◆ Evaluation (vlerësim)

## PËRGATITJA E VENDIT TË INTERVISTËS

### Pikat kryesore të kapitullit

- Para se të zhvilloni një intervistë fillestare, sigurohuni që të jenë plotësuar nevojat bazë njerëzore për viktimën e mundshme:
  - ◆ Ushqim
  - ◆ Veshmbathje
  - ◆ Siguria
  - ◆ Mjedisi
- Përpiquni të mos intervistoni asnjëherë kur ka të tjerë që shikojnë apo dëgjojnë (viktima të tjera të mundshme apo trafikantë të mundshëm).
- Mendoni për vendndodhjen dhe masat për zhvillimin e intervistës ose për mënyrën se si mund të menaxhoni vendndodhje të vështira.
- Merrni në konsideratë aspektin gjinor (kur është e mundur ofroni një intervistues të së njëjtës gjini).

### Ushtrim

Cila është më e mira?

- Tregojini klasës në PowerPoint tri fotot e mëposhtme.



A



B



C

- Kërkojini secilit prej pjesëmarrësve të regjistrojë përgjigjen vet për këtë pyetje: "Cili imazh paraqet më mirë praktikën e mirë në përgatitjen dhe menaxhimin e intervistës fillestare?"
- Diskutojini përgjigjet në grup të madh, duke i pyetur pjesëmarrësit të shpjegojnë individualisht arsyetimin e tyre.
- Shpjegoni se imazhi C është përgjigjja e saktë.



## Pikat kryesore të kapitullit

- Është e rëndësishme që viktimës t'i krijoni kushte sa më komode.
- Kjo përfshin:
  - ◆ Sa herë të jetë e mundur, sigurohuni që të jenë larg mjedisit ku janë trafikantët.
  - ◆ Përpiquni ta bëni vendin e intervistës sa më pak formal.
  - ◆ Tavolinat mund të shihen si barriera, përpiquni të mos i përdorni.
  - ◆ Uluni krah tyre dhe mos qëndroni në këmbë mbi ta.
  - ◆ Mbani parasysh gjuhën e trupit për të treguar që jeni i hapur, të demonstroni besim dhe dëshirë për të dëgjuar.

## ZHVILLIMI I INTERVISTËS

### Pikat kryesore të kapitullit

- Jini profesionist por edhe miqësor.
- Tregoni respekt pavarësisht nga rrethanat.
- Mos jini gjykues.
- Bëni durim.
- Jepini viktimës kohë për të folur.
- Sigurojini se jeni aty për të ndihmuar.
- Mos përdorni përkthyes të "komunitetit".
- Mos bëni premtime që nuk mund t'i mbani.

## TË KUPTOSH EFEKTET E TRAUMËS

### Pikat kryesore të kapitullit

- Viktimat mund të jenë të traumatizuara.
- Tregohuni mirëkuptues për faktin se viktimat nuk dëshirojnë të vazhdojnë të përsërisin historinë e tyre.
- Sa herë që e tregojnë, e rijetojnë situatën duke rënduar traumën.

## TË FLASËSH ME NJË VIKTIMË TË MUNDSHME

### Pikat kryesore të kapitullit

- Kur një viktimë e mundshme përballet për herë të parë me një profesionist, me shumë mundësi do të duhet të bëhen disa pyetje.
- Kjo është një bisedë e menaxhuar. Së bashku me njohurinë tuaj për si, ku dhe pse ndodh trafikimi, kjo do t'ju ndihmojë të vendosni nëse një person është viktimë e mundshme.
- Mënyra e strukturimit të pyetjes është me rëndësi kritike për përgjigjen dhe/ose reagimet që do të merrni.
- Përgjithësisht janë dy lloj pyetjesh: pyetje të hapura dhe pyetje të mbyllura.
- Kur flisni me një viktimë të mundshme është shumë e rëndësishme që për sa



të jetë e mundur të bëhen pyetje të hapura, ndonëse në disa rrethana pyetjet e mbyllura mund të jenë të përshtatshme.

- Pyetjet bëjini vetëm një e nga një me radhë. Asnjëherë mos përsërit pyetje pa i dhënë personit kohën për t'i u përgjigjur secilës.

## PYETJE TË HAPURA

- Pyetje e hapur është ajo që i jep personit mundësinë të shpjegojë me sa më shumë detaje që personi dëshiron. Këto pyetje u lejojnë të zgjerojnë përgjigjen, të shpjegojnë një situatë me fjalët e tyre.

## PYETJE TË MBYLLURA

- Pyetje e mbyllur është një pyetje e drejtpërdrejtë që merr një përgjigje të thjeshtë ose vetëm një fjalë, zakonisht me fjalët "po" ose "jo".

## PYETJE TË HAPURA

### Pikat kryesore të kapitullit

- Siç e kemi parë, pyetjet e hapura janë ato që kërkojnë më shumë mendim dhe më shumë se një përgjigje të thjeshtë apo me një fjalë.
- Pyetjet e hapura kërkojnë përgjithësisht mendim dhe reflektim; përgjigjja ndaj një pyetjeje të hapur është zakonisht përshkruese dhe shpjeguese.
- Pyetjet e hapura fillojnë zakonisht me fjalë si:
  - ◆ Kush?
  - ◆ Çfarë?
  - ◆ Kur?
  - ◆ Ku?
  - ◆ Pse?
  - ◆ Si?
- Mund të fillojnë edhe me shprehje si:
  - ◆ Më trego për...
  - ◆ Më shpjego ...
  - ◆ Përshkruaj...



## Ushtrim

Pyetje të mundshme

- Në grup të madh, ftojini pjesëmarrësit të vendosin pyetjet e mëposhtme (në tabelë) në kategorinë e duhur "Pyetje të hapura" ose "Pyetje të mbyllura".
  - ◆ A erdhe me avion këtu?
  - ◆ Çfarë pune bën?
  - ◆ A e ka ai pasaportën tënde?
  - ◆ Si u pagua udhëtimi për ty?
  - ◆ Më trego për udhëtimin.
  - ◆ A jeton këtu?



## Pikat kryesore të kapitullit

- Siç e kemi parë, ka një dallim të madh në strukturimin e pyetjeve të hapura dhe atyre të mbyllura, por edhe në mënyrën se si ato i inkurajojnë, ose jo, viktimat e mundshme për të dhënë një përgjigje të zgjeruar.
- Pyetjet e hapura mund ta inkurajojnë një person që të flasë. Ato i japin viktimës së mundshme mundësinë për të folur me shpejtësinë e vet, si dhe për t'i shpjeguar gjërat në mënyrën e vet.
- Pyetjet e hapura i japin personit një element të kontrollit të jetës së tyre dhe u lejon të ndihen se dikush po u kushton vëmendje dhe po i dëgjon.



## Ushtrim

Pyetje e hapur dhe e mbyllur.

- Ndajeni grupin në grupe të vogla dyshe.
- Informojini se çdo dyshe do të ketë 5 minuta që njëri të "intervistojë" tjetrin mbi "çfarë bënë fundjavën e kaluar", duke bërë vetëm pyetje të hapura.
- Pas 5 minutash, në dyshe do të ndërrojnë rolet.
- "I intervistuari" duhet t'u përgjigjet vetëm pyetjeve të hapura.

## MODELI PEACE PLANIFIKIM DHE PËRGATITJE (P)

### Pikat kryesore të kapitullit

- Planifikimi i duhur dhe përgatitja për intervistën e shqyrtimit paraprak nga ana e intervistuesit është me rëndësi kyçe.
- Aspektet kyçe janë:
  - ◆ Cili është objektivi juaj?
  - ◆ Çfarë dini? Si për personin për të cilin po përgatiteni ta intervistoni edhe për situatën e përgjithshme?
  - ◆ Çfarë keni nevojë të dini?
  - ◆ Kush do ta zhvillojë intervistën?
  - ◆ Ku do të zhvillohet intervista?
  - ◆ Si do ta bëni gati vendin për intervistën?
  - ◆ A ka nevojë viktimat e mundshme për ndonjë gjë? Ushqim, pije, veshmbathje?

## ANGAZHO DHE SHPJEGO (E)

### Pikat kryesore të kapitullit

- Është shumë e rëndësishme që në fillim të intervistës fillestare, t'i jepni viktimës së mundshme informacion kyç, i cili do të bënte që procesi të jetë më pak i rëndë, dhe të mos shkaktojë konfuzion apo frikë. Kjo mund të jetë hera e parë që viktimat e mundshme përballet me ndonjë nga autoritetet. Trafikantët

mund t'u kenë thënë gjëra të ndryshme që mund t'i bëjnë viktimat të kenë frikë dhe të mos kenë besim te autoritetet. Po ashtu, mund të kenë një ndjesi negative për shkak të eksperiencave në vendin e origjinës.

- Për të gjitha këto arsye, është tejet e rëndësishme që të filloni duke shpjeguar disa pika kyçe.
- Kjo merr rëndësi kritike për ndërtimin e një raporti me viktimën.
  - ◆ Shpjegoni kush jeni dhe identifikohuni si dhe tregoni arsyen pse ju dhe kolegët tuaj gjendeni aty.
  - ◆ Tregoni dhembshuri e mirëkuptim.
  - ◆ Mos bëni premtime që nuk jeni në gjendje t'i mbani.
  - ◆ Shpjegoni se mund t'i ofrohet ndihmë dhe përkujdesje profesionale.
  - ◆ Tregojuni cilat janë qëllimet tuaja: mbështetja e viktimës dhe ndjekja penale e autorëve.

## RRËFIM, QARTËSIM DHE SFIDË

### Pikat kryesore të kapitullit

Kjo fazë është pjesa kryesore e modelit, vetë intervista.

#### RRËFIMI

- Ftojini viktimën të tregojë historinë e vet. Lejojeni viktimën të "rikujtojë lirshëm" situatën e tij apo të saj. Lërimi ata të flasin. Mos e ndërprisni.
- Lejojini viktimës një kohë heshtjeje dhe një kohë për të menduar. Mbani parasysh se viktimat mund të jetë e traumatizuar, në gjendje konfuzioni, dhe/ose e frikësuar.

#### QARTËSIM

- Pasi viktimat e mundshme të ketë mbaruar së foluri, "rikujtimin e lirshëm" nga ana e saj, kjo është një mundësi për të sqaruar dhe shqyrtuar atë që u tha.
- Bëni pyetje "të hapura", p.sh. "si...", "kur...", "shpjego...", "më trego...".
- Në vazhdim të "rikujtimit të lirshëm", pyetjet tuaja duhet të jenë të hapura dhe sistematike.
- Në raste të trafikimit të qenieve njerëzore, duhet të prisni të dalin edhe mospërputhje në informacion.
- Zgjidhni një fushë në historinë e viktimës, përmbledhjeni dhe më tej bëni pyetje të hapura. Me fjalë të tjera, shqyrtoje historinë me kujdes dhe ndjeshmëri.
- Qartëso për të kuptuar pikat që ngrenë dhe gjërat që ju tregojnë.

#### SFIDË

- Mund të ketë raste kur nevojitet të sfidoni mospërputhjet në historinë e treguar.
- Në raste të trafikimit të qenieve njerëzore, duhet të prisni të dalin edhe mospërputhje në informacion.

- Viktimat mund të jenë konfuzë madje edhe gënjejnë për të fshehur turpin/frikën.
- Menaxhoni reagimin tuaj, jini të durueshëm.
- Jini objektivë.
- Trajtoni mospërputhjet.
- Mos e personalizoni këtë proces.

## CLOSURE (MBYLLJE)

### Pikat kryesore të kapitullit

- Në përfundim të intervistës, bëjini të ditur viktimës së mundshme se çfarë do të ndodhë më pas.
- Është e rëndësishme që ngjarjet ndodhin "me ta" dhe jo "ndaj tyre".
- Mbi të gjitha...
  - ◆ Jini të sjellshëm
  - ◆ Jini pozitivë
  - ◆ Jini profesionistë
  - ◆ Jini mbështetës

## EVALUATION (VLERËSIMI)

### Pikat kryesore të kapitullit

- Në përfundim, është e rëndësishme që të bëni një vlerësim të intervistës.
  - ◆ A ishte e efektshme intervista juaj?
  - ◆ Çfarë mësuat?
  - ◆ A ka mbetur ende ndonjë mangësi që lidhet me provat?
  - ◆ Vazhdoni punën me hetimin për të marrë prova shtesë - ndiqni pistat e dhëna.
  - ◆ Bëni diskutime përmbledhëse me kolegët në mënyrë që ekipi të ketë dijeni të të gjitha fakteve.
  - ◆ Merrni parasysh nevojën për një intervistë të mëtejshme.
  - ◆ Bëni një vlerësim të rrezikut për mirëqenien e viktimës.



## Ushtrim

- Përdorni karrige për të improvizuar "ndenjëset e autobusit".
- Identifikoni gjashtë pjesëmarrës për të luajtur rolin e "pasagjerëve".
- Tregojini secilit një histori të thjeshtë që duhet ta tregojnë kur të merren në pyetje nga oficerët e policisë. Duhet të ketë disa dallime midis historive. Gjashtë shembuj të mundshëm përfshijnë si më poshtë:
  - ◆ Person pa kualifikime që udhëton me shumë pak para drejt një vendi dhe shpreson të gjejë një punë kur të arrijë atje.
  - ◆ Person i kualifikuar (që ka një zanat si elektrikist, hidraulik, etj.) që kthehet

nga pushimet te puna që ka pasur për tre vjet.

- ◆ Person i kualifikuar që udhëton drejt vendit të punës me një kontratë nga një agjenci punësimi.
- ◆ Person i kualifikuar që udhëton pa një kontratë po ka në plan të kthehet pas një muaji nëse nuk do të jetë në gjendje të gjejë punë, dhe ka para të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e akomodimit dhe biletës së kthimit, po të lindë nevoja.
- ◆ Person i pakualifikuar që udhëton pasi ka parë një reklamë rekrutimi në internet ku kërkoheshin punëtorë në ndërtim. Ai/ajo nuk ka kontratë po ka vetëm një numër telefoni për të kontaktuar pasi të mbërrijë në destinacion.
- ◆ Person i pakualifikuar me një kontratë, por që ka një specifikim jo realist të punës për aftësitë që ka dhe kushte pune shumë të mira dhe jo realiste.
- Pjesa tjetër e grupit duhet të informohet për rrethanat ("Ky është një autobus që udhëton nga Prishtina në Tiranë") dhe u thuhet se duhet të bëjnë një intervistë të shpejtë fillestare për secilin prej personave në autobus.
- Ndajeni grupin në grupe të vogla dyshe. Tregojini secilës dyshe për kapitullin e intervistës fillestare që sapo mësuan dhe se duhet të përgatisin një intervistë me një prej pasagjerëve në autobus.
- Pas pesë minutash, kërkoni secilin nga personat e dyshes të përzgjedhin një prej "pasagjerëve" dhe të realizojnë intervistën.
- Bëni diskutime vlerësuese me secilën dyshe pas përfundimit të intervistës.

## EMPATIA

### Pikat kryesore të kapitullit

- Shfaqja e empatisë ka rëndësi absolute kur kemi të bëjmë me një viktimë të mundshme. Shumë shpesh, ata duan që ne t'i kuptojmë dhe jo t'u ofrojmë mëshirë.
- Përkufizimi në fjalor i fjalës empati është: "aftësi për të kuptuar dhe për të bashkëndarë ndjenjat e një personi tjetër".
- Ajo dallon nga simpatia, e cila përkufizohet si: "Ndjenja mëshire dhe keqardhjeje për fatkeqësinë e dikujt tjetër".
- Në themel, empatia ka katër elemente kyçe.

## SHIH BOTËN E TYRE

- Eksperiencat që ka kaluar në jetë një viktimë e trafikimit me gjasë mund të jenë shumë ndryshe nga tonat. Sigurisht që janë shumë ndryshe pas trafikimit, por me shumë mundësi edhe shumë ndryshe edhe më parë.



## VLERËSOJINI SI QENIE NJERËZORE

- Viktima e mundshme është po aq qenie njerëzore sa edhe ju dhe familja juaj. Ato kanë emocione, frikë, ndjenja, nevoja dhe ëndrra si kushdo tjetër.

## KUPTONI NDIKIMIN

- Është e rëndësishme të kuptoni, ose të paktën të përpiqeni të kuptoni se cili ka qenë ndikimi tek ata. Ne mund të mos kemi pasur të njëjtat përjetime, por natyrisht që mund të përpiqemi të kuptojmë sa vlerësim të ulët kanë për veten, sa frikë ndjejnë dhe ndoshta edhe sa të turpëruar ndihen.

## KOMUNIKOJENI MIRËKUPTIMIN TUAJ

- Thënë thjesht fare, nuk ka shumë kuptim të kesh empati për një viktimë të mundshme, të kuptosh se si ndihen, nëse nuk ia komunikon këtë atyre.

## SAKTËSIA E HISTORIVE

Pikat kryesore të kapitullit:

- Viktimat e trafikimit, të paktën në fillim, mund të tregojnë histori të pasakta apo edhe mund të gënjejnë.
- Kjo është krejtësisht e kuptueshme.
  - ◆ Frika nga trafikantët shpesh e tejkalon frikën nga autoritetet.
  - ◆ Mund të kenë kaluar nëpër shumë duar dhe shumë shtete, në kushte jashtëzakonisht stresuese.
  - ◆ Mund të ndihen në konfuzion kur janë nën presion.
  - ◆ Janë ndarë me familjen dhe miqtë.
  - ◆ Historia e parë mund të jetë ajo që u ka mësuar trafikanti në formën e një skenari.
  - ◆ Mund të besojnë se juve nuk mund t'ju zihet besë.
  - ◆ Mund të kenë frikë ose të besojnë se kanë kryer një krim.



## Ushtrim:

Gënjeshttrat - a ka rëndësi kjo?

- Lexoni deklarin e mëposhtëm para grupit të madh dhe kërkojini secilit pjesëmarrës që të shkruajë përgjigjen që besojnë se është e sakta.
- "Një viktimë e mundshme që ju zbuloni se po gënjen qartësisht nuk është një viktimë dhe, rrjedhimisht, është bashkëpunëtor/e me kriminelët."
  1. Po, çdo person që është një viktimë e vërtetë do të tregojë gjithmonë të vërtetën, sidomos nëse po shfrytëzohen.
  2. Jo, për shumë arsye, viktimat mund të gënjejnë para autoriteteve.
  3. Po, një viktimë e mundshme që nuk tregon të vërtetën nuk duhet të trajtohet me mirëkuptim apo mbështetje.
- Diskutojini përgjigjet në grup të madh. Informojini se Opsioni 2 është përgjigja e saktë dhe theksoni pikat kyçe si më poshtë:



- Duhet të pranojmë se disa herë viktimat mund të gënjejnë.
- Kemi nevojë për një histori bazë mbi të cilën të punojmë.
- Duhet t'i tregojmë viktimës se jemi në anën e tyre, se i mbështesim dhe se pavarësisht se kush janë apo çfarë kanë bërë apo kanë thënë, do të trajtohen në mënyrë të drejtë, me respekt dhe dinjitet.
- Duhet t'u tregojmë se i shohim si viktimat dhe jo si kriminelë.
- Nevojitet t'i sigurojmë se po kërkojmë të mbrojmë ata dhe të tjerët.
- Pasi të kemi vendosur një raport, mund që më pas të shqyrtojmë pasaktësitë për të cilat jemi në dijeni.

## ÇFARË TË BËJMË DHE TË MOS BËJMË

### Pikat kryesore të kapitullit

Më poshtë jepen disa pika për praktikatat e mira që duhen marrë në konsideratë.

Disa gjëra që të bëjmë:

- Merrni në konsideratë indikatorët e trafikimit të qenieve njerëzore.
- Vini re ku ndodhen njerëzit.
- Flisni me njerëzit individualisht, ku të mos ketë mundësi të shohë dhe të dëgjojë njeri.
- Tregoni dhembshuri dhe empati për viktimat e mundshme .
- Përdorni pista për të planifikuar pyetjet.
- Bëni pyetje të hapura.
- Lejojini njerëzit ta tregojnë historinë e tyre, në mënyrën e tyre, në kohën e tyre.
- Regjistroni çfarë ju thonë.
- Shpjegojuni viktimave të mundshme çfarë po ndodh dhe çfarë do të ndodhë.
- Jeta e një viktime është vjedhur ndaj kthejuni atyre një farë kontrolli.

### DISA GJËRA PËR TË MOS I BËRË

- Mos i pyesni a janë trafikuar. (Viktimat mund ta kuptojnë ndryshe termin "trafikuar". Po ashtu, mund të ndihen në siklet ose të turpëruar).
- Mos përdorni përkthyes vullnetarë nga komuniteti. (Ata mund të vijnë nga i njëjti komunitet i gjerë i viktimës dhe mund të njohin trafikantët ose të ndikohen prej tyre).
- Mos e shfaqni se jeni i mërzhitur nga historia e viktimës.
- Mos e sfido haptazi historinë e viktimës.
- Mos hamendësoni se është kontrabandim i personave.
- Mos bëni premtime që nuk jeni në gjendje t'i mbani.
- Mos i gënjeni viktimat e mundshme.
- Përpiquni të mos i arrestoni viktimat e dyshuara - nëse janë viktimë e trafikimit mund të kenë mbrojtje ligjore që të mos ndiqen penalisht.





## Ushtrim

- Ndajini pjesëmarrësit në 8 grupe.
- Secilit grup i jepet një Skenar (Shih Shtojca A).
- Grupeve u jepet 45 minuta kohë të "Planifikojnë&Përgatisin" intervistën sipas skenarit, ku/ dy nga grupi zgjidhen si oficerët intervistues.
- Grupet pastaj kthehen në grup të madh.
- Secili grup me radhë, para grupit të madh, zhvillon intervistën fillestare sipas skenarit të tyre.



## PËRMBLEDHJE

### Pikat kyçe:

- Siç e theksuam në fillim, kontakti i parë me një viktimë të mundshme dhe mënyra se si u flitet atyre, biseda e menaxhuar, ka rëndësi absolute.
- Duhet të mbajmë parasysht:
  - ◆ Shikojeni botën me sytë e viktimës.
  - ◆ Viktimat rrallë e tregojnë abuzimin.
  - ◆ Marrëdhëniet me të tjerët duhet të eksploroohen me imtësi - kujt i besojnë dhe pse - kujt nuk i besojnë dhe pse?
  - ◆ Mos i ndiqni penalisht viktimat për krimet e kryera si pasojë e të qenit i trafikuar pasi kjo rrit kontrollin e viktimave nga trafikantët.

*Për një informacion më të hollësishëm mbi intervistimin e viktimave të rritura dhe të mitura të trafikimit të qenieve njerëzore, referojuni Manualit të OSBE-së "TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE. MANUAL PËR PUNONJËSIT E POLICISË", kapitulli 6.*

<https://www.osce.org/files/f/documents/8/f/513298.pdf>

10

Hetimi

i trafikimit

të qenieve

njerëzore



## Objektivat e kapitullit

Në këtë kapitull do të eksplorojmë aspektet kyçe të hetimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore, duke u mundësuar pjesëmarrësve të kuptojnë elementet e veprës penale.

Në fund të këtij kapitulli:

- Do të vlerësoni rëndësinë e profesionalizmit dhe vlerave në hetimin e trafikimit të qenieve njerëzore.
- Do të kuptoni rolin e krimit të organizuar ndërkombëtar në trafikimin e qenieve njerëzore.
- Do të njiheni me sfidat e zakonshme gjatë hetimit të trafikimit të qenieve njerëzore.
- Do të kuptoni mundësitë për kryerjen e hetimit.
- Do të njihni përfitimet që sjell reagimi proaktiv ndaj fenomenit.
- Do të kuptoni rëndësinë e analizës së informacionit gjatë hetimit.
- Do të zbatoni njohuritë tuaja gjatë trajtimit të një kazusi duke luajtur rolin e drejtuesit të grupit hetimor.



## KRIMI I ORGANIZUAR

### Ushtrim

- Në grup të madh bëni pyetjen: "Çfarë është Krimi i Organizuar"?
- Diskutoni pikëpamjet e pjesëmarrësve.



### Pikat kryesore të kapitullit

- Krimi i organizuar nuk do të thotë thjesht "krim që është i organizuar".
- Ndonëse krime si grabitja apo vjedhja e banesave mund të kërkojnë një farë organizimi, këto lloj krimesh nuk janë domosdoshmërisht krime të organizuara.
- Ka mbi 200 përkufizime të "Krimin të Organizuar".
- Megjithatë, përkufizimi që jep Interpoli është ky:

*"një grup i strukturuar prej tre ose më shumë personash, që veprojnë në bashkëpunim me synim kryerjen e një ose më shumë krimeve të rënda" (Burimi: Interpol).*

Kodi penal Shqiptar jep përkufizimin e mëposhtëm në nenin 28:

*Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale. Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një vepre penale nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësitë e qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar.*

- Shumë njerëz mund të konsiderojnë krim të organizuar grupe kriminale që përfshihen në veprimtari që kanë të bëjnë me armë, lëndë narkotike, dhe pastrim të parave.
- Ndonëse këto janë disa prej "bizneseve" të krimit të organizuar, Trafikimi i Qenieve Njerëzore besohet të jetë gjeneruesi numër dy i parave për Krimin e Organizuar në të gjithë botën.
- Krimi i organizuar nuk njeh as kufij kombëtarë dhe as interesa kombëtare.

## PROFESIONALIZMI DHE VLERAT

### Ushtrim

- Pjesëmarrësit ndahen në 4 grupe:
  - ◆ Pjesëmarrësve u vihen në dispozicion letra dhe lapsa/stilolapsa/markera.
- Kërkojini secilit grup të përgjigjet dhe të shënojë në fletë të veçanta:
  - ◆ Cilat janë vlerat e rëndësishme në policimin modern?
  - ◆ Cilat vlera duhet të ketë Policia?
- Ftojini secilin grup t'i paraqesë komentet e veta grupit të madh, duke diskutuar pikat e ngritura.
- Ekspozojini fletët në mur përgjatë gjithë leksionit.

### Pikat kryesore të kapitullit

- Nga përgjigjet e pjesëmarrësve, duhet të theksohen pikat e mëposhtme dhe të shtohen nëse nuk janë përmendur në komentet e paraqitura para grupit të madh:
  - ◆ Ju përgjigjeni për vendimet, veprimet dhe mosveprimet tuaja.
  - ◆ Trajtojini njerëzit në mënyrë të barabartë.
  - ◆ Jini të vërtetë dhe të besueshëm.
  - ◆ Gjithmonë bëni gjënë e duhur.
  - ◆ Udhëhiqni me Rastin praktik tuajin të mirë.
  - ◆ Merrni vendime bazuar në prova dhe gjykimin tuaj më të mirë profesional.
  - ◆ Jini të hapur dhe transparentë në veprimet dhe vendimet tuaja.
  - ◆ Trajtojini njerëzit me respekt.
  - ◆ Veproni në të mirë të interesit publik.

## ROLI I NJË PUNONJËSI POLICIE TË MIRË

### Ushtrim

- Si grup, pyetini pjesëmarrësit se çfarë e përkufizon një punonjës policie të mirë?
- Përgjigjet shtrojini për diskutim.



## Pikat kryesore të kapitullit

- Pas marrjes së përgjigjeve të pjesëmarrësve, duhen theksuar pikat e mëposhtme:
  - ◆ Aftësia për të marrë vendime të jashtëzakonshme dhe për të arritur gjykime të mira.
  - ◆ Të [jetë në gjendje të] zgjidhë probleme të vështira.
  - ◆ Të kuptojë procesin e hetimit.
  - ◆ Menaxhimi i viktimave, dëshmitarëve, të dyshuarve, skenave të krimit, provave shkencore, zinxhirin e provave.

## OBJEKTIVAT E NJË HETIMI

### Ushtrim



- Ftojini secilin pjesëmarrës të punojnë me pjesëmarrësin në krah tij/saj dhe të renditin objektivat e një hetimi.
- Diskutojini përgjigjet në grup të madh.



## Pikat kryesore të kapitullit

- Në çdo hetim, duhet të jenë të pranishme objektivat e mëposhtëm:
  - ◆ Përcaktimi nëse është kryer një vepër penale.
  - ◆ Mbledhja e të gjithë informacionit, materialeve dhe provave të disponueshme.
  - ◆ Veprimi në interes të drejtësisë dhe të viktimës.
  - ◆ Ndjekja e të gjitha pistave të arsyeshme të hetimit.
  - ◆ Realizimi i një hetimi të detajuar.
  - ◆ Identifikimi, arrestimi dhe ngritja e akuzave për autorët e veprës penale.
  - ◆ Paraqitja e provave para prokurorit/gjykatës.
  - ◆ Dënimi i autorëve dhe mbrojtja e viktimës.

## MENTALITETI HETIMOR

### Pikat kryesore të kapitullit

- Vendimmarrja e mirë mbështetet te:
  - ◆ Të qenit mendjehapur.
  - ◆ Jini të hapur dhe pranues ndaj sugjerimeve alternative.
  - ◆ Kërkimi për shpjegime alternative.
  - ◆ Mos u fokusoni më shumë se duhet te një apo dy teori.
  - ◆ Përdorni një qasje logjike.



## OPSIONET HETIMORE

### Ushtrim

- Ftojini pjesëmarrësit të punojnë me personin pranë tyre dhe të rendisin taktikat dhe teknikat hetimore të përshtatshme për një çështje trafikimi të qenieve njerëzore.
- Diskutojini përgjigjet në grup të madh.



### Pikat kryesore të kapitullit

- Në çdo hetim të trafikimit të qenieve njerëzore duhet të mbani parasysh pikat e mëposhtme:
  - ◆ Strategji dhe taktika si proaktive ashtu dhe reaktive.
  - ◆ Mbledhja e të gjithë informacionit, të dhënave, materialeve dhe provave të disponueshme.
  - ◆ Marrja e provave shkencore nga të gjitha vendngjarjet.
  - ◆ Përdorimi i modelit PEACE, intervista me viktimën.
  - ◆ Marrja e deklarimeve nga të gjithë dëshmitarët përkatës.

## HETIME PROAKTIVE DHE REAKTIVE

### Ushtrim

- Ndajini pjesëmarrësit në 4 grupe.
- Secilit grup kërkojini të veprojnë si më poshtë:
  - ◆ Të përkufizojë një hetim proaktiv.
  - ◆ Çfarë lloj informacioni mund të çojë në një hetim proaktiv?
  - ◆ Cilat janë përfitimet e një hetimi proaktiv?
- Ftojini grupin të japë përgjigje dhe komente në grup të madh.
- Diskutojini përgjigjet në grup të madh.



*Për më shumë informacion rreth hetimit proaktiv, referojuni manualit të OSBE-së “Trafikimi i Qenieve Njerëzore. Manual për Punonjësit e Policisë”, kapitulli 5.*

<https://www.osce.org/files/f/documents/8/f/513298.pdf>



### Pikat kryesore të kapitullit

- Nëse jeni proaktiv, atëherë jeni ju që kontrolloni hetimin që prej fillimit - në një hetim reaktiv, ju vetëm reagoni ndaj ngjarjeve në mënyrë retrospektive.
- Realiteti është që viktimat rralë largohen nga shfrytëzuesit. Për çdo viktimitë që shkon në polici është një mori e panumërt që vazhdon të shfrytëzohet.
- Nëse një viktimitë është arratisur, trafikantët e kanë zhvendosur aktivitetin kriminal në një vend tjetër.
- Agjencitë ligj zbatuese nuk duhet të presin deri sa viktimat të shkojnë në polici - duhet të jetë policia në kërkim të tyre.

- Viktimat janë hallka më e dobët në çdo hetim - me gjasë janë në krizë, me gjasë kanë pësuar dëm psikologjik dhe/ose fizik, mund të jenë të trembur nga shfrytëzuesit, të hutuar, nuk janë të gatshëm ta njohin dhe pranojnë situatën e tyre, kanë frikë nga policia.
- Të jesh proaktiv do të thotë se mund të udhëheqësh në mbledhjen e provave me një qasje shkencore.
- Një qasje proaktive mundëson përdorimin e metodave speciale të hetimit, përfshirë edhe infiltrimin.
- Viktimat mbahen të fshehura në komunitete.
- Përgjithësisht, autoritetet e zbatimit të ligjit i dinë llojet e vendndodhjeve ku mund të gjenden viktimat.
- Nëse mund të përcaktoni vendndodhjen e shfrytëzimit, mund të përcaktoni edhe viktimat e tij.
- Nëse përcaktoni vendndodhjen e viktimave, mund të përcaktoni vendndodhjen e autorëve të dyshuar për trafikim, për shkak se viktimat duhet të mbahen nën shtrëngim dhe mbikëqyrje.
- Nëse mund të përcaktosh vendndodhjen e autorëve të dyshuar, atëherë mund t'i hetosh ata në mënyrë proaktive.

## ÇFARË DUKET E DREJTË DHE ÇFARË DUKET E GABUAR?

### Pikat kryesore të kapitullit

- Pavarësisht nga profesioni që kemi, në përditshmërinë e jetës sonë private dhe profesionale, ne e dimë se çfarë duket dhe ndiejmë se është mirë, çfarë është e drejtë dhe çfarë nuk është.
- Pikat e mëposhtme janë faktorë kyç që mund të zbatohen për cilindo për të ndihmuar në identifikimin e situatave të mundshme të shfrytëzimit.
  - ◆ Njihe mjedisin tënd dhe/ose informacionet.
  - ◆ Të dish, kur dhe pse njerëzit lëvizin në zonën tënde ose vijnë në zonën ku ti ushtron detyrën.
  - ◆ Gjuha e trupit është e rëndësishme. Njerëzit, po aq sa kafshët, përdorin gjuhën e trupit për të ndihmuar në komunikim. Gjuha e trupit e një personi mund të komunikojë në mënyrë të efektshme çdo emocion njerëzor.
  - ◆ Krahasoni situatën me kushtet e rregullta të punës / pagesë për atë rol apo për një rol të ngjashëm.
  - ◆ Nëse situata duket si një abuzim dhe shfrytëzim, atëherë ndoshta ashtu është.
  - ◆ Nëse duket si diçka e gabuar, atëherë kontrolloje ose raportoje. Mos e injoro.



## PROVA SHKENCORE - EKZAMINIMI I VENDNGJARJES

### Pikat kryesore të kapitullit

- Pjesëmarrësve duhet t'u tregohet sa më poshtë:
  - ◆ Në aspektin e provave shkencore, sipas parimit të shkëmbimit i Locard-it (disa herë referohet thjesht si parimi i Locard-it) autori i një krimi do të sjellë diçka në vendngjarje dhe do të marrë me vete diçka nga vendngjarja kur largohet prej saj, dhe që të dyja këto mund të përdoren si prova shkencore.
- Trafikimi i qenieve njerëzore është një krim i rëndë. Si i tillë, duhet të respektohen pikat e mëposhtme:
  - ◆ Konsideroni një strategji të provave shkencore që në faza të hershme.
  - ◆ Përdorni ekspertë për provat shkencore.
  - ◆ Ruajeni vendin e ngjarjes deri sa të mbërrijnë ekspertët.
  - ◆ Trajtojeni si një krim të rëndë.
  - ◆ Nëse nuk mund të merrni mbështetje për provat shkencore ... Kërkojini VETË!

## ÇFARË ËSHTË NJË VENDNGJARJE?

### Pikat kryesore të kapitullit

- Vendngjarje është çdo skenë fizike, kudo, që përmban gjurmë fizike të veprimtarive kriminale në të shkuarën.
- Vendngjarjet mund të jenë vendndodhje (në mjedise të mbyllura apo në natyrë), automjete dhe persona (viktima dhe të dyshuar).
- Kqyrja e vendngjarjes ka të bëjë me mbledhjen e provave fizike dhe ruajtjen e tyre në kushtet në të cilat janë gjetur.

## ÇFARË ËSHTË KOYRJA E VENDNGJARJES?

### Pikat kryesore të kapitullit

- Është "kqyrja e vendngjarjes duke përdorur një qasje teknike dhe shkencore".
- Synimi është gjithmonë që të regjistrohen, mbrohen dhe ruhen provat në mënyrë të tillë që të mund ekzaminohen në mënyrë shkencore në një kohë të mëvonshme.

## PSE KOYRET VENDNGJARJA?

### Ushtrim

- Pyetini pjesëmarrësit në grup të madh: "Pse e kqyrin vendngjarjen?"
- Diskutojini përgjigjet në grup të madh.





## Pikat kryesore të kapitullit

- Për të përcaktuar, për sa të jetë e mundur, çfarë ka ndodhur në atë vendngjarje.
- Për të bërë lidhjen e autorëve me vendngjarjen.
- Për të bërë lidhjen e viktimave me vendngjarjen.
- Për të siguruar prova për ekspertim shkencor.
- Për të ruajtur vazhdimësinë e provave për të mbështetur ndjekjen penale në gjykata.
- Për t'i mbrojtur viktimat edhe më tej duke kryer një hetim profesional që çon në dënimin e autorëve të veprës penale.
- Bëjini vetes dy pyetje të rëndësishme:
  1. Cilat janë qëllimet e tua?
  2. Si do t'i arrish ato (duke pasur parasysh burimet e disponueshme dhe rrethanat e çështjes)?

## ÇFARË DËSHIRON TË ARRISH?

### Pikat kryesore të kapitullit

- Mund të ndërmerrni veprimet e mëposhtme:
  - ◆ Identifikoni një të dyshuar.
  - ◆ Identifikoni një viktimë.
  - ◆ Përcaktoni moshën e viktimës.
  - ◆ Mbështesni me prova historitë.
  - ◆ Identifikoni lidhjet midis të dyshuarve, viktimave, vendndodhjeve, automjeteve, dokumenteve, etj.
  - ◆ Identifikoni dokumente udhëtimi apo përcaktoni vërtetësinë e tyre.

## CILAT PROVA SHKENCORE MUND TË MERREN NË LIDHJE ME TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE?

### Ushtrim

- Ftojini pjesëmarrësit të punojnë me personin në krah dhe të identifikojnë provat shkencore që mund të merren në lidhje me një rast trafikimi të qenieve njerëzore.
- Diskutojini përgjigjet në grup të madh.



## Pikat kryesore të kapitullit

- Provat shkencore që mund të merren në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore mund të përfshijnë:
  - ◆ Material biologjik (p.sh. gjak, urinë, pështymë).
  - ◆ Gjurme të gishtave ose të pjesëve të tjera të trupit.
  - ◆ Fibra dhe mikrogjurme të tjera.
  - ◆ Provat dokumentare.

- ◆ Imazhe të njerëzve, pajisjeve, planimetrisë së objektit, etj.
- ◆ Pajisje kompjuterike dhe pajisje të tjera elektronike TELEFONAT!

## TELEFONAT CELULARË DHE TEKNOLOGJIA

### Pikat kryesore të kapitullit

- Përdorimi si prova e të dhënave nga telefonat celularë, dhe pajisje të tjera teknologjike, si laptop dhe tableta, është rritur në mënyrë eksponenciale gjatë dekadës së fundit duke marrë shkas edhe nga zhvillimi i shpejtë i teknologjisë.
- Shumë pak njerëz në botë nuk kanë një telefon celular të një teknologjie të caktuar, shpesh një telefon smart.
- Në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, ka shumë gjasë që të jetë përdorur një telefon celular përgjatë gjithë procesit të trafikimit si nga trafikantët ashtu edhe nga viktimat.
- Përmbajtja dhe të dhënat që kanë telefonat celularë (si dhe çdo pajisje tjetër teknologjike) duhet, pra, të ekzaminohen në mënyrë teknike nga një ekspert.
- Ato mund të përmbajnë të dhëna dhe informacione për:
  - ◆ personat pjesë e grupit kriminal (në listën e kontakteve ose të thirrjeve/ mesazheve).
  - ◆ identifikimin e viktimave të tjera të mundshme.
  - ◆ të dhëna për vendndodhjen në lidhje me udhëtimin, fshehjen apo shfrytëzimin.

*Për më shumë informacion rreth metodave hetimore, referojuni Manualit të OSBE-së "Trafikimi i Qenieve Njerëzore. Manual për Gjyqtarë, Prokurorë dhe Punonjës të Tjerë Ligjorë", kapitulli 6.*  
<https://www.osce.org/files/f/documents/f/6/512644.pdf>

## ANALIZA E INFORMACIONEVE SI INSTRUMENT PËR HETIMIN DHE MBLEDHJEN E PROVAVE

### Pikat kryesore të kapitullit

- Analiza mund t'i ndihmojë hetuesit të identifikojnë pista të mundshme për hetimin - mund të hartëzojë rrjetet e krimit të organizuar.
- Analiza e Rrjeteve Sociale ndihmon për nxjerrjen e informacioneve të dobishme si për Rast praktik interesa personale, lidhje shoqërore, dhe veprimtari.
- Informacionet:
  - ◆ Përdoret për të identifikuar itinerare, metoda dhe shënjestra.
  - ◆ Lidh individët, pronat dhe sende që shërbejnë si provë.
- Analiza mund të përdoret "për të krijuar një tablo provash" para një gjykate me anë të grafikëve dhe diagramëve.

11

Detyrimi për  
Përkujdes  
dhe Vlerësimi  
i Rrezikut për  
Viktimat e  
Trafikimit



## Objektivat e këtij kapitulli

Në përfundim të këtij kapitullit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë parimet bazë të Vlerësimit të Rrezikut.
- Të shpjegojnë termat "largo", "prano", "redukto", "shmang", dhe "transfero".
- Të shpjegojnë konceptin e "vlerësimit dinamik të rrezikut".
- Të kuptojnë parimet dhe aspektet kyçe për menaxhimin e rrezikut në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore.

## HYRJE

### Pikat kryesore të kapitullit

- Vlerësimi i niveleve të rrezikut është me rëndësi kritike për rastet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (TQNJ). Çdo person i përfshirë në luftën kundër TQNJ duhet të jetë i vetëdijshëm për procesin në mënyrë që të japë një kontribut të informuar dhe të dobishëm sa herë që i kërkohet një gjë e tillë.
- Realizimi i vlerësimit të rrezikut në fushën e TQNJ është ndoshta një detyrë unike dhe komplekse në drejtësinë penale dhe disiplinat që lidhen me të. Zakonisht, janë të përfshirë shumë individë, shpesh të shpërndarë në një zonë gjeografike të gjerë (përfshirë në shtete të tjera), që shfrytëzojnë njerëz të intimiduar dhe të frikësuar, të cilët mund të mos jenë të gatshëm të bashkëpunojnë me ju.
- Gjithsesi, parimet bazë janë të thjeshta dhe diçka që e bëjmë çdo ditë në të gjitha aspektet e jetës sonë. Ky kapitull synon t'i ndihmojë pjesëmarrësit të kuptojnë qartë atë që aktualisht janë duke e zbatuar dhe se si kjo mund të zbatohet në kontekstin e TQNJ.

## Ushtrim

Kalimi i rrugës

- Ky ushtrim përdor një situatë të përditshme për të ilustruar konceptin e vlerësimit të rrezikut, dallimet e mundshme midis rreziqeve, dhe se çfarë mund të bëhet për t'i trajtuar këto rreziqe. Ky ushtrim mund të realizohet lehtësisht në klasë.
- Ndonëse është i një natyre të gëzueshme dhe zbavitës, ushtrimi përmban një mesazh serioz, shërben si një hyrje e mirë për temën dhe përvoja ka treguar se ndihmon për zbatimin e koncepteve në skenaret e TQNJ.
  - ◆ Kërkoni tre vullnetarë nga grupi.
  - ◆ Dy janë këmbësorë, tjetri është shofer i një automjeti.
  - ◆ Thuajini grupit se ndodhen në Shqipëri, pra ku makinat ecin në krahun e djathtë të rrugës.



- ◆ Një prej këmbësorëve është nga Shqipëria; tjetri është vizitor nga Mbretëria e Bashkuar ku makinat lëvizin në krahun e majtë të rrugës.
- ◆ Shoferi po ecën me makinë drejt dy këmbësorëve.
- ◆ Udhëzojini këmbësorët të shikojnë në drejtimin nga presin të vijë trafiku.
- ◆ Këmbësori që sheh nga drejtimi i duhur qëndron në trotuar; këmbësori tjetër që sheh nga drejtimi i gabuar goditet nga "automjeti".
- ◆ Nuk ka rëndësi nëse këmbësorët debatojnë se të dy do të shikonin nga drejtimi i duhur ose nëse audienca bën komente të ngjashme - mund ta përdorni këtë për të gjeneruar energji duke i pyetur pse janë të këtij mendimi, duke shprehur këndvështrimin e kundërt, etj.

### **TANI, PREZANTONI KONCEPTIN E MËPOSHTËM:**

- Pyetjet që parashtrojmë kur bëjmë vlerësimin e rrezikut janë: Kush ose çfarë është në rrezik?
- Çfarë është rreziku?
- Cili është niveli i rrezikut?
- Çfarë veprimesh duhet të ndërmerren? Largo, Prano, Redukto, Shmang, Transfero?

### **PYETJE: KUSH OSE ÇFARË ËSHTË NË RREZIK?**

#### **PËRGJIGJE:**

- Këmbësorët. Ndoshta edhe shoferi.
- Ndoshta edhe përdorues të tjerë të rrugës dhe dëshmitarët.

### **PYETJE: ÇFARË ËSHTË RREZIKU?**

#### **PËRGJIGJE:**

- Lëndimi fizik dhe psikologjik i shoferit. Dëmi shkaktuar automjetit.
- Vonesa ndërkohë që policia merret me aksidentin rrugor. Kostot e hetimit të aksidentit.
- Kostot e trajtimit të palëve të lënduara. Trauma për dëshmitarët.
- Pasqyrimi në shtyp me pasoja negative për turizmin.

### **PYETJE: CILI ËSHTË NIVELI I RREZIKUT?**

#### **PËRGJIGJE:**

- Në bazë të fakteve të paraqitura, kjo do të ndryshojë midis dy këmbësorëve.
- Shkalla sa i rëndë është rreziku do të jetë e njëjtë për të dy po të goditeshin nga një makinë - një lëndim ose edhe një fatalitet i mundshëm.
- Dallimi qëndron te gjasat e rrezikut për secilin prej tyre.
- Personi që vjen nga vendi ku automjetet qarkullojnë në krahun e majtë të rrugës me gjasë do të shikonte automatikisht në të djathtë, me më shumë

gjasë do ta shikonte makinën dhe, rrjedhimisht, do ta shmangte rrezikun.

- Vizitori që vjen nga vendi ku automjetet qarkullojnë në krahun e djathtë të rrugës me më shumë gjasë do të shikonte në krahun e majtë, nuk do ta shikonte automjetin, do të goditej dhe do të lëndohej.

### **PYETJE:**

Çfarë mund të bëjë këmbësori që vjen nga një vend ku "automjetet ecin në krahun e majtë" me qëllim që të:

- ◆ Largojë;
- ◆ Pranojë;
- ◆ Reduktojë;
- ◆ Shmangë;
- ◆ Transferojë rrezikun te vetja?

### **PËRGJIGJE:**

Largo

- Ai/ajo mundet që thjesht të shmangë udhëtimin në vende ku automjetet qarkullojnë në krahun e majtë.
- Ai/ajo mund të eci në rrugë dhe të shpresojë që nuk do të ketë trafik.
- Shoferi do ta shohë, ose që makina do të ecë aq ngadalë sa që nuk do të shkaktonte ndonjë lëndim serioz.
- Ai/ajo mund ta trajtojë veten që të mendojë në mënyrë të ndërgjegjshme lidhur me drejtimin nga vjen trafiku. Ata mund ta harrojnë këtë dhe t'i drejtohen asaj që u ka mësuar jeta më parë, por do të kishte më pak shanse për këtë.

### **SHMANGIA**

- Ai/ajo mund të përdorë vetëm vendkalimet e duhura ose nënkalimet për këmbësorët, urat, etj. ose të marrë një taksì për të shkuar kudo që i duhet.

### **TRANSFERIMI**

- Këmbësori nuk do të jetë në gjendje për të transferuar të gjitha rreziqet, por mund të jenë në gjendje të transferojnë disa prej tyre. Për Rast praktik, po të merrte një taksì, disa prej rreziqeve që të paguante për trajtim spitalor në rast se do të pësonte një aksident do të transferoheshin te kompania e sigurimit ose te shoferi i taksisë.

***Ju mund të funksiononi vetëm mbi bazë të asaj që dini.***

***Vini re se mund të merrni vendime për rrezikun vetëm duke i bazuar ato te informacioni që dini ose që mund të pritët, në mënyrë të arsyeshme, ta zbuloni.***

## VLERËSIMI DINAMIK I RREZIKUT

### Pikat kryesore të kapitullit

- Vlerësimi dinamik i rrezikut (që njihet edhe si "vlerësimi i vazhdueshëm i rrezikut") është procesi i vlerësimit në vazhdimësi të mënyrës se si vlerësimi i rrezikut ka ndryshuar nën dritën e informacionit dhe ngjarjeve që evoluojnë.
- Është shumë e rëndësishme që të bëni vlerësimi dinamik të rrezikut në rastet e TQNJ-së, duke ditur që rrethanat mund të ndryshojnë me shpejtësi të madhe.
- Natyrisht, nuk është e mundur të jepen udhëzime për çdo situatë të mundshme, por ky Rast praktik është një ilustrim i mirë:
  - ◆ Niveli i rrezikut prej dhunës është i lartë në rastet kur trafikanti i dyshuar është person i dhunshëm që ka dhunuar viktimën, ka një histori të gjatë dhune, dhe endet akoma i lirë.
  - ◆ Viktima vendoset në një strehëz të sigurt dhe të fshehtë; niveli i përgjithshëm i rrezikut për dhunë ulet.
  - ◆ Një banorë tjetër e strehëzës e dëgjon duke folur në telefon duke përshkruar vendndodhjen e strehëzës; rreziku i nivelit të dhunës rritet.
  - ◆ Kqyrja e telefonit të banores tregon se ajo ka kontaktuar trafikantin e dhunshëm që është ende në gjendje të lirë; niveli i rrezikut për dhunë është tashmë edhe më i lartë, ndoshta në mënyrë thelbësore.
  - ◆ Burri arrestohet pranë strehëzës, ndaj tij ngrihen akuza, dhe vendoset në paraburgim; niveli i rrezikut tani ulet.

## KUSH OSE ÇFARË ËSHTË NË RREZIK?

### Pikat kryesore të kapitullit

(Vini re: kjo nuk është një listë shteruese)

- Viktimat e TQNJ, Familjet e viktimave.
- Kushdo që është i përfshirë në hetim, dhënie të mbështetjes, etj. Dëshmitarët.
- Gjasat e arritjes së një rezultatit të suksesshëm për hetimin.
- Besimi e siguria e viktimave të ardhshme për të bërë kallëzim.

## ÇFARË ËSHTË RREZIKU?

### Pikat kryesore të kapitullit

(Vini re: kjo nuk është një listë shteruese)

- Sulm/intimidim i viktimave të TQNJ-së ose familjeve të tyre nga kriminelët. Intimidim i dëshmitarëve.
- Nëse nuk dënohen, autorët e veprave penale do të vazhdojnë të viktimizojnë persona të tjerë.
- Viktimat/dëshmitarët nuk do të bashkëpunojnë me drejtësinë nëse e humbin besimin në sistem.



- Nëse viktimat kthehen në shtëpi pa ju ofruar mbështetje ato do ta mohojnë ose do të mbyllen në vetvete. Trafikantët (autorët e veprës penale) do të vihen në dijeni të teknikave hetimore dhe ato do të kompromentohen.

## CILI ËSHTË NIVELI I RREZIKUT?

### Pikat kryesore të Kapitullit

Niveli i rrezikut varet nga një sërë faktorësh, përfshirë përgjigjet për pyetjet e mëposhtme:

- A janë në gjendje autorët e veprës penale/trafikantët të kontaktojnë viktimën ose familjen e tij/saj?
- Sa të dhunshëm janë autorët e veprës penale/trafikantët?
- Si është shëndeti fizik i viktimës(ave)?
- Si është shëndeti psikologjik i viktimës(ave)?
- Nëse teknikat hetimore dekonspirohen, sa të rënda janë pasojat për të ardhmen?

## ÇFARË VEPRIMESH DUHET TË NDËRMERREN?

### Pikat kryesore të kapitullit

Kjo varet nga të gjithë faktorët e mësipërm, disa shembuj janë:

- Vendosja e viktimave të dyshuara të TQNJ në strehëza të sigurta dhe masa të tjera për mbrojtjen e dëshmitarëve.
- Këshillimi dhe trajtimi mjekësor për viktimat e traumatizuara/të dëmtuara. Ndalimi i të dyshuarve.
- Mbështetje për kthimin e asistuar të viktimave e TQNJ-së në banesë/shtëpi.
- Lehtësimi për dëshmitarët/viktimat që të dëshmojnë nëpërmjet videokonferencës ose në mënyrë anonime.

Përdorimi i metodave speciale hetimore, për Rast praktik, kryerja e operacioneve policore në dukje rutine për të shpëtuar viktimat e mundshme.

## Ushtrim

- Ndajini pjesëmarrësit në 6 grupe.
- Caktojini secilit grup një mjedis të veçantë (psh. ndajini në klasa të ndryshme).
- Secilit grup i jepet një rast studimor nga këto që jepen më poshtë.
- Secilit grup i jepen tre pyetje për diskutim dhe përgjigje.
  1. Identifikoni, nëse janë të pranishme, elementet e konceptit të trafikimit të qenieve njerëzore.
    - a. Veprimi
    - b. Mjetet
    - c. Qëllimi

2. Cilat janë nevojat individuale të viktimës dhe çfarë mbështetjeje është ofruar?

3. A ka ndonjë përmirësim të identifikuar për veprimin e ndërmarrë?

- Grupeve u jepen 30 minuta kohë për të realizuar këtë detyrë.
- Më pas, grupet rikthehen dhe paraqesin rastin e tyre, që më pas ndiqet nga diskutimi në grup.

*Andi ishte vetëm 17 vjeç kur pjesëtarët e një familjeje e kontaktuan dhe i ofruan një punë dhe një strehë për të futur kokën. Por, në vend të këtyre premtimeve, u kthye në një skllav në një vendgrumbullimi hekurishtesh që ata zotëronin, ku e shfrytëzuan brutalisht, e rrahën dhe e abuzuan për vite me radhë.*

*Andi u largua nga shtëpia kur ishte 16 vjeç dhe qëndroi në një banesë me qira për katër muaj por më pas nuk kishte mundësi të paguante qiranë. Pronarët e dëbuan dhe e gjeti veten të pastrehë. Andi kishte paaftësi intelektuale dhe probleme të tjera sociale dhe të shëndetit mendor.*

*Në janar 2019, pranë sallës operative të policisë erdhi një telefonatë nga një person që kishte vizituar vendgrumbullimin e hekurishteve dhe kishte parë një djalë të ri që nuk ishte aspak mirë, ishte i kequshqyer dhe i pashëndetshëm. Ai kishte edhe shenja të dhunës fizike.*

*Me ndërhyrjen e Policisë së Shtetit, Andi u shoqërua menjëherë për në spital pasi kishte shumë plagë të patrajtuara. Një prej infermiereve që kujdesej për Andin tha:*

*"Në 38 vite punë si infermiere, nuk kam parë asnjëherë plagë të tilla, kurrë. Vetë numri i plagëve më shokoi; ishin të tmerrshme. Do ta përshkruaja pamjen e tij si të dikujt që vjen nga një kamp përqendrimi. Ishte shumë i uritur dhe i etur, nuk mund ta besoja sa hante e pinte, sa nuk ndjente të ngopur."*

*Siguria e Andit u vendos si përparësia numër një, duke pasur parasysh jo vetëm nevojat e tij, por edhe rolin kyç që mund të luante në hetim. Në lidhje me hetimin policia argumentoi se:*

*"Që ky rast të hetohet me sukses, është e domosdoshme që marrim masat e duhura për sigurinë, të garantojmë që viktima të marrë mbështetjen e nevojshme, ta ndihmojmë të kapërcejë këtë situatë të tmerrshme, si dhe ta mbështesim gjatë procesit gjyqësor. Raste të mëparshme kanë treguar se pa mbështetje të mjaftueshme gjatë periudhës së rikuperimit, këto viktima të krimit janë të rrezikuar për t'u ritrafikuar, pasi kanë vështirësi për të përmbushur nevojat bazë."*

*Pasi i dhanë si fillim përkujdesjen dhe mbështetjen e nevojshme Andit, në ditën e tretë në spital, ai tregoi se trajtohej si skllav dhe se e rrihnin çdo ditë. Andi u asistua gjatë dhënies së deklarimeve në polici. Për rrjedhojë, të dy burrat që e shfrytëzuan Andin dhe e detyruan të punonte në vendgrumbullimin e hekurishteve*

*pa pagesë u dënuan përkatësisht me 15 dhe 6 vjet burgim.*

*Elona, një grua në moshë të mesme, është viktimë e shfrytëzimit për aktivitet kriminal. Shtëpia e saj u zu nga një grup kriminal për të magazinuar drogën dhe për ta përdorur si vend nga ku të drejtonin veprimtarinë e tyre kriminale.*

*Elona kishte qenë më parë viktimë e dhunës në familje, dhe i ishte dhënë drogë me forcë nga partneri i saj i dhunshëm. Për rrjedhojë, ajo u kthye në një preson të varur nga droga. Të birin ia morën në kujdestari dhe ajo përpqej mes vështirësive të largojë nga kjo marrëdhënie dëmtuese.*

*Kaluan shumë vite para se Elona të bëhej më mirë e të ishte në gjendje të kontaktonte djalin tashmë të rritur. Në atë kohë, ajo jetonte në një qytet të vogël dhe po merrte trajtim për varësinë nga droga.*

*Elona jetonte e vetme dhe ndihej e izoluar. Ajo gjeti disa "miq" me të cilët të fliste. Pasi fituan besimin e saj, ajo i mori në shtëpinë e saj. Sapo hynë në shtëpinë e saj, pesë burrat u bënë zot të shtëpisë.*

*Ata i dhanë Elonës tre mundësi:*

- 1. Të shiste lëndë narkotike për ta;*
- 2. Të kryente marrëdhënie seksuale me klientët që ata do të sillnin në shtëpi;*
- 2. Ta çonin në fshat dhe të mos kthehej asnjëherë.*

*Elona "zgjodhi" të shiste lëndë narkotike.*

*Më vonë, policia ushtroi kontroll në banesën e Elonës. Ajo u arrestua, së bashku me burrat e tjerë në shtëpi. Gjithsesi, anëtarët e grupit vazhduan ta intimidonin atë. Policia kuptoi se Elona ishte viktimë e mundshme dhe e referoi te Mekanizmi Kombëtar i Referimit. Aktualisht, Elona po merr mbështetje nga një prej ofruesve të shërbimeve në vend. Megjithatë, ajo jeton ende në shtëpinë ku abuzohej. Punonjësi social i saj po mundohet të gjejë një tjetër lloj strehimi të pavarur, por deri më tani pa sukses.*

*Beth u rrit në Nigeri në një familje në gjendje të mirë. Ajo mundi të shkonte në Evropë për studime dhe gjërat po shkonin mirë deri në vitin 2015. Në këtë vit, babai i saj ndërron jetë befas dhe asaj iu desh të kthehej në vendlindje.*

*"Jeta u bë shumë e vështirë për familjen time pasi babai na la", tregon Beth. "Pas një farë kohe, zbulova se nëna ime ishte përfshirë në kontrabandimin e drogës me qëllim që me fitimet të paguante faturat."*

*Nëna e Bethit u arrestua dhe më pas shitësit e drogës filluan të ushtronin presion mbi Bethin. Ata thanë se nëna e saj u kishte borxh para. U përpoqën që ta përfshinin edhe Bethin në kontrabandim droge. Duke qenë se kërcënimet për dhunë ndaj saj u shtuan, Bethi filloi të kishte frikë për jetën e saj. Kështu, u largua nga Nigeria dhe u nis për në Mbretërinë e Bashkuar.*

Pak pasi arriti atje, goditi pandemia e Covid-19 dhe ajo mbeti e izoluar nga pandemia. Ishte si e zënë në kurth, në dëshpërimin e saj duke u përpjekur të mbijetonte derisa një ditë e gjeti veten të trafikuar nga një rrjet kriminal. Kriminelët e kërcënuan nëpërmjet dhunës fizike dhe seksuale për ta detyruar që të bënte atë që i thonin. E frikësuar për jetën edhe njëherë si dikur, Bethi u bind: "Duhej të bëja çfarë mund të bëja në mënyrë që të mbijetoja", thotë ajo.

Gjatë një skeme mashtrimi të mbetur në tentativë, Bethi u arrestua. Policia e kuptoi që ajo ishte viktimë trafikimi dhe e referoi atë pranë një ofruesi shërbimesh që mundësoi strehimin e saj në një strehë të sigurt. Ajo mund të merrte shërbimet shëndetësore dhe po shikon mundësinë e fillimit të këshillimit.

Si pasojë e eksperiencave, Bethi ka vështirësi me gjumin. Tani është në listën e pritjes për terapi për ta ndihmuar të qetësohet, dhe stafi i strehëzes i mundëson sesione me ushtrime për ta ndihmuar në çlirimin e stresit.

Bethi ka ëndrra të mëdha për të ardhmen e saj dhe dëshiron të hyjë në sistemin formal arsimor në MB. "Unë jam një person shumë ambicioz. Jam gati të kontribuoj me gjithçka që kam mësuar. Brenda pesë vjetësh, shpresoj të jem një analiste financiare dhe të kem gjetur punë pranë një kompanie të madhe."

Tani për tani, Bethi po pret vendimin lidhur me kërkesën e saj për azil. "Çdo ditë zgjohem me frikën se mos më rikthejnë dhe do të më duhet të nis gjithçka nga e para dhe të ndjej përsëri gjithë atë dhimbje?"

Mbështetja që ka marrë në strehën e sigurt i ka krijuar një farë stabiliteti mes gjithë asaj pasigurie në situatën e saj dhe në mes të pandemisë prej Covid-19. "E megjithatë, ka një rreze drite, duke qenë këtu në këtë shtëpi", thotë ajo. "Ndjehem se jam e shpëtuar."

Kur familjen e Erionit e goditi tragjedia, ai e pati të vështirë ta përballonte. Në trishtim e sipër, iu kthye alkoolit për të përballuar dhimbjen dhe humbjen. Kështu, humbi punën në ndërtim dhe si të mos mjaftonte kjo humbi edhe shtëpinë.

Kishte turp dhe nuk donte t'u kërkonte ndihmë fëmijëve. Por dikush iu afrua për t'i ofruar ndihmë me një punë të mirëpajuar në ndërtim. Për fatin e keq të Erionit, personi që i ofroi mbështetje ishte një trafikant i qenive njerëzore.

Erioni u trafikua në Mbretërinë e Bashkuar ku u detyrua të punojë në kantiere të ndryshme në Londër për gjashtë vjet. Në fillim kur arriti në Angli, Erioni nuk e kuptoi se kishte ndonjë gjë që s'shkonte. Kishte mundësi të kontaktonte fëmijët me celular. Por shumë shpejt, trafikantët ia morën telefonin dhe i thanë se s'kishte nevojë për njeri tjetër.

Djali i Erionit nuk e kishte idenë se çfarë i kishte ndodhur të atit. Ai nuk e dinte as nëse ishte gjallë apo jo. Ndihej i shkatërruar.

Një viktimë tjetër i të njëjtit rrjet kriminal që shfrytëzonte Erionin, që ishte shpëtuar nga policia shprehu shqetësimin për Erionin dhe falë kësaj edhe ai u lirua.

*Erioni u shtrua në spital për shkak të abuzimit që kishte pësuar dhe një prej anëtarëve të organizatës Justice and Care Navigators filloi të merrej me të dhe mbështetjen e tij.*

*Duke filluar të hapej, gjëja e parë që kërkoi si ndihmë Erioni ishte të vendoste kontakt me familjen. Organizata e ndihmoi për ribashkimin e Erionit nga shtrati i spitalit me të birin. Sot, falë mbështetjes, të dy, babë e bir, flasin çdo ditë.*

*Erioni është duke u përmirësuar, mbështet hetimin e policisë dhe mezi pret të shohë djalin përsëri fizikisht dhe t'i japë një përqaftim të përmalluar.*

*Erindi është një djalosh 14-vjeçar që kishte vështirësi në shkollë. Shpesh i linte orët e mësimit dhe përzihej me njerëzit e gabuar. Gjatë kësaj kohe, u piketua dhe u mashtrua me premtime nga kriminelët. Ata e manipuluan dhe e bënë që të shpërndante lëndë narkotike si crack, kokaine dhe heorinë për përdoruesit lokalë. I premtuan para po i thanë se po "i spiunoi", babin do t'i a therrnin me thikë ndërsa mamën dhe motrat do t'i sulmonin seksualisht.*

*Ai u "zhyt në borxh" me grupin kriminal kur drogën dhe paratë ia morën si pjesë e planit të shfrytëzuesve.*

*Ata i thanë se po ta kapte policia, gjithçka duhej të thoshte në intervistë ishte "nuk di gjë" dhe të refuzonte të jepte emra dhe detaje.*

*Policia e gjeti Erindin në një "Shtëpi droge" dhe, kur e morën në intervistë, ai gjeti kurajën të shpjegonte se çfarë kishte ndodhur.*

*Situata përfshin Iranan, një viktimë të mundshme trafikimi femër nga Rumania, që po shfrytëzohej nga një "mikeshë" që i kishte kërkuar të vinte në Mbretërinë e Bashkuar të punonte me të.*

*Dikur, Irana i tregoi dikujt nga personeli në fabrikën e përpunimit se dokumentet ia kishin konfiskuar dhe se kishte shumë frikë. Pasaportën, kartën e identitetit dhe certifikatën e lindjes ia kishte marrë shfrytëzuesja me justifikimin se ajo i detyrohej £365.*

*Irana jetonte bashkë me shfrytëzuesen dhe të dyja punonin në të njëjtën fabrikë përpunimi ushqimesh gjatë pandemisë.*

*Linja e ndihmës Helpline foli me Iranan personalisht pas një telefonate fillestare. Ajo shpjegoi se e njihnte shfrytëzuesen që në Rumani dhe se i ishte kërkuar të vinte në Angli me të ta ndihmonte të kujdesej për fëmijët gjatë kohës që do të ishte në punë.*

*Irana e kishte kuptuar se do të regjistrohej si kujdestare e fëmijës. Shfrytëzuesja pagoi për udhëtimin e Iranas dhe tha se nuk do t'i kërkonte pagesë për qira ose ushqim. Por, me të mbërritur, shfrytëzuesja i kërkoj Iranas t'i kthente pagesën për udhëtimin dhe veshjet. Shfrytëzuesja ia mori Iranës dokumentet e identifikimit*

dhe i mbajti në dhomën e saj, dhe Irana nuk kishte akses në dokumentet e saj. Irana kishte akses në telefonin e saj deri sa një ditë shfrytëzuesja ia theu në zemërim e sipër. Shfrytëzuesja i mori Iranës edhe kartën e bankës. Irana monitorohej vazhdimisht nga shfrytëzuesja dhe kërcënohej se do t'i lëndonte familjen në Rumani nëse nuk bënte çfarë i thonin. Shfrytëzuesja u zemërua kur Irana i tha se kishte zënë një shoqe në punë dhe kështu e ndaloi që të dilte nga shtëpia. Megjithëse donte të dilte nga kjo situatë, Irana tha se kishte frikë të rikthehej në shtëpinë e shfrytëzueses për të marrë plaçkat e saj pasi mendonte se shfrytëzuesja nuk do ta linte të largohej. Linja e ndihmës Helpline foli pastaj me policinë për të marrë masat për nxjerrjen e saj nga kjo situatë dhe shpjeguan procesin për futjen e Iranës në shërbime mbështetëse të financuara nga qeveria. Policia e nxori Iranën në mënyrë të sigurt nga kjo situatë dhe u vendos në një strehë të sigurt.

## PËRMBLEDHJE

### Pikat kryesore të kapitullit

- Është e rëndësishme të mbahet parasysh se asnjë sistem i vlerësimit të rrezikut nuk është i përsosur, sidomos në kontekstin e ndërlikuar të TQNJ-së.
- Thjesht mund të bëni më të mirën dhe në mënyrë të arsyeshme të bëni një vlerësim të ndershëm të asaj që mund të pritët prej jush.



12

Bashkëpunimi  
ndërkombëtar  
dhe Skuadrat  
e Përbashkëta  
Hetimore



## Objektivat e kapitullit

Në këtë mësim, pjesëmarrësit do të rrisin të kuptuarit e Ndihmës së Ndërsjellë Juridike, Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, përfitimet prej tyre gjatë një hetimi, si edhe sfidat e mundshme.

## NDIHMJA E NDËRSJELLË JURIDIKE (NNJ)

### Pikat kryesore të kapitullit

- NNJ-ja përfshin aspekte kyçe që mund të ndihmojnë në hetimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore.
  - ◆ Letër Porosia
  - ◆ Skuadrat e Përbashkëta Hetimore (SPH)

#### Letër Porosia

- Letër Porositë
- Janë letra zyrtare me kërkesë për ndihmë juridike ose gjyqësore që dërgohen nga autoritetet qendrore të një shteti te autoritetet qendrore të një shteti tjetër, kur kërkohen prova ose ndihmë gjyqësore nga një juridiksion tjetër.
- Letërporositë e gjykatave dhe prokurorive, të drejtuara autoriteteve të huaja për njoftimet dhe marrjen e provave, i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë, e cila merr masa për t'i nisur ato. Kur çmon se mund të rrezikohet sigurimi ose interesat e tjera të rëndësishme të shtetit, Ministria urdhëron, brenda tridhjetë ditëve nga marrja e letërporosisë, që kësaj të mos i jepet rrugë.
- Ministria i komunikon autoritetit procedues që ka bërë kërkesën datën e marrjes së saj dhe nisjen e letërporosisë ose urdhrin për të mos i dhënë rrugë letërporosisë.
- Në rastet e ngutshme, autoriteti procedues mund të vendosë nisjen direkt, duke informuar Ministrin e Drejtësisë.
- Zakonisht, Letër Porositë specifikojnë si më poshtë:
  - ◆ natyrën e kërkesës;
  - ◆ padinë penale përkatëse në vendin kërkues;
  - ◆ dispozitën ligjore në bazë të së cilës bëhet kërkesa; dhe
  - ◆ informacionin që kërkohet.
  - ◆ Letër Porositë shpesh përdoren së bashku me Traktatet e Ndihmës së Ndërsjellë Juridike (TNNJ).

Gjykata që pranon kërkesën për ekzekutimin e letërporosisë, kryen dhe veprimin e kërkuar ose autorizon për këtë qëllim prokurorin, në rastet kur ligji e lejon.

Për kryerjen e veprimeve të kërkua zbatohen normat e këtij Kodi, përveç rasteve kur duhet të respektohen rregulla të veçanta të kërkua nga autoriteti gjyqësor i huaj, të cilat nuk vijnë në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar.





- Kërkesat tipike për prova me anë të Letër Porosive përfshijnë:
  - ◆ Të dhëna bankare - marrja e informacionit për llogaritë dhe prova dokumentare nga bankat;
  - ◆ Prova kompjuterike - marrja e rekordeve në internet dhe përmbajtjen e e-maileve, ndonëse informacione të caktuara nga kompani me bazë në SHBA mund të merren drejtpërdrejt prej tyre;
  - ◆ Dënimet - marrjen e informacionit të detajuar dhe autentik për dënime në një vend të huaj që mund të citohen si provë në gjykatë; kërkimet fillestare, megjithatë, bëhen nga policia;
  - ◆ Masa shtrënguese - kërkesa për kërkim dhe sekuestrim dhe kërkesa të tjera që përfshijnë një masë shtrënguese që do të kërkonte një urdhër gjykate në një çështje të brendshme;
  - ◆ Lidhje video-konferencë në proces gjyqësor - kërkesa për një lidhje nëpërmjet video-konferencës për një dëshmitar për dhënien e dëshmisë live në një proces gjyqësor nga një shtet tjetër;
  - ◆ Dëshmitarët - marrja e një deklaratë nga një dëshmitar jo-vullnetar;

Kur shteti i huaj ka vënë kushte për përdorshmërinë e akteve të kërkuara, autoriteti procedues shqiptar është i detyruar t'i respektojë, në qoftë se ato nuk vijnë në kundërshtim me ndalimet e caktuara nga ligji.

## SKUADRAT E PËRBASHKËTA HETIMORE (SPH)

### Pikat kryesore të kapitullit

- Maj 2000 - Konventa për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike.
- Qershor 2002 - Vendimi Kuadër i Këshillit.
- Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore (neni 27) (aplikimi i SPH ndërmjet Shteteve Anëtare (Austria, Bullgaria, Hungaria, Rumania, Slovenia) dhe vendeve të Ballkanit ( Shqipëria, BH, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia).

### Pikat kryesore të kapitullit

- Kur është më e përshtatshme një SPH?
  - ◆ Për hetime të vështira dhe me kërkesë të lartë, lidhje me Shtetet Anëtare të BE-së; ose veprime të koordinuara me shtete të tjera anëtare.
  - ◆ Kur juridiksioni i duhur për procedimet është i paqartë?
  - ◆ Kur kërkohet shumë asistencë për NNJ?
  - ◆ Në rast nevojë për shkëmbim/ndarje të shumë informacioneve?
  - ◆ Për masa hetimore që duhet të kërkohen në një tjetër Shtet Anëtar të BE-së?
  - ◆ Kur pasja e oficerëve të dërguar në një Shtet Anëtar tjetër përbën një avantazh?

- Përfitimet e një SPH:
  - ◆ Komunikim i drejtpërdrejtë.
  - ◆ Shkëmbimi i informacioneve.
  - ◆ Mbështetje nga Europoli.
  - ◆ Më pak nevojë për Letër Porosi.
  - ◆ Objektivë të përbashkët strategjikë.
  - ◆ Eficiencë dhe ndikim i shtuar.
  - ◆ Shkëmbimi i praktikave më të mira.
  - ◆ Kërkesa të drejtpërdrejta për masa shtrënguese.
  - ◆ Rritja e kapaciteteve të oficerëve të dërguar në shtetin tjetër.
- Kërkesa për një SPH me një shtet të BE-së:
  - ◆ 2 ose më shumë Shtete Anëtare.
  - ◆ Kuadër kohor specifik.
  - ◆ Qëllim specifik.
  - ◆ Përbërja e ekipit përcaktohet nga Marrëveshja.
  - ◆ Ekipi ngrihet në një (ose më shumë) Shtete Anëtare.
- Anëtarë të një SPH-je mund të jenë:
  - ◆ Prokurorë.
  - ◆ Oficerë policie.
  - ◆ Anëtarë të dërguar.
  - ◆ Përfaqësues të Eurojust.
  - ◆ Palë të treta: Europoli, shtete joanëtare të BE-së dhe agjenci ligj zbatuese.



## Ushtrim

- Kërkojini pjesëmarrësve të japin shembuj të sfidave që mund të paraqiten në çdo SPH.
- Përgjigjet paraqitini për diskutim.
- Identifikoni sfidat e mëposhtme dhe diskutoni cilëndo që pjesëmarrësit nuk e përmendën.
- Gjuha
- Vendndodhja
- Lidërshipi
- Strukturat ligjore
- Forcimi i skuadrës
- Dinamikat e skuadrës
- Praktikant kombëtare/lokale

*Legjislacioni shqiptar nuk ka parashikim ligjor të drejtpërdrejtë në lidhje me Skuadrat e Përbashkëta Hetimore. Megjithatë, si bazë ligjore baza ligjore mund të përdoret një interpretim i zgjeruar i Ligjit Nr.10 193, datë 3.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale” si dhe neni 10 i Kodit të Procedurës Penale mbi Zbatimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare.*

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

OSBE. Prezenca në Shqipëri  
Trafikimi i qenieve njerëzore : për Akademinë  
e Sigurisë: manual për trajnerë / OSBE. Prezenca  
në Shqipëri. - Tiranë :  
Graphic Line-01, 2023.  
106 f. ; 21 x 29.7 cm

ISBN 9789928470751

1.Trafikimi i qenieve njerëzore2.Manuale  
343.54 (035)









Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**